

Dhjetor 2016
Numri: 105
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



PSE NUK PRANOHET
LUTJA?

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Dhjetor 2016

VITI: X

NUMRI: 105

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VIETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi

pavarësisht nëse botohen apo jo

nuk i kthehen autorit. Koha e botimit

të një materiali përcaktohet

nga redaksia. Honoraret e shkrimeve

autoriale ose përkthimeve duhet të

vini t'i tërhiqni pranë

Shtëpisë Botuese "Progresi"

ose pranë zyrave të përfaqësimit

në Kosovë dhe Maqedoni.

Një ditë Ibrahim ibn Ed'hemit i thanë: "O veli i madh, që e kalon të gjithë kohën me mirësi! Allahu (xh.sh.), thotë: **"Lutmuni Mua dhe Unë do t'ju përgjigjem."** Ne e adhurojmë Allahun pa reshtur, por lutjet nuk po na pranohen." Ibrahim ibn Ed'hemi buzëqeshi me dhembshuri dhe u përgjigj:

"O bijtë e Ademit! Zemrat tuaja kanë vdekur për shkak të dhjetë gjërave." Të gjithë u habitën dhe e pyetën: "Na kanë vdekur zemrat?" Ibrahim ibn Ed'hemi u tha:

-Po, u kanë vdekur zemrat.

-Si ka mundësi?

-Zemrat tuaja i keni bërë ushqim për dhëmbët helmues të mëkateve. Helmi i mëkatit ua ka tharë damarët jetikë të zemrave tuaja... Ndërsa Allahu i Madhëruar nuk i pranon lutjet e zemrave të vdekura.

-Mirë, por cilat janë këto mëkate?

1- Thoni se e njihni Allahun (xh.xh.), por nuk i zbatoni urdhrat e Tij.

2- E lexoni librin e Allahut (xh.xh.), por nuk i zbatoni urdhrat e tij.

3- Pohoni se e doni të Dërguarin e Allahut (a.s.), por nuk jetoni sipas Sunetit të tij.

4- Thoni se Shejtani është një armik, por i ndiqni hapat e tij dhe i shkoni nga pas. Gjithashtu krijoni miqësi me të.

5- Pohoni se e doni Xhenetin, por nuk bëni asnjë përgatitje për të.

6- Thoni se keni frikë nga Xhehenemi, por nuk kërkonit recetë shpëtimi prej tij dhe nuk largoheni nga mëkatet.

7- Thoni se vdekja është e vërtetë, por nuk bëni asnjë parapërgatitje për të.

8- Merreni me gabimet e të tjerëve, por nuk i shikoni aspak gabimet tuaja.

9- Notoni në mirësitë e ndryshme të Allahut Teala, por harroni ta falënderoni Atë.

10- Të vdekurit tuaj i çoni dhe i fusni në dhe, por nuk mendoni se një ditë edhe juve do t'ju vijë exheli.

Si mund të pranohen lutjet e zemrave që janë nxirë në këtë mënyrë? Nëse e lini urdhërimin për të mirë, lutja juaj nuk pranohet.

Përmbajtja

Të mos përlyhesh apo të pastrohesh?
Prof. dr. Ismail Lufti Çakan

10




14

Esenca e fshehtë e ibadeteve
Rabia Brodbeck



Vetëm devotshmëria
Osman Nuri Topbash

34



17

18



Larg alkoolit, larg drogës!
Ruajuni nga mallkimi i Zotit!
Muhamed B. Sytari

5 Ndjeshmëria për të mos u përlyer
Ahmet Tashgetiren

8 Të qëndrosh i pastër
dhe të pastrohesh
Dr. Adem Ergyl

12 Mos u përlyej nga papastërtitë
e kësaj bote
Prof. dr. Sulejman Derin

17 Lutja
Adem Çelikkaja

22 Vesveset dhe rrugët e shpëtimit
Dr. M. Selim Arëk

24 Ruaje zemrën në namaz
Xhafer Durmush

28 Mrekullitë e Kuranit

29 "T'u thaftë gjuha!"
Edison Çeraj



47

Një Ajet - Një Hadith 30

El-Melik 40

Ilir Hoxha

Njihni veten dhe arrini lumturinë 42

Psikologji

Dizajni: Si ta shndërrosh shpirtin në trup 43

Edison Çeraj

Deshifrimi i kaosit 47

Mirko Univers

Kthimi te Zoti 50

Rrugëtim shpirtëror

Muhamed Ikbal 52

Personalitete botërore Islame

Viti i ri 56

Naim Drijaj

Për çfarë shkolle kemi nevojë?
Nuredin Nazarko



26

Islami e mallkon astrologjinë!
Muaz Erdem

44



Ndjeshmëria për të mos u përlyer

Ahmet Tashgetiren

Si Jusufi (a.s.)...

Kur dyert të mbyllen fort për të mos parë asnjë njeri dhe kur është përgatitur mjedisi më i përshtatshëm për të bërë mëkatin... Kur gruaja e famshme dhe e fuqishme përgatiti çdo gjë për t'ia shfaqur veten njeriut më të bukur, Jusufit (a.s.)... Domethënë, kur e përgatiti mjedisin dhe i mori të gjitha masat e sigurisë për të bërë mëkatin...

Kur i tha: “Eja!”

Jusufi (a.s.), tha: “Meadhallah / i kërkoj mbrojtje Allahut!”

Të ikësh prej gruas që të fton... Madje, të ikësh në atë mënyrë, sa që të të grisjet edhe këmbisha... Pastaj të bëhesh objekt shpifjesh...

Ja, kjo është rezistenca ndaj mëkatit. Ja, kjo është ndjeshmëria për të mos u përlyer.

Apo siç shprehet edhe Kurani Fisnik, kjo do të thotë që të jesh “prej atyre që i nënshtrohen vetëm Allahut”. Ajo

që përjetoi Jusufi (a.s.), ishte prej vështirësive të mëdha...

Dobësia që gjinitë e kundërta kanë kundrejt njëra-tjetrës, shqetësimi për familjen dhe fëmijët, dashuria ndaj pasurisë, pasioni për të udhëhequr etj., janë fusha që shejtani i mallkuar mund “t’ua zbukurojë” njerëzve. Kurthet... Intrigat... Lehtësimet për të kryer mëkatin...

Gjendje dhe situata në të cilat epshi mund ta kapë njeriun për hunde dhe ta çojë majtas e djathtas. Gjendje dhe situata në të cilat njeriu mund të zvarritet pas epshit... Atëherë, si mund të frenohemi dhe të rezistojmë kundrejt këtyre? Si mund të themi: “Meadhallah / i kërkoj mbrojtje Allahut?”

Gjithmonë

duhet të jemi të kujdesshëm...

Gjithmonë duhet të jetojmë në gatishmëri për t’u mbrojtur...

Gjithmonë duhet të mbrohemi.

Gjithmonë duhet të përpiqemi të jemi të pastër. Gjithmonë duhet të jemi të ndjeshëm që të mos përlyhemi.

Ah, sikur t’i shikojmë pretekstet që i shfaqte për veten bashkëshortja e mbretit (Zylejha e kishte emrin, apo jo?), për anaforen në të cilën kishte hyrë! Ah sikur të shohim shprehjen e saj të fashme: “Ja, ky është

djaloshi për të cilin më nënçmuat dhe më për-
gojuat.” – pasi grave u dha nga një thikë në dorë
dhe i pa duke prerë duart e tyre kur u solli Jusufin
përpara!.. Domethënë, ah sikur ta shohim përpjek-
jen e njeriut për të gjetur pretekste që justifikojnë
devijimin dhe përlyerjen e tij!.. Me të vërtetë, nuk
është e lehtë që njeriu të thotë “meadhallah”.

Bejazidi Bestami, rahmetullahi alejh, na para-
lajmëron:

“Kur të bësh një mëkat,
mos e bëj me gjymtyrën që
ta ka dhuruar Allahu! Mos
ke ndonjë gjymtyrë tjetër
përveç gjymtyrëve që të ka
dhënë Allahu? Kur të bësh
ndonjë mëkat, mos e bëj në
ndonjë vend ku të sheh Alla-
hu! Mos ka ndonjë vend ku
nuk të shikon Allahu? Kur
të bësh ndonjë mëkat, mos e
bëj në ndonjë vend që e ka
krijuar Allahu! Mos ka ndo-
një vend që nuk e ka krijuar
Allahu? Atëherë, përse e bën
atë mëkat? Përse e kalon vi-
jën e kuqe që ta ka vendosur
Allahu? Përse i shkel kufijtë
e Allahut?”

Ja pra, njerëzit si shembulli
i Jusufit (a.s.), që e kanë zgje-
dhur për të qenë robër të sin-
qertë të Allahut, thonë: “Këtë
dorë na e ka dhënë Allahu.
Atë nuk mund ta përdorim
në një punë që Allahu nuk
është i kënaqur.” Ata veprojnë
në kështu edhe kur përdorin gjuhën e tyre... Kur
thirren për të bërë ndonjë mëkat, thonë: “Allahu
na shikon.” “Nëse e shkelim ligjin e Allahut në një
vend që Ai e ka krijuar për të na shërbyer neve, kjo
nuk mund të jetë në përputhshmëri me virtytin
njerëzor.”

Pra, veprojnë siç ka vepruar Jusufi (a.s.)... A është
i lehtë një veprim i tillë? Sigurisht që nuk është
i lehtë. Për këtë arsye, duhet të bëhemi robër më
zemër të mbujtur me singëritet. Si mund të bë-
hemi robër të tillë? Këtë mund ta bëjmë duke dalë
në audiencën e Allahut Teala në kohën e seherit

për të bërë llogarinë e ditës së djeshme, së sotme
dhe së nesërme. Këtë mund ta bëjmë duke i parë
pikat e zeza që bien në zemër dhe duke u pastruar
prej tyre... Këtë mund ta bëjmë duke trokitur në
dyert e mëshirës në kohën e seherit siç thotë edhe
i Madhërishmi: “Ve’l-mustagfirine bi’l-es’har...”
Nisur nga kjo, asnjëherë nuk duhet ta përlyejmë
ditën, në mënyrë që të ngrihemi në seher dhe ta
përrjetojmë mirësinë e madhe të tij... Ndërsa nga
seheri duhet të mbartim një
zemër të pastër dhe frymë-
zim për ditën që vijon...

Si iu përgjigj Ebu Ubejde
ibn Xherrah (r.a.), Umerit
kur e pyeti: “Çfarë është de-
votshmëria?”

-Si ecën në një rrugë me
ferra?

-I mbledh rrobat dhe bëj
kujdes që të mos shkel në
gjemba.

-Ja, ajo është devotshmë-
ria.

Jeta e kësaj bote i përngjan
ecjes në një rrugë me ferra.
Kjo është prova e njeriut. A
nuk është e vërtetë se Shejta-
nit të mallkuar i është dhënë
aftësia për të ndikuar thellë
te njeriu, pra, deri te damarët
e tij? A nuk është e vërtetë se
Shejtani është armiku i nje-
riut? A nuk është e vërtetë se
brenda njeriut ka një fuqi që
e quajmë “Nefsu’l-Emmare”,

e cila bashkëpunon me Shejtanin dhe ka poten-
cialin për të urdhëruar të keqen? Njeriu është i
obliguar të jetojë me zgjuarsë. Ai duhet t’i bëjë
sytë katër, sepse, siç shprehet edhe Kurani Fisnik,
bëhet fjalë për një armik që ndërhyr te njeriu “nga
e djathta, nga e majta, nga përpara, nga prapa,
nga lart dhe nga poshtë”. Pra, ky është shejtani
i mallkuar...

Gjithmonë duhet të jemi të kujdesshëm... Gjith-
monë duhet të jetojmë në gatishmëri për t’u mbrojt-
tur... Gjithmonë duhet t’i kemi në dorë armët e
mbrojtjes. Gjithmonë duhet të përpiqemi që të jemi

*“Kur të bësh
një mëkat, mos e bëj me
gjymtyrën që ta ka dhuruar
Allahu! Mos ke ndonjë gjymtyrë
tjetër përveç gjymtyrëve që të
ka dhënë Allahu? Kur të bësh
ndonjë mëkat, mos e bëj në
ndonjë vend ku të sheh Allahu!
Mos ka ndonjë vend ku nuk
të shikon Allahu? Kur të bësh
ndonjë mëkat, mos e bëj në
ndonjë vend që e ka krijuar
Allahu! Mos ka ndonjë vend
që nuk e ka krijuar Allahu?
Atëherë, përse e bën atë mëkat?
Përse e kalon vijën e kuqe që
ta ka vendosur Allahu? Përse i
shkel kufijtë e Allahut?”*

të pastër. Gjithmonë duhet të jemi të ndjeshëm që të mos përlyhemi.

Atijje ibn Urve es-Sa'di, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Përderisa rob i të mos qëndrojë larg edhe nga disa gjëra që nuk janë të ndaluara me frikën se bie në mëkat, nuk mund të lartësohet në gradën e të devotshmëve."* (Tirmidhi, Kijamet 19. Veçanërisht shik. Ibn Maxhe, Zuhd, 24.)

Ndoshta duhet të përpiqemi për ta pastruar mjedisin në të cilin jetojmë... Ndoshta duhet të pastrohet i gjithë vendi... Ndoshta duhet ta parandalojmë ndotjen / përlyerjen e ajrit që marrim frymë... Të gjitha këto janë të nevojshme për t'i bërë lidhjet tona të shëndetshme me Zotin (xh.xh.). Ne i ngremë duart lart drejt Zotit... Por si mund t'i ngremë lart duart e përlyera? Çfarë mund t'i thonë Krijuesit, dhulxhelal, gjuhët e përlyera? A mund t'i drejtohet dhe t'i përgjërohet Atij një zemër që nuk e njuh mirë Atë?

Evliatë / miqtë e Allahut janë përpjekur shumë për të gjetur përgjigjen e pyetjes: "Si pranohen lutjet, apo, përse nuk pranohen lutjet?" Përgjigja që kanë gjetur është pikërisht çështja e cilësisë në marrëdhëniet tona me Allahun Teala. Për këtë arsye, të gjithë duhet ta pyesim veten: "Sa e fortë është lidhja jonë me Allahun?" Apo: "Sa e dobët është lidhja jonë me Allahun?" Fjalët e Ibrahim ibn Ed'hemit në lidhje me këtë, e shprehin qartë çdo gjë.

Një ditë Ibrahim ibn Ed'hemit i thanë: "O veli i madh, që e kalon të gjithë kohën me mirësi! Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Lutmoni Mua dhe Unë do t'ju përgjigjem."*** Ne e adhurojmë Allahun pa reshtur, por lutjet nuk po na pranohen." Ibrahim ibn Ed'hemi buzëqeshi me dhembshuri dhe u përgjigj:

"O bijtë e Ademit! Zemrat tuaja kanë vdekur për shkak të dhjetë gjërave." Të gjithë u habitën dhe

e pyetën: "Na kanë vdekur zemrat?" Ibrahim ibn Ed'hemi u tha:

-Po, u kanë vdekur zemrat.

-Si ka mundësi?

-Zemrat tuaja i keni bërë ushqim për dhëmbët helmues të mëkateve. Helmi i mëkatit ua ka tharë damarët jetikë të zemrave tuaja... Ndërsa Allahu i Madhëruar nuk i pranon lutjet e zemrave të vdekura.

-Mirë, por cilat janë këto mëkate?

1- Thoni se e njihni Allahun (xh.xh.), por nuk i zbatoni urdhrat e Tij.

2- E lexoni librin e Allahut (xh.xh.), por nuk i zbatoni urdhrat e tij.

3- Pohoni se e doni të Dërguarin e Allahut (a.s.), por nuk jetoni sipas Sunetit të tij.

4- Thoni se Shejtani është një armik, por i ndiqni hapat e tij dhe i shkoni nga pas. Gjithashtu krijoni miqësi me të.

5- Pohoni se e doni Xhenetin, por nuk bëni asnjë përgatitje për të.

6- Thoni se keni frikë nga Xhehenemi, por nuk kërkonit recetë shpëtimi prej tij dhe nuk largoheni nga mëkatet.


7- Thoni se vdekja është e vërtetë, por nuk bëni asnjë parapërgatitje për të.

8- Merreni me gabimet e të tjerëve, por nuk i shikoni aspak gabimet tuaja.

9- Notoni në mirësitë e ndryshme të Allahut Teala, por harroni ta falënderoni Atë.

10- Të vdekurit tuaj i çoni dhe i fusni në dhe, por nuk mendoni se një ditë edhe juve do t'ju vijë exheli.

Si mund të pranohen lutjet e zemrave që janë nxirë në këtë mënyrë? Nëse e lini urdhërimin për të mirë, lutja juaj nuk pranohet.



Ne i ngremë duart lart drejt Zotit... Por si mund t'i ngremë lart duart e përlyera? Çfarë mund t'i thonë Krijuesit, dhulxhelal, gjuhët e përlyera? A mund t'i drejtohet dhe t'i përgjërohet Atij një zemër që nuk e njuh mirë Atë?



Të qëndrosb i pastër DHE TË PASTROHESH

Dr. Adem Ergyl

Pastërtia është një fjalë që u jep rehati e prehje shpirt-rave. Kjo fjalë e bukur ka një specifikë që e zbukuron pothuajse çdo vend në të cilin gjendet. Allahu i Madhëruar na njofton në Kuranin Fisnik “se i do robërit e Tij të pastër”. Gjithashtu, na tregon edhe rëndësinë e marrëdhënies ndërmjet pastërtisë dhe besimit. Allahu Teala kërkon që ne të shkojmë në audiencën e Tij të pastër dhe të dëlirë. Përveç të tjerash, kërkon që robi të mos jetë i papastër / i ndryshkur në të gjitha aspektet e tij të dukshme apo të padukshme, por gjithmonë të jetë i pastër, madje, kërkon që robi të përpiqet seriozisht për t’u bërë i pastër.

Njeriu lind i pastër në këtë botë. Detyra e tij e parë është që të mos përlyhet. Kujdesi për të mos u përlyer është i rëndësishëm. Por edhe nëse nuk duam të përlyhemi, gjërat e papastra mund të na prekin. Nganjëherë mund të mashtrohemi nga nefsi, nganjëherë mund të mashtrohemi nga inkurajimet devijuese të shejtanëve prej njerëzve e xhindëve dhe nganjëherë mund të shtyhem apo të biem në gropa të papastra nga ndikimi i shoqërisë në të cilën jetojmë. Kur të ndodhë kjo, e rëndësishme është që të pastrohemi sa më parë. Ja, ky është synimi hyjnor që na është vënë përpara. Për ta arritur këtë synim:

“Gjuha jonë nuk duhet të përlyhet.” Gjuha përlyhet me gënjeshtër, me përgojime, me lëndimin e të tjerëve,

me shkatërrimin e ndonjë zemre, ma fjalë që përbëjnë kufër dhe me fjalë të shëmtuara e të ulëta. Para së gjithash, ne duhet të qëndrojmë larg nga këto ujëra të ndotur, sepse, nëse përlyhemi, ndoshta mund të mos na jepet mundësia për t’u pastruar. Megjithatë, nëse përlyhemi, menjëherë duhet të përpiqemi të pastrohemi pa humbur aspak kohë. Pasi ta pastrojmë gjuhën nga papastërtitë, duhet t’ia shtojmë edhe më shumë dritën asaj dhe ta bëjmë të dëlirë. Këtë duhet ta bëjmë me fjalë të bukura që i qetësojnë zemrat e të tjerëve, me fjali si perla që shprehin vetëm të vërtetën e të mirën, me thënien e shehadetit, me përmendjen e Allahut (xh. xh.) dhe me leximin e Kuranit Fisnik, i cili është fjala e Allahut Teala...

“Sytë tanë nuk duhet të përlyhen.” Ka shikime që janë haram. Këto shikime i përlyejnë edhe sytë, edhe zemrat. Ka faje që kryhen me shenjën e syve dhe të vetullave. Ka pamje të ulëta e të shëmtuara që nuk duhet të shikohen. Sytë nganjëherë mund të shndërrohen në një kanal që derdh helm në mendjen dhe zemrën e njeriut. Sytë janë drita më e bukur për një njeri. Për këtë arsye, njeriu nuk duhet ta nxijë këtë dritë. Kapakët e syve duhet t’i shndërrojmë në një mburojë që na mbron nga papastërtitë e dukshme dhe ato të padukshme. Mevlana shprehet se syri i përlyer mund të pastrohet me anë të lotëve. Sa i bekuar është loti që derdhet për

hir të Allahut! I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut goftë mbi të, i ka kërkuar mbrojtje Zotit (xh.xh.), nga një sy që nuk qan. Po, sytë tanë duhet t'i mbajmë të pastër. Madje, duhet t'i mbajmë shumë të pastër. Këtë mund ta bëjmë duke e parë më dashuri çdo gjë që është e lejuar, duke i parë me vëmendje dhe për të marrë mësim shenjat e Zotit (xh.sh.), në tokë dhe në qiej. Gjithashtu, edhe duke e parë fjalën e Tij sublime, Kuranin Fisnik me meditim.

“Veshët tanë nuk duhet të përlyhen.” Veshët tanë mund të përlyhen duke dëgjuar gënjeshtër, përgojime, fjalë që janë mëkat, fjalë të padobishme, muzikë që përmban haram, etj. Mbrojtja e veshëve është mjaft e vështirë. Mbrojtja e veshëve mund ta detyrojë njeriun që të qëndrojë larg lagjeve të papastra. Mbrojtja e veshëve kërkon përpikëri kundrejt shokëve, lagjes, mjedisit të punës dhe kuvendeve. Allahu i Lartësuar na ka bërë paralajmërime serioze në lidhje me këtë çështje. Pastaj na ka këshilluar: “Vërjani veshin fjalës më të bukur!” Po ashtu, thotë: “Mos qëndroni në vende ku flitet keq rreth argumenteve të Allahut! Përndryshe, edhe ju bëheni si ata.” Po, shqisën e dëgjimit duhet ta mbajmë të pastër dhe të dëlirë. Këtë duhet ta bëjmë duke dëgjuar fjalë të bukura, duke dëgjuar urtësi, duke ia vënë veshin fjalës së Allahut të Lartësuar dhe duke marrë frymëzim nga ligjëratat e dijetarëve dhe njerëzve të devotshëm që janë të përkushtuar ndaj Zotit (xh.xh.).

“Zemrat dhe mendjet tona nuk duhet të përlyhen.” Papastërtia më e rrezikshme e zemrave është mohimi i Zotit (xh.xh.) dhe shirku. Prej veprave të papastra që i bëjmë me sytë, veshët, gjuhët dhe duart tona, përlyhen edhe zemrat. Edhe imajinatat dhe mendimet e ulëta bëhen shkak për turbullimin dhe përlyerjen e zemrës. Pëshpëritjet e nefsit dhe vesveset e shejtanit të mallkuar janë viruse të fshehta që e nxijnë dhe e përlyejnë zemrën. Bota e zemrës dhe e mendjes influencohet nga librat që lexon njeriun dhe nga konferencat, ligjëratat e seminarat që ai dëgjon. Nisur nga ky këndvështrim, përmbajtja e librit që lexohet dhe natyra e ligjëratës apo e seminarit që dëgjohet janë mjaft të rëndësishme, sepse “ullukët janë çift. Prej njërit rrjedh dritë, ndërsa prej tjetrit rrjedh papastërti.” Mbrojtja e botës së zemrës dhe mendjes nga papastërtitë është ndër çështjet më të vështira. Për ta realizuar këtë mbrojtje kaq të vështirë, përpjekjen e robit duhet ta shoqërojë udhëzimi dhe ndihma e Allahut Teala. Ja, për këtë arsye, më shumë se për organet e tjera, Allahut Teala duhet t'i kërkojmë ndihmë për mbrojtjen e zemrës. Kjo është edhe një urtësi e lutjes së të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, të cilën e ka bërë shpesh: *“O Allah që i ndryshon zemrat nga një gjendje në një gjendje tjetër! Mbaje / ruaje zemrën time mbi të vërtetën!”*

“Kafshatat tona nuk duhet të përlyhen.” Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë të vërtetën se kafshatat haram janë një zehir për jetën tonë shpirtërore. Për këtë arsye, të urtët kanë thënë: “Nëse dëshiron t'i ngjash Lukmanit,

duhet të bësh kujdes për kafshatën tënde.” Nijetet e singerta dhe vepra e mira shpesh janë produkt i kafshatës së pastër. Ushqimet e pijet haram dhe ushqimet hallall, por të fituara në mënyrë jo të drejtë, janë ushqime të papastra për trupin tonë. Të gjithë dijetarët na e kanë bërë të qartë se kafshata jonë duhet të jetë e pastër dhe e mirë. Abdulkadir Gejlani thotë: “Ka kafshatë që të bënë të jepesh pas kësaj bote. Ka kafshatë që të bënë të jepesh pas Ahiretit. Përveç të tjerash, ka edhe kafshatë që të drejton te Zoti (xh.xh.), i Cili është poseduesi i të dy botëve. Ka kafshatë që ta nxin dhe ta përlyen zemrën. Ka kafshatë që ta ndriçon zemrën dhe ta mbush atë me urtësi.”

“Pasuria jonë nuk duhet të përlyhet.” Fitimet e padrejta, uzurpimet, vjedhjet dhe mallrat që nuk u jepet zekati, i cili është e drejtë e të varfërve, janë pasuri e përlyer. Këto lloj mallrash nuk janë mirësi për të zotin e tyre, por fatkeqësi. Ndërsa pasuritë që fitohen me mënyra të pastra, janë mirësi të vjera për të zotin e tyre. Të qenët e pasurisë hallall apo haram, ndikon edhe në harxhimin e saj. Ndërkohë që pasuria e përlyer shpesh herë shpenzohet për vepra të përlyera, pasuria e pastër shpenzohet për punë dhe shërbime sublime ndaj njerëzve. Ne duhet ta mbajmë të pastër pasurinë tonë. Madje, duhet ta shtojmë lëmoshën dhe mirësinë, në mënyrë që ta bëjmë pasurinë tonë të pastër sa më shumë që të jetë e mundur.

Familja nuk duhet të përlyhet. Rugët nuk duhet të përlyhen. Tregjet dhe pazaret nuk duhet të përlyhen. Shteti nuk duhet të përlyhet. Vendi nuk duhet të përlyhet. Përfundimisht, kjo botë, e cila na është dhënë komplet e pastër, duhet të qëndrojë e pastër materialisht dhe shpirtërisht. Pastërtia e të gjithave këtyre që thamë më lart ka lidhje me mospërlyerjen dhe pastërtinë e njeriut. Më e pakta, ka lidhje me sundimin e të pastërve.

Të qëndruarit i pastër apo të pastruarit mund të realizohet duke bërë një jetë të lidhur me Zotin (xh.xh.), i Cili e ka njerin prej emrave të Tij “es-Selam”. Sigurisht se gjithmonë ka një formulë pastërtie që e pastron çdo papastërti. Në lidhje me këtë kontekst, Allahu i Lartësuar u ka hapur shumë dyer robërve me mëshirën e Tij. Një besim me plot bindje ndaj Allahut Teala dhe Ahiretit është një derë pastrimi. Pendimi, kërkimi i faljes nga Allahu dhe loti që derdhet për hir të Zotit (xh.xh.), janë dyer pastrimi. Përpikëria në çështjet e hallallit dhe haramit është një derë pastrimi. Abdesti, gusuli dhe tejemumi janë dyer pastrimi. Largimi i ndonjë pengese nga rruga është derë pastrimi. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja janë dyer pastrimi. Krahaskëtyrë, ka edhe me mijëra dyer të tjera për ata që dëshirojnë të pastrohen.

Së fundmi mund të themi: Në këtë botë kemi ardhur të pastër. Ne kemi një detyrë sublime e cila është: “Të shkojmë të pastër në audiencën e Allahut Teala dhe t'i paraqesim Atij një jetë të pastër e të dëlirë.” Allahu Teala na ndihmoftë të gjithëve!



Të mos përlyhesh

APO TË PASTROHESH?

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Të mos përlyhesh është ideal, por sa është e mundur një gjë e tillë? Si mund të realizohet ky ideal në këtë botë që është atdheu i mëkateve? Pyetje të tilla mund të shumohen, por e rëndësishme është përgjigja. Kur Ebu Ejub el-Ensari, radijallahu anhu'l-Bari, po ndërronte jetë, transmetohet se ka thënë: “Po ju tregoj një hadith që e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.), por që e kam mbajtur të fshehtë nga ju deri më tani. Të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam, e kam dëgjuar duke thënë: *“Po të mos bënit aspak mëkate, (Allahu do t'ju shkatërronte) dhe do të krijonte një popull tjetër që do të bënte mëkate dhe do t'i falte (pasi t'i kërkonin falje)!”*”

REALITETI NJERËZOR

Njeriu nuk mund të jetojë pa bërë mëkate, sepse njeriu është i gabueshëm. Robi nuk mund të jetë pa mangësi, por të mos harrojmë se në botën tjetër nuk duhet të shkojë me ato mëkate që ka bërë. Atëherë, çfarë duhet të bëjë ai, meqë është e pamundur të shpër-

ngulet në Ahiret pa bërë asnjë mëkat? Çfarë është e rëndësishme dhe e vërtetë: Të mos bësh asnjë mëkat, domethënë, të mos përlyhesh, apo të kërkosht falje për mëkatin e bërë, domethënë, të pastrohesh?

Në hadithin e mësipërm gjejmë përgjigjen e qartë të kësaj pyetjeje dhe të pyetjeve të tjera të ngjashme me të. Mjeshtria nuk është në mos bërjen mëkat por në rregullimin e gabimit dhe kërkimi i faljes nga Allahu Teala për faljen e mëkatit. Njeriu është krijesa e vetme që ka aftësi për ta rregulluar gabimin që ka bërë. Njeriu, i cili mund t'i rregullojë gabimet e tij në jetën e përditshme, përsëri është ballë për ballë me detyrën për të rregulluar gabimet e veta në botën e tij shpirtërore. Nga ana tjetër, Allahu Teala është mëshirëplotë. Mëshira e Tij e ka përfshirë çdo gjë dhe e ka kaluar zemërimin e Tij. Allahu Teala e pëlqen faljen. Falja e Tij shfaqet mbi mëkatarët.

Në hadithin fisnik të mësipërm vihen në pah këto të vërteta njerëzore dhe hyjnore të dyanshme. Pra, njerëzit ftohen me një sihariq të madh që të përpiqen t'i kërkojnë falje Zotit (xh.xh.), për gabimet e tyre. Nga hadithi në fjalë absolutisht nuk mund të nxirret kuptimi i inkurajimit për të bërë mëkat, domethënë,

1. Muslim, Tevbe, 9; Tirmidhi, Deavat, 98; Ahmed b. Hanbel, V/44; Tab - rani, el-Muxhemu'l-Kebir, IV/186. Ndërsa për transmetime të ndryshme që vijnë nga transmetues të tjerë mund të shik. Mustedrek, IV/246-247.

për t'u përlyer.² Përkundrazi, hadithi fisnik i inkurajon njerëzit, të cilët kanë bërë mëkat në ndonjë mënyrë apo tjetër dhe janë përlyer, për të kërkuar mëshirë nga Zoti me një shpresë të pafundme dhe për t'u penduar. Përveç të tjerash, hadithi fisnik e refuzon pesimizmin dhe trishtimin.

Ebu Ejub el-Ensariu, radijallahu anhu, ka hezituar ta transmetojë këtë hadith fisnik deri në fund të jetës së tij, ngaqë shqetësohej se njerëzit që mund ta dëgjonin atë mund të mos shfaqnin më kujdesin e duhur ndaj mëkateve duke u kapluar nga një besim i tepërt për shkak se hadithi mbart në vetvete një përgëzim shumë të madh. Ndërsa në fund të jetës e transmetoi këtë hadith, ngaqë kishte frikë prej mëkatit të fshehtës së një dijeje që e kishte mësuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.).

Feja jonë e sheh të vërtetën në çdo çështje dhe jep zgjidhje për të pasi e pranon atë siç është. Nisur nga kjo fjali, në fenë islame, e cila është feja e tolerancës, veçanërisht myslimanit nuk i lejohej që të shfaqë tolerancë ndaj gabimit të tij. Kjo e vërtetë shpjegohet kështu në një ajet fisnik: ***“Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë.”***³ Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në një hadith tjetër të tij është shprehur se myslimani duhet të mos shfaqë tolerancë kundrejt gabimit të tij duke na këshilluar në këtë formë: ***“Pas të keqes menjëherë bëj një të mirë, në mënyrë që ta fshijë të keqen e mëparshme.”***⁴

NJË E VËRTETË HISTORIKE

Kur të Dërguarit të Allahut (a.s.), i erdhi shpallja e parë, erdhi në shtëpi i emocionuar. Pasi pushoi për pak kohë, u ngrit dhe i tregoi bashkëshortes së tij të dashur për atë që i kishte ndodhur. Pastaj i shprehu shqetësimin duke i thënë: ***“Çfarë po më ndodh mua?”*** Nëna jonë Hatixhja ishte një zonjë e kulturuar po aq sa ishte edhe e pasur dhe e mirëkuptueshme. Ajo i kujtoi bashkëshortit të saj të dashur të kaluarën e tij të pastër për ta ngushëlluar,

duke iu shprehur: ***“Beto hem në Allahun se Allahu nuk të turpëron ty asnjëherë, sepse ti interesohesh për të afërmit dhe ua zgjidh hallet të dobëtëve. I do të varfrit dhe e nderon mysafirin. Njerëzit i ndihmon në rrugë të Allahut. Ti nuk di çfarë është mashtrimi dhe gjithmonë thua të vërtetën.”***⁵

Nëna jonë, Hatixhja, radijallahu anha, të kaluarën e pastër të të Dërguarit të Allahut (a.s.), e tregoi si argument për të ardhmen e tij të ndritur. Këto fjalë të saj, në të njëjtën kohë janë një shënim shumë i vlefshëm për të kaluarën e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, që u hodhën në histori. Me këto fjalë ajo pothuajse dëshiron të thotë se, të jesh një burrë me të kaluar të pastër, është shumë e rëndësishme për shërbimin shpirtëror, mirësitë dhe suksesin. ***“Një e kaluar e papastër”*** gjithmonë është një rrezik i madh për këdo. Për një të ardhme të ndritur dhe të lumtur, duhet të kesh një të kaluar të dëlirë. Me anë të kë-

tyre fjalëve, ajo po shpallte se i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte i vetmi shembull nga ky aspekt.

MUNDËSIA PËR T'U PASTRUAR

Në hadithet fisnike është njoftuar se besimi, hixhreti dhe pendimi janë rrugë të veçanta për pastrimin e të kaluarës. Në këto tri mundësi, pendimi është një rrugë pastrimi e vlefshme për çdo mysliman deri në momentin e vdekjes. E rëndësishme është që njeriu t'i rregullojë gabimet e tij pa u kapluar nga ndjenja e një ngushëllimi mashtrues duke parë gabimet e të tjerëve. Interesimi për gabimet e të tjerëve e bën njeriun që ta neglizhojë pastrimin e vetes së tij. Kjo, me plot kuptimin e saj, nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim.

Ajo që i ka hije myslimanit është përpjekja pa humbur kohë për t'i pastruar nga zemra dhe

defteri i veprave gjurmët e mëkateve, qofshin edhe të vogla duke i parë si të mëdha, sepse mëkatet e vogla që nuk u kushtohet rëndësi rriten. Ndërsa me pendim dhe kërkim të faljes nga Allahu Teala, mëkatet e mëdha zvogëlohen, madje, mund edhe të fshihen. Myslimani duhet ta dijë mirë se gjerësia e mëshirës së Krijuesit që e fal gabimin ka përfshirë çdo gjë. Për këtë arsye, këtë asnjëherë nuk duhet ta nxjerrë nga mendja për sa u përket gabimeve dhe mëkateve.

2. Ibn Melek, Mebariku'l-Ez'har, II/59.

3. Al Imran, 135.

4. Tirmidhi, Birr, 55; Darimi, Rikak, 74; Ahmed b. Hanbel, V/153, 158, 169, 228, 236; Hakim, Mustedrek, I/54.

5. Shik. Buhari, Bed'u'l-Vahj, 3; Muslim, Iman, 252.



Mos u përlyej në papastërtitë E KËSAJ BOTE

Allahu Teala na ka dërguar në këtë botë për të na sprovuar. Për këtë arsye, gjithmonë na e ka bërë të qartë se kjo botë, të cilën e ka krijuar si arën e Ahiretit, nuk është e përhershme, por se Ahireti është bota e vërtetë. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim...”** (En’am, 32) **“Kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të botës tjetër, është shumë e vogël.”** (Teube, 38) Allahu i Lartësuar në këto ajete fisnike na e tregon qartazi fytyrën e vërtetë të kësaj bote. Edhe miqtë e Allahut, mistikët, të cilët e marrin frymëzimin nga Libri ynë i Shenjtë, Kurani, vazhdimisht na e tërheqin vërejtjen që të mos zhytemi në papastërtitë e kësaj bote. Imam Rabbani shprehet në lidhje me mashtrimin e kësaj bote:

“O bir! Kjo botë është vend për t’u sprovuar. Pamjen e jashtme të kësaj bote e kanë stolitur me stoli të ndryshme. Dukjen e saj e kanë stolitur me faqe dhe mollëza të rreme. Njerëzit nga jashtë e imagjinojnë si të ëmbël, të freskët dhe të bukur, por në të vërtetë, nuk është asgjë tjetër përveçse një qelbësi që i është hedhur erë e mirë dhe një mbeturinë e mbushur plot e përplot me miza e krimba. Ajo është një mirazh dhe iluzion që pandehet se është ujë. Ajo duket si sherbet, por në fakt është helm. Fytyra e brendshme e kësaj bote është gërmadhë dhe ajo nuk është e përhershme... Ai që lidhet dhe jepet pas saj është i çmendur, i marrosur nga magjia dhe i mashtruar... (Mektubat, I. Letra e 73-të.)

Në të vërtetë, Dynjaja në vete nuk është e keqe sipas

Imam Rabbanit. Ajo që e bën atë të keqe është fakti se ne zhytemi në të duke e neglizhuar Ahiretin dhe duke e harruar qëllimin për të cilin kemi ardhur në këtë botë. Për këtë arsye, Dynjaja nuk e përlyen atë që nuk mashtrohet ndaj saj dhe që e harxhon atë në rrugën e Zotit (xh.xh.). Sipas Imam Rabbanit, këto janë një pjesë prej preokupimeve që e përlyejnë njeriun në jetën e kësaj bote dhe që e bëjnë atë ta harrojë synimin e vërtetë të tij:

“Bir! A e di ti çfarë është kjo botë? Gjërat që të largojnë nga Allahu Teala janë Dynja. Për këtë arsye, dhënia më tepër se sa duhet mbas grave, fëmijëve, pasurisë, pozitës, lojërave, argëtimeve dhe të gjitha gjërat e tjera të padobishme, janë prej Dynjasë. Edhe dija që nuk ka dobi në ahiret është prej Dynjasë... I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: **“Shenja që tregon se Allahu Teala është i zemëruar me dikë është preokupimi i tij me gjëra të padobishme dhe që nuk i interesojnë atij.”** (Tirmidhi, nr: 2324-2325.)

Për këtë arsye, asketët që kanë hyrë në rrugën e tyre shpirtërore, kanë qenë njerëzit që i kanë dhënë fjalën Allahut të Madhëruar për t’u mbrojtur nga papastërtitë e kësaj bote. Hyrja në rrugën shpirtërore, e cila realizohet duke u penduar dhe duke i lënë mëkatet, do të thotë që të pendohesh për dashurinë ndaj kësaj bote. Në lidhje me këtë çështje, askush nuk ka garanci. Kur njeriu hyn në rrugën shpirtërore, nuk do të thotë se është i mbrojtur nga çdo gjë. Dëshira për të qenë murid/nxënës, e

cila shfaqet në fillim të kësaj rruge, duhet të mbahet e gjallë deri në fund, sepse shejtani përpiket më shumë që t'i devijojë njerëzit që kanë hyrë në rrugë të drejtë. Siç kemi parë në të kaluarën apo siç shikojmë edhe në ditët e sotme, ka shumë prej atyre që hyjnë në rrugë të drejtë, por që prapë se prapë bien në devijim. Për këtë arsye, murshidët e vërtetë gjithmonë u qëndrojnë pranë muridëve që shfaqin dobësi në pendimin e tyre dhe përpiqen me gjithë qenien e tyre që t'i mbajnë ata në rrugën e drejtë. Imam Rabbani, muridin e tij, të cilit i drejtohet me dhembshuri duke i thënë: "O bir!" – e paralajmëron kështu kundrejt këtyre rreziqeve të tilla:

Sipas Imam Rabbanit, një udhëtar në rrugëtimin e tij shpirtëror e ka shumë të vështirë që ta mbrojë sinqeritetin e tij në përshpirtshmëri përdërisa të ketë miq të këqij, sepse miqtë e këqij, edhe nëse nuk e hedhin direkt njeriun në mëkate, fillojnë ta mësojnë që të përfitojë sa më shumë nga kjo botë dhe ta zhysin dalëngadalë në papastërtitë e saj. Për këtë arsye, veçanërisht në ditët e sotme, mundësia më e rëndësishme për t'u mbrojtur është përfitimi i pakët nga gjërat e lejuara.

"Bir! Duhet të largohesh nga shfrytëzimi i tepërt i gjërave të lejuara. Gjërat e lejuara duhet t'i përdorësh aq sa ke nevojë. Gjërat e lejuara duhet t'i përdorësh me qëllim që të fitosh fuqi për të adhuruar Allahun Teala. Për shembull, kur të hash diçka, duhet ta bësh nijet që të forcohesh për të zbatuar urdhrat e Allahut Teala dhe kur të vishesh, duhet ta bësh nijet që të mbulosh vendet intime dhe të mbrohesh nga i ftohti apo i nxehti. Edhe sjelljet duhet të jenë në këtë perspektivë. Të mëdhenjtë e tarikatit Nakshibendi gjithmonë kanë vepruar me madhështi dhe janë larguar prej të lejuarave aq sa kanë pasur mundësi. Përdorimi i të lejuarave aq sa është e domosdoshme, është prej madhështisë. Nëse nuk e ke këtë mirësi dhe mundësi, nuk duhet të dalësh jashtë kornizës së të lejuarave dhe nuk duhet të biesh në gjërat e ndaluara apo të dyshuara." (Mektubat, I. Letra e 73-të.)

Ndërsa një çështje tjetër që e zhyt njeriun në papastërtitë e kësaj bote janë këto lloj vesvesesh që shejtani ia bën njeriut: "Ti akoma je i ri. Kur të plakesh në të ardhmen, do të hysh në rrugën e drejtë." Imam Rabbani i rrëzon kështu këto lloj vesvesesh të shejtanit:

"Njeriu është një rob i lidhur ndaj urdhrit të zotërisë së tij. Njeriu nuk është lënë pa përgjegjësi/i lirë. Atij nuk i është dhënë leje për t'u zhytur në çdo punë që i del përpara. Prandaj le të mendojmë thellë dhe të bëhemi largpamës. Harrimi i Ditës së Gjykimit nuk të jep gjë tjetër përveçse pishmanllëk. Periudha e rinisë është koha e fitimit. Ai që është burrë, ia di vlerën kësaj kohe. Për këtë arsye, nuk e lë të shkojë dëm dhe e vlerëson atë. Ndoshta nuk e kemi risk që të jetojmë gjatë, e të plakemi. Por edhe nëse do ta kemi këtë risk, trupi ynë nuk do të ketë fuqi dhe zemra nuk do të jetë e qetë. Edhe nëse këto janë të mundura (pra, edhe nëse trupi dhe zemra do të jenë mirë), punët e dobishme nuk mund të bëhen në një kohë kur njeriu nuk e ka fuqinë e plotë. Me çfarë preteksti mund ta lësh punën e sotme për

nesër ndërkohë që sot e ke trupin dhe mendjen aktive, ndërkohë që ke edhe mirësinë që gjendesh ndërmjet prindërve (prindërit i ke gjallë), ndërkohë që nuk ke telashin për të siguruar jetesën, sepse këtë telash e mbartin prindërit dhe ndërkohë që ke mundësi e fuqi? Si mund të thuash: "E bëj nesër?" I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "*Është shkatërruar ai që thotë do ta bëj nesër.*" (Dejlemi, el-Firdevs, 2420.) Nëse punët e kësaj bote i lë për nesër dhe punët e Ahiretit i bën sot, kjo do të ishte e mrekullueshme, por nëse bën të kundërtën, do të ishte diçka shumë e shëmtuar." (Mektubat, I. Letra e 73-të.)

Sipas Imam Rabbanit, mashtrimi që kjo botë i bën njeriut është i mundur në çdo periudhë. Por, periudha e rinisë është më e predispozuar, sepse të rinjtë duke pasur shumë fuqi fizike dhe pak përvojë, janë më të lehtë për t'u mashtruar.

"Në kohën e rinisë njeriun e rrethojnë dhe e preokupojnë armiqtë e fesë, nefsi dhe shejtani. Në kohën e rinisë edhe pak ibadet është shumë i vlefshëm. Ibadetet e shumta që bëhen në moshën e thyer nuk kanë kaq shumë vlerë. Sipas rregullave të ushtrisë, edhe një lëvizje apo përpjekje e vogël e ushtarëve është shumë e vlefshme kur armiku të rrethon dhe të sulmon. Ndërsa në paqe dhe në kohë sigurie nga sulmi i armikut, kjo lëvizje apo përpjekje nuk ka kaq shumë vlerë."

Nëse nuk dëshirojmë të humbasim nëpër tunelet e errëta të kësaj bote, asnjëherë nuk duhet ta harrojmë qëllimin për të cilin jemi dërguar në këtë botë. Asnjëherë nuk duhet ta nxjerrim nga mendja se veprat si të ngrënët, të pirët, fjetja etj., që i bëjmë çdo ditë, nuk janë qëllim, por mundësi për të arritur te qëllimi ynë sublim:

"Bir! Njeriu, i cili është përmbledhja dhe thelbi i të gjitha krijesave, nuk është krijuar vetëm për t'u argëtuar, për t'u dëfryer, për të ngrënë, për të pirë dhe për të fjetur. Përkundrazi, ai është krijuar për të kryer detyrat e adhurimit kundrejt Allahut Teala, domethënë, për t'u bindur me modesti dhe duke shfaqur dobësinë e tij ndaj Zotit (xh.xh.), për t'u strehuar dhe për t'u përgjyruar Atij. Të gjitha adhurimet për të cilat na ka njoftuar i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), janë gjëra të dobishme pikërisht për njerëzit, sepse asnjë ibadet nuk ka dobi për Allahun e Lartësuar. Për këtë arsye, ibadetet duhet t'i kryesh me gjithë zemër."

Këtë letër të gjatë të Imam Rabbanit, e cila përfshin aventurën e njeriut në këtë botë dhe këshillat e Imamit rreth rikthimit të njeriut shëndoshë e mirë në vendin nga ka ardhur, dëshirojmë ta ndajmë edhe në numrat e ardhshëm me lexuesit tanë të nderuar. Për fat të keq, në ditët e sotme shumë prej mistikëve nuk ia kanë dalë mbanë kësaj çështjeje. Si rezultat, këtë rrugë të bukur e kanë shfrytëzuar për punët e tyre të kësaj bote. Kjo përryerje dhe instrumentalizim i fesë është parë edhe te lëvizjet e tjera fetare. Për këtë arsye, i lutemi Allahut (xh.xh.), që të na mbrojë nga papastërtitë e jetës së kësaj bote dhe të na mundësojë të përfitojmë nga kjo botë pa e futur atë në zemrat tona! Amin!

Esenca e fshehtë e ibadeteve

Rabia Brodbeck

Suneti/tradita e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është fuqia më e madhe dinamike në gjithësi. Vetëm kur Kurani Fisnik të bashkohet me Hadithin dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), del në pah udhëzimi më i madh dhe drita e udhëzimit. Kjo do të thotë se të gjitha sjelljet, veprat, ibadetet dhe fjalët e besimtarëve duhet të mbështeten te Kurani dhe Suneti. Kjo gjendje është begatia e të jetuarit në rrugën e drejtë me bukurinë dhe përsosmërinë hyjnore të rrugës së Muhamedit, alejhi's-selam. Feja e vërtetë ka triumfuar me Hatemu'l-Enbija, Muhamedin (a.s.), e vërteta është ndarë nga e pavërteta dhe është ndërtuar rruga madhështore e siratu'l-mustekim. Ky është thesari i Umetit të Muhamedit (a.s.) dhe ftesa e tij për në përpjekjen në rrugën e vërtetë të Allahut Teala.

Siratu'l-mustekim është një rrugë në të cilën njeriu bëhet pluhur, rob dhe kurban. Kjo rrugë është rruga në të cilën njeriu bëhet pluhur i këmbës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për të gjithë universin, dhe rruga në të cilën ndiqet Pejgamberi (a.s.). Kjo rrugë është mbi njeriun. Kjo rrugë është rruga e njerëzimit. Kjo rrugë është rruga e përpjekjes. Kjo rrugë është rruga e lumturisë dhe flijimit. Kjo rrugë është rruga e Hixhretit. Kjo rrugë është rruga e Haxhit. Kjo rrugë është rruga në të cilën i përgjerohe mi Krijuesit tonë: "Ijjake na'budu ve ijjake nestain / Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." Kjo rrugë është rruga e përkujtimit, rruga e lutjes dhe rruga e adhurimit. Kjo rrugë është rruga e bindjes. Kjo rrugë është rruga e dashurisë së nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Kjo rrugë është rruga e përgjërimit. Kjo rrugë është rruga e bukurisë, e përsosmërisë, e pafundësisë, e vazhdimësisë, e dritës dhe e dashurisë së përhershme. Kjo rrugë është rruga e qetësisë, bujarisë, mirësisë, nderimit dhe virtytit

të përhershëm. Kjo rrugë është rruga e dëlirësisë së zemrës dhe shpirtit. Kjo rrugë është rruga e sakrificës. Kjo rrugë është rruga e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i cili nuk dinte shkrim e këndim. Kjo rrugë është siratu'l-mustekim. Siratu'l-mustekim përfaqëson moralin e Muhamedit (a.s.). Kjo rrugë është rruga e dritës. Kjo është drita e emrave dhe attributeve të Allahut Teala. Kjo është drita e besimit. Kjo është drita e siratu'l-mustekimit, e cila është rruga e fitimit, e nderit dhe krenarisë. Kjo dritë është e hapur ndaj çdo individi që hyn me sakrificë në rrugën e të vërtetës. Kjo dritë buron nga dija e modestisë. Kjo është drita e udhëzimit hyjnor. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **“...Juve ju erdhi prej**

Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kurani).” (Maide, 15) Kjo rrugë është

një ftesë hyjnore për Miraxh, për të hyrë në Xhenet dhe për të fituar miqësinë me Zotin (xh.xh.). Kjo rrugë është esenca e fshehtë e të gjitha adhurimeve. Kjo rrugë nuk ka fund. Dija, bukuria dhe përsosmëria e Allahut Teala nuk kanë fund. Dashuria, bukuria, mëshira dhe dhembshuria e Allahut (xh.xh.), nuk kanë fund. Asnjë gjë që transmetohet në udhëtimin tonë shpirtëror nuk është një mësim i thatë historie apo grimcë e pavlefshme dijeje. Skena në të cilën janë vendosur dijet është e gjitha e gjallë. Ne mund t'i ndjekim gjurmët e asaj tradite të ndriçimit shpirtëror që vazhdon në formë zinxhiri.

Lindja e njeriut në këtë botë është ftesë për të rru- ga e drejtë, domethënë, për të siratu'l-mustekim. Të gjithë njerëzit lindin myslimanë dhe si Umet i Mu- hamedit (a.s.). Njerëzit në botën perëndimore janë të privuar nga identiteti i besimit të vërtetë dhe për këtë arsye, lindin të painformuar për rrugën e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam. Po ashtu, shumë njerëz që lindin myslimanë nuk e veshin petkun e Islamit. Për këtë arsye, nuk e kuptojnë dot siratu'l-mustekimin. Nëse njerëzit nuk e kuptojnë siratu'l-mustekimin, nuk kanë bërë gjë tjetër përveçse kanë devijuar nga rruga e drejtë. Në këtë mënyrë, humbin në pavetëdijen e errësirës. Veça- nërisht myslimanët duhet të zgjohen nga gjumi i

shkujdesjes dhe ta kuptojnë madhësitinë sublimë të siratu'l-mustekimit. Të kuptuarit e kësaj është të kuptuarit e moralit të Muhamedit (a.s.). Mevlana Xhelaleddin Rumi, flet për gjendjen e atyre që do të hidhen në Xhehenem dhe do t'i përgjërohen Allahut Teala jo për të hyrë në Xhenet, por për t'u kthyer në këtë botë. Mevlana thotë: “Banorët e Xhehenemit janë më të kënaqur aty se sa në këtë botë, sepse tashmë e njohin Allahun. Ndërsa në këtë botë nuk e njohnin Atë. Asgjë nuk është më e ëmbël se njohja e Allahut. Për këtë arsye, ata kërkojnë të kthehen në këtë botë për të bërë vepra që t'i kuptojnë gjërat në të cilat shfaqen bukuritë dhe mirësitë e Allahut.” (F 229/236) Mevlana Xhelaleddin Rumi, me këtë

urtësi madhështore, ia tregon të gjithë njerë- zisë se si ndryshon çdo gjë kur në zemrën e njeriut hyn Allahu i Madhëruar.

*Ijjake na'budu ve
ijjake nestain / Vetëm
Ty të adhurojmë dhe
vetëm prej Teje ndihmë
kërkojmë.” Kjo rrugë
është rruga e përkujtimit,
rruga e lutjes dhe rruga
e adhurimit.*



Allahu Teala gjithmonë na fton që të përpiqemi/luftojmë në rru- gën e vërtetë. Allahu Teala na thë- rret që të shohim bukurinë e për- hershme të thesareve të krijimit.

Ai na fton te admirimi, dashuria dhe frymëzimi hyjnor. Thirrja, ftesa dhe paralajmërimi i Zotit (xh.xh.), përfaqëson zgjimin nga shkujdesja dhe daljen në dritën e dijes hyjnore, dome- thënë, udhëzimin e vërtetë. Të gjithë ne duhet të zgjohe- mi nga gjumi i neglizhencës dhe duhet të përpiqemi për të jetuar Miraxhin e vërtetë. Be- simin tonë duhet ta freskojmë dhe rinovojmë. Dashurinë për besimin, që e kemi në zemër, duhet ta rigjallërojmë. Shkur- timisht, ne duhet të heqim

dorë nga çdo lloj dashurie që nuk është për hir të Allahut Teala. Verbëria shpirtërore, shkujdesja dhe injoranca janë gjendje që shfaqen vetëm te ata që nuk kanë dashuri hyjnore. Të bësh një jetë të shkujdesur, nuk do të thotë se ke dije të mangët, por do të thotë se ke mangët ndjenjat ndaj urdhrave hyjnore dhe nevojën për Zotin (xh.xh.). Mevlana thotë se kjo botë, në një aspekt, është një mohim dhe refuzim i të vërtetës hyjnore: “Shkaku që jemi të lidhur fort pas kësaj bote është fakti se jemi të shkujdesur nga audienca hyjnore. Pra, shkaku nuk janë paratë, gratë apo rrobat. Këtë kuptojë mirë!” Kur njeriu të humbasë në këtë botë dhe në joshjen e saj, largohet nga Allahu i Madhëruar dhe bëhet

rob i pasioneve të tij e lodër në dorën e shejtanit të mallkuar. Për këtë arsye, Mevlana Xhelaleddin Rumi i fton njerëzit për të dalë nga burgu i pasurisë. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kush preferon këtë botë kundrejt botës tjetër, do të ketë vështirësi prej tri gjërash: Një peshë të rëndë që nuk lehtësohet asnjëherë, një varfëri që nuk pasurohet dhe një uri të pangopshme.”* Të Dërguarin e Allahut (a.s.), e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! Cilat janë ato gjëra që na zhysin në këtë botë?” I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, u përgjigj: *“Çdo gjë që të zhyt në shkujdesje dhe të bën ta harrosh Zotin.”* Dashuria ndaj kësaj bote përfaqëson egoizmin, mendjemadhësinë, shirkun, injorancën dhe humbjen. Dashuria ndaj kësaj bote e largon njeriun nga dashuria për Zotin e botëve, nga Feja, Agjërimi, Lutja, nga Haxhi, Miraxhi, Ihrami, Xhihadi, nga Siratu'l-Mustekimi dhe nga Sexhdeja. Dashuria ndaj kësaj bote është largim nga Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe mangësi e bukurisë, dashurisë e dritës. Me një thënie tjetër, një njeri që jeton duke mos qenë i vetëdijshëm, e harron orientimin e duhur, devijon nga rruga e drejtë, heq dorë nga e vërteta dhe zhytet në të pavërtetën. Shkurtimisht, humb veten e tij.

A nuk do të jetonim në siratu'l-mustekim nëse do të arrinim të ishim koshientë se jeta jonë është një udhëtim shpirtëror? A nuk do të ishim në siratu'l-mustekim nëse do ta sakrifikonim veten tonë për Zotin (xh.xh.), në pazarin e Ahiretit? A nuk do të ishim gjithmonë në siratu'l-mustekim nëse do të shpëtonim nga shirku? A nuk do të bënim një jetë në siratu'l-mustekim nëse do t'i shërbenim fesë së tevhidit? A nuk do të bënim një jetë në siratu'l-mustekim nëse do ta mbartnim amanetin e shenjtë dhe nëse jeta jonë do të ishte provë për Ahiretin?

Sa më shumë të shkojmë pas së vërtetës në siratu'l-mustekim, sa më shumë të kthehemi te atdheu ynë i vërtetë, sa më shumë që të hyjmë në ihram, sa më shumë të bëjmë sexhde në siratu'l-mustekim, sa më shumë që ta ndryshojmë veten, sa më shumë që të bëhemi skllav, jetim, emigrant dhe rob në audiencën e Allahut Teala, sa më shumë dashuri ta vazhdojmë përpjekjen, nëse vdesim para se të vdesim, po aq do të na gjallërojë edhe Allahu Teala në të vërtetën dhe do të na bëjë besimtarë të devotshëm. Sa më shumë që të kemi vështirësi, sa më shumë që të luftojmë dhe sa më shumë që të sprovohemi në siratu'l-mustekim, po aq do të bëhemi njerëz, besimtarë, robër dhe mëkëmbës të vërtetë.

E vërteta nuk jepet pa një kundërvlerë. Ne si besimtarë gjithmonë dhe në çdo vend duhet të rendim pas së vërtetës. Në jetën e kësaj bote duhet ta lëmë çdo gjë dhe të arratisemi. Në Kuranin Fisnik thuhet: “Shkoni te Allahu, vraponi te Allahu!”

Ata që i besojnë tevhidit hyjnor duhet të ecin drejt vulës së profetëve, të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke filluar që nga gjurmët e këmbëve të Ibrahimit (a.s.). Hapat e tyre duhet t'i hedhin sipas hapave të Pejgamberit tonë të nderuar. Besimtarët duhet ta dinë se në të njëjtën kohë janë edhe pasuesit e Ibrahimit (a.s.) dhe si nxënës të Muhamedit (a.s.), asnjëherë nuk duhet ta nxjerrin nga mendja dhe vetëdija e tyre të vërtetën se të gjithë njerëzit janë fëmijët e Ademit (a.s.). Pasuesit e Muhamedit (a.s.), mbartin mbi supet e tyre trashëgiminë e të gjithë pejgamberëve. Kjo trashëgimi është adhurimi i Allahut të Lartësuar. Ata janë mëkëmbësit e Allahut (xh.xh.), në këtë botë. Prandaj, le të luajmë rolin e tyre. Le t'i kapim duart që arrijnë deri te i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, sepse, të urtët kanë thënë: “Dorë për dore mund të arrijmë te Zoti (xh.xh.).”

Nëse i besojmë tevhidit, ia kemi borxh Allahut Teala përkushtimin në rrugën e vërtetë. Ia kemi për borxh Allahut që të shkojmë në gjurmët e atyre që kanë rënë dëshmorë në rrugën e vërtetë. Ia kemi borxh Allahut Teala që ta ndjekim Bilalin (r.a.), i cili thoshte pa reshtur “Ehad, Ehad!” nën torturat e padurueshme përgjatë netëve dhe ditëve të tëra. Ia kemi borxh Allahut që të mos frikësohemi nga vdekja dhe të ecim në rrugën e vërtetë duke i kryer detyrat e robnisë ndaj Tij. Ia kemi borxh Allahut Teala që t'i posedojmë cilësitë si devotshmëria, sinqeriteti dhe besnikëria. Ia kemi borxh Allahut të Madhëruar që ta shfaqim dashurinë tonë ndaj Tij siç e shfaqti Habili duke derdhur gjakun e vet. Mësimet që duhet të marrim nga dëshmorët e Islamit, të cilët e ndriçojnë botën me nurin e tyre, duhet të na nxjerrin nga errësira e shkujdesjes. Ata e dhanë jetën e tyre, në mënyrë që ne të shikojmë, të zgjohemi, të kuptojmë dhe të gjejmë dritën e udhëzimit nga urtësitë e Kuranit Fisnik. Për këtë arsye, le ta vendosim veten tonë në vend të atyre, të luftojmë aty ku kanë luftuar ata, të lutemi aty ku janë lutur ata, të ecim aty ku kanë ecur ata, të ecim siç kanë ecur ata, të qajmë aty ku kanë qarë ata dhe t'i përgjërohemi Allahut Teala, i Cili është Zoti i botëve, siç i janë përgjëruar ata.



Lutja

Adem Çelikkaja

Lutje do të thotë që ata të cilët kanë nevojë për çdo gjë apo që i kanë nevojat e pakufishme, t'ia shprehin vështirësinë dhe gjendjen e atyre Atij që nuk ka nevojë për asgjë me anë të gjuhës dhe sjelljeve të tyre. Lutja nuk duhet të shikohet si një porosi për dikë. Zoti (xh.xh.), jep përgjigje të shumanshme dhe të thella, por jo sipas horizontit tonë të ngushtë. Ajo që kërkohet në lutje është vetëdija për dobësinë tonë dhe shprehje e hallit sipas rregullave të kërkimit duke besuar se patjetër do të merret përgjigje. Pritja e pranimit të lutjeve një për një siç i kemi bërë mund të jetë në kundërshtim me të vërtetën që Allahu Teala di çdo gjë dhe bën atë që dëshiron, sepse kaderi i njeriut nuk do të realizohet sipas atyre që kërkon, por në lidhje me sjelljet e tij, në dashtë Allahu (xh.xh.). Pritja e rezultatit pa u kapur siç duhet pas shkaqeve dhe shprehja e hallit me gjuhë duke mos vepruar, nuk përputhen me shpirtin e lutjes, por, nëse Allahu i Madhëruar dëshiron të krijojë pa shkaqe, këtë nuk mund ta ndalojë askush.

Lutja, krahas trokitjes në derën ku do të realizohet kërkesa jonë, shfaq madhësitinë e të zotit të asaj dere. Gjithashtu, tregon edhe besimin tonë se Allahu Teala e di dhe e bën çdo gjë siç duhet. Lutje do të thotë të pranosh pafundësinë e mëshirës së Allahut (xh.xh.) dhe të presësh çdo gjë nga Ai. Ato që ndjejmë në zemër është e pamundur t'i fshehim nga Allahu Teala. Ai e di çdo gjë, por ajo që na takon neve për të bërë është qëndrimi te dera e Tij, sado që të jemi mëkatarë duke e kuptuar dobësinë tonë. Lutje do të thotë që të kërkojmë me gjithë qenien tonë, me sinqeritet të plotë dhe me besimin se një ditë do marrim përgjigje nga ajo derë duke mos u mërzhitur për asnjë moment.

Lutja është esenca e adhurimeve. Në lutje flasim direkt dhe pa ndërmjetësim me Zotin (xh.xh.). I Dërguari i Allahut (a.s.), gjyshërit dhe të mëdhenjtë tanë kanë bërë konsultime duke filluar që nga punët që hapën e mbyllën shekuj e deri te ato më të voglat. Pasi morën masat, iu drejtuan asaj dere me përgjërim. Ata u lutën pa ndërprerje dhe ia lanë në dorë Allahut Teala punët e tyre. Sa më shumë të luteshin, aq më shumë iu afruan Allahut të Lartësuar. Sa më shumë iu afruan Allahut Teala, aq më shumë i bënë lutje, sepse ata e kuptuan shumë qartë se asgjë nuk mund të bëhet pa thënë Allahu Teala: “Bëhu!”

Edhe ne si myslimanë që përpiqemi të shkojmë në rrugën e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, edhe pse duke u zvarritur dhe që e konsiderojmë këtë si mirësinë më të madhe, natën duhet ta bëjmë ditë, detyrat dhe shërbimet tona duhet t'i kryejmë me rigorozitet, të shkojmë te dera e Atij (xh.xh.), me një frikë-respekt dhe dëlirësi të madhe dhe të mos ndahemi asnjëherë nga aty duke thirrur: “O Zoti ynë! O Zoti ynë! O Zoti ynë!” Kur t'i lutemi Zotit (xh.sh.), nuk duhet të parashtrojmë vetëm kërkesat tona, por duhet t'ia parashtrojmë Atij edhe gjendjen e familjes, fqinjëve, kolegëve, vendit, krahinës dhe të të gjithë Umetit të Muhamedit (a.s.). Gjithashtu duhet t'i kërkojmë që të na japë bashkim e unitet, shëndet, mirësi dhe vetëdijesim. Kur t'ia parashtrojmë Allahut Teala këto kërkesa, nuk duhet të kemi kujdes nëse fjalët tona thuhën me elokuencë, por nëse thuhën apo jo me sinqeritet.

Ja Malike'l-Mulk! Ja Erhame'rr-rrahimin! Ja Rabbe'l-Alemin! Bashkoi të gjithë myslimanët, na pastro nga mëkatet, na largo prej rrugëve që na shpien në errësirë dhe na ndero në të dyja botët! Amin!..



LARG ALKOOLIT, LARG DROGËS! RUAJUNI NGA MALLKIMI I ZOTIT!

Muhamed B. Sytari

TË DASHUR DHE TË SHTRENJTË, RINIA E JONË BESIMTARE,

Kam dëshirë që këtë mesazh ta zhvilloj në formën e një bashkëbisedimi me maturantët e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër, si dhe ata të krejt trojeve shqiptare, në kuadër të sensibilizimit të opinionit publik, komunitetit dhe bashkësisë myslimane në lidhje me përhapjen në masë të disa fenomeneve dhe veseve të dëmshme për individin dhe shoqërinë.

Që në krye të herës, ne si myslimanë jemi të ftuar si besimtarë, të distancohemi totalisht nga krejt ndalesat hyjnore, të qartësuara në Kuranin Famëlartë dhe në hadithet e Muhammedit (a.s).

Allahu i Madhëruar i tërheq vëmendjen të dërguarit të Tij dhe mbarë njerëzimit, kur thotë: “Thuaj: “Zoti im i ndaloi të këqijat e turpshme, qofshin të hapëta ose të fshehta, ndaloi gjynahun, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t’i mvishni Allahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thoni

për Allahun atë që nuk e dini se është e vërtetë!”¹, sikurse dëshmon për besimtarët, se, “...ata që iu shmangën mëkateve të mëdha e të shëmtuara...”²

TË DASHURIT E MI,

Të gjithë ne, po ndjekim prej vitesh me shqetësim të madh përhapjen në masë të alkoolit, duhanit, basteve, të quajturave “lojëra të fatit”, kumarit, shthurjes morale, divorceve për shkak të dhunës në familje, tradhtive bashkëshortore, degradimit të moralit dhe zhdukjes së turpit nëpërmjet keqpërdorimit të rrjeteve sociale, si fb, instagram etj., si dhe së fundi, përhapja në masë e mbjelljes, kultivimit dhe përhapjes së bimëve narkotike dhe drogërave të ndryshme, që po kthehen në një gangrenë të dhunshme për shoqërinë shqiptare, rininë në veçanti!

Nga pozita e Myftiut të Zonës Shkodër dhe në emër të Myftinisë Shkodër, ftoj të gjithë besimtarët myslimanë dhe bashkëqytetarët e mi, rininë e shtrenjtë

1. A'rafë: 33.

2. Shura: 37.

në veçanti, të distancohen nga krejt sa përmenda më lart, sepse konsumimi i duhanit, alkoolit (me krejt llojet e tij), drogërave, është shkaktar i dëmeve të pallogaritura morale, shëndetësore, ekonomike, sociale, por jo vetëm!

Njëkohësisht, tërheq vëmendjen e krejt besimtarëve dhe bashkëqytetarëve të mi për të mos e humbur kohën, shëndetin dhe pasurinë e hallallit pas bixhozit, basteve, kazinove, sepse nuk është në natyrën e myslimanit dhe besimtarit, frekuentimi i vendeve ku shkelet fjala e Zotit, ku dëmtohet familja, ku prishet morali, ku njeriu kthehet në skllav i shejtanit të mallkuar, epsheve dhe kapriçove, tekave dhe errësirës!

TË DASHUR BESIMTARË, BASHKËQYTETARË TË SHTRENTJË,

Në Kuranin Famëlartë, All-llahu Më-shirëplotë urdhëron: “O ju që besuat, s>ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, **largohuni** prej tyre që të jeni të shpëtuar! Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të mbjellë armiqësi mes jush, t>ju pengojë nga të përmendurit e Allahut dhe t>ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”³

Sa e sa lokale, restorante dhe kafene janë përhapur gjithandej në qytetin tonë, ku fatkeqësisht gjen me dhjetëra e qindra lloje pijeesh alkoolike të ekspozuara në vitrina e nëpër menu?! (Më ka rastisur ta pyes një të ri mysliman, që mbante në lokalin e tij pije të ndryshme alkoolike. Me shumë siklet ma ktheu: “Hoxhë, ne s'e pimë alkoolin, por na duhet patjetër se e kërkojnë njerëzit!” - Po ajo që kërkon Zoti, është më pak e vlefshme, sesa dëshirat e paekuilibruara të njerëzve?!)

Sa e sa trotuare janë zënë nga tavolinat, prej ku kutërbon era e alkoolit dhe e duhanit, me të cilin përballen ditë pas dite fëmijët, rinia, gratë, të moshuarit, studentët dhe krejt kalimtarët e dhunuar në hapësirat e tyre publike?

Sa herë na ka ndodhur të përballemi me festa publike alkooli, përpara institucioneve më të rëndësi-

shme të qytetit tonë, prej ku, në fakt duhet të dalin udhëzime dhe ndërmarrje konkrete për disiplinimin e kësaj krahore sociale, që po i merr frymën qytetit dhe po infekton rininë tonë me veset më të liga!

Sa e sa gëzime familjare, tryeza drekash e darkash, pritjesh e nderimesh, deri protokollare, janë të mbushura me pije alkoolike, ndërkohë, në mbarë botën përgatiten programe konkrete për luftën kundër alkoolit, drogës, hashashit, duhanit etj?!

MË LEJONI TË SJELL CA STATISTIKA NGA BURIME TË BESUARA DHE TË DOKUMENTUARA:

“Mbi 90% e amerikanëve e konsumojnë alkoolin, ndërkohë, 40-50% e burrave atje goditen nga problem shëndetësore, si pasojë e dehjes, ndërsa 10% e burrave dhe 3-5% e grave janë të alkoolizuar”⁴

Ndërkohë: “Humbjet e përgjithshme, si pasojë e problemeve të lëndëve dehëse në Amerikë, arrijnë shumën e 136 milion dollarëve në vit. Poashtu, ekspertët theksojnë se ¼ e rasteve të shtrimeve në spitalet amerikane ka si pasojë konsumimin e alkoolit”⁵

Ndërkohë, në vitin 1924, nëpërmjet revistës “Zani i Naltë”, mësojmë se: “Sot, luftimi më i math moralisht është kontra pirjeve... Më 1900 nga Shtetet e Bashkume vetëm pesë e ndalunë... kur erdhi moti 1919, sasija e shteteve pirje-ndaluse kapi numrin 32”.

⁶ Madje, autori thekson se: “Në kohët e luftës se përgjithçme, Luid Xhorxhi ka thënë: “Na po luftojmë me Gjermaninë dhe me Austrinë, edhe me alkoolin, por lufta e alkoolit është më e madhja!” Brezi i ri, sa luftojnë me fenë, nuk do të ishte më mirë të luftojmë me alkoolin?...”⁷

Në vitin 2009 isha në ShBA. Mësova se, në një numër të madh shtetesh amerikane, ndalohet me ligj konsumimi i alkoolit në ambiente të hapura, siç ndodh rëndom në vendin tonë!

4. Dr. Hassan Sh. Basha, “Ettibaul-garb juhaddirune min shurbil-khamr”, botimi I, Damask, 1991, f. 9. (Autori është anëtar i Fakulteteve Mbretërore të Mjekëve në Britani dhe i asaj në Irlandë).

5. Po aty, f. 11.

6. H. ALI, “Të ndryshme përmbi moralin”, në revistën “Zani i Naltë”, nr. 10, korrik 1924, viti I, f. 344.

7. Po aty, f. 345.

3. Maide: 90-91.



Me dhimbje, Hafiz Ali Korça pyeste: “Shohim një njeri që nuk qit në muajt 100 fr.ari, ku i gjen qi prish ndë natët (pra, për çdo natë), 2-3 fr.ari vetëm për pije?”⁸ Po sot, tek ne? Zoti e ndaftë me hajr këtë katastrofë!

TË DASHURIT E MI,

Resulullahu (a.s.) ka thënë prerazi: “All-llahu e ka mallkuar pijen dehëse, edhe atë që e konsumon (duke e pirë), edhe atë që e shërben, edhe shitësin e saj, edhe atë që e blen atë, edhe atë që e shtrydh atë, (duke e përgatitur për fermentim etj.), edhe atë për të cilin shtrydhet, edhe atë që e bart atë, edhe atë që i shërbehet (duke u bartur arkat e alkoolit, si pronarëve të lokaleve e ngjashëm) dhe atë që ushqehet nga frutet e kësaj pune”⁹

Vetëm nëpërmjet këtij hadithi, kuptohet qartë se si trajtohen pijet dehëse në Islam! Zero tolerancë, zero hapësirë, zero mundësi! Prandaj, sërish ftoj krejt besimtarët myslimanë, rininë tonë në veçanti dhe krejt bashkëqytetarët tanë: LARG ALKOOLIT, LARG DUHANIT, LARG DROGËS! RUAJUNI NGA MALLKIMI I ZOTIT!

TË DASHUR DJEM TË RINJ,

“Është përhapur në mesin e mjekëve dhe njerëzve në përgjithësi në perëndim (edhe tek ne), mendimi që thotë se, konsumimi i një sasi të vogël alkooli (sidomos e verës së kuqe), e pakëson përqindjen e vdekjeve nga ataku kardiak. Por, një studim i publikuar qysh në vitin 1987 në revistën mjekësore britanike, “Lancet”, e ka mohuar këtë pretendim, sa vijon: “Pretendimi i disa mjekëve se, alkooli mund

të jetë i dobishëm, nëse nuk konsumohet në sasi të vogla, është krejtësisht gënjeshtër dhe shpifje!”¹⁰ Pastaj, autori i këtij studimi, konkludon, se: “Fjala përfundimtare është se, krejt mjekët e kanë për detyrë ta përhapin në mesin e njerëzve këtë mesazh: Alkooli është i dëmshëm për shëndetin!”¹¹

NË PËRFUNDIM,

Më lejoni të ndalem për fund tek kultivimi dhe konsumimi i bimëve dhe lëndëve narkotike, një shfaqje e frikshme në rritje, në realitetet shqiptare dhe ato globale.

[Të gjithë juristët myslimanë kanë patur qëndrim unanim kundër të këqijave që përhapeshin në kohën e tyre... Shejhul-Islami Ibn Tejmije thotë: “... E keqja e tij (e hashashit) është më e rrezikshme se konsumimi i pijeve dehëse (alkoolit). Njerëzit filluan ta përdorin (hashashin) pas ardhjes së tatarëve...”]¹²

“Hashashi e deh përdoruesin e tij dhe ia dobëson forcat, madje ai sjell edhe dëme të tjera, përtej dëmeve të pijeve dehëse, gjë që obligon ndalimin e tij (bërjen haram). Vartësia ndaj tij trashëgon mungesën e xhelozisë dhe eliminimin e ndjesive të krenarisë individuale! Ai i prish temperamentet njerëzore, saqë shumë prej përdoruesve të rregullt të tij, çmenden. E kush shpëton nga çmenduria, goditet nga dobësimi i mendjes. Ai i përfton përdoruesit të tij përçmim e poshtërim, ndërkohë dëmet e tij në organizmin njerëzor janë më të rënda sesa ato të pijeve dehëse. Prandaj, vendimi ndaj sasisë së vogël a të madhe të hashashit, është njësoj si sasia e vogël a e madhe e

8. Po aty, f. 315.

9. Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Hakimi.

10. “Lancet”, 1987, II, f. 1249.

11. Po aty. Të shihet: Dr. Hassan Sh. Basha, “Ettibaul-garb juhadrhirune min shurbil-khamr”, botimi I, Damask, 1991, f. 24-25.

12. Dr. Jusuf El-Kardavi, “Hallalli dhe harami në Islam”, përkth. në shqip nga Muhamed Mustafa, Tiranë, 2000, f. 65.



verës (a pijeve të tjera dehëse)...

Në medhhebin hanefi përdorimi i hashashit dhe opiumit është haram, por jo në formën e ndalimit të pijeve dehëse, forma e ndalimit e të cilave është kategorike (me ajet të qartë kuranor dhe hadithe të sakta) dhe del feje mohuesi i saj...

Ndërkohë, hanefitë dhe shafitë janë një mendje në saktësinë e divorcit të dikujt që ka humbur mendjen si pasojë e përdorimit të fletëve të kanabisit, pasi fetvatë e tyre e ndalojnë (haram) përdorimin e tyre..."¹³

Pa dyshim, "shteti më i madh që konsumon lëndët narkotike, sipas statistikave të OKB, është SHBA, pasuar nga Gjermania. 60% e drogërave të botës hidhen në ShBA, ndërsa 60 miliard dollarë shpenzohen për çdo vit për trajtimin dhe shërimin e të drogëuarve atje.

Mund ta kuptojmë fare thjeshtë përmasën e trajgjedisë së konsumimit të drogërave, duke ndjekur statistikën e përqindjeve të vdekjeve në mesin e konsumuesve të tyre, sa vijon: Italia: 30%, Zvicra: 22%, Gjermania Perëndimore: 44%, SHBA: 51%... shifra që sa vijnë në rritje... Edhe në Francë ka me mijëra të drogëuar, ndërkohë atje po shfaqet përherë e më shumë përhapja e drogërave në mesin e studentëve në përgjithësi dhe adoleshentëve në veçanti".¹⁴

Ndërkohë, ajo që na dhemb më së shumti është përhapja e frikshme e kultivimit të hashashit dhe përhapja e drogërave në mesin e të rinjve shqiptarë. Nëse faktet dhe argumentet e përhapura kohëve të

fundit në mediat e ndryshme të shkruara dhe vizive shqiptare, janë të vërteta, atëherë, ky është një alarm kombëtar, që duhet të na shqetësojë të gjithëve!

Në publikimet e lajmeve të datës 22 tetor 2016, "Zëri i Amerikës", shkruan se: "Në Shqipëri policia po vazhdon një operacion të gjerë në zona të ndryshme të vendit, nga Veriu në Jug, kundër trafikut të marijuanës... Në total gjatë ditës së djeshme deri në mbrëmje u sekuestruan mbi 1.3 ton lëndë narkotike, ndërsa janë asgjësuar rreth 8 mijë bimë cannabis sativa e mbjellë ose në proces tharjeje..."¹⁵

"Superoperacioni, Specialët kapin 1.3 ton hashash, asgjësohen 7650 rrënjë kanabis"¹⁶, shkruan një e përditshme e kësaj date.

Në mënyrë kategorike, ne si bashkësi fetare, si besimtarë myslimanë, distancohemi nga këto fenomene, sikurse bëjmë thirrje publike për të gjithë bashkëqytetarët tanë dhe institucionet tona, që ta ruajmë vendin, shoqërinë, individin dhe familjen shqiptare nga katastrofa e drogës, pijeve dehëse, bixhozit, basteve, kazinove dhe hashashit!

Njëkohësisht ftojme bizneset mbarë, ato të myslimanëve në veçanti, të distancohen nga shitblerja dhe përdorimi i pijeve alkoolike, duhanit dhe drogërave, që sjellin vetëm dëme të shumëanëshme, harame e mallkime hyjnore!

Allahu e ruajtë rininë shqiptare, individin shqiptar, familjen shqiptare dhe na udhëzoftë nga Drita e Tij, para se të jetë vonë e të meritojmë ndëshkimin e Tij në këtë botë para të përtejmes! Allahumme Amin!

13. Me përmbledhje dhe përshtatje nga: Shejkh Muhammed Hasenejn Makhluf, "Fetava sher'ijje ve buhuthun islamijje", botimi i 2-të, Egjipt, 1965, vëll. 2, f. 110-112.

14. "El-Mafja, Vethaikh-Shehadat-Vekaia", botimi I, Bejrut, 1989, f. 105-106.

15. Nga publikimi i lajmeve online të datës 22 tetor 2016, në portalin zyrtar të Zërit të Amerikës në gjuhën shqipe.

16. Gazeta "Dita", e shtune, 22 tetor 2016, viti IV, nr. 1407, f. 9.



Vesveset dhe RRUGËT E SHPËTIMIT

Dr. M. Selim Arëk

Vesvesi/et, në kuptimin “dyshim, hezitim, fjalë e fshehtë dhe mendime që njeriut i burojnë në mënyrë të pavetëdijshme”, janë ndjenjat që e orientojnë njeriun drejt sjelljeve të këqija, jo të lejuara fetarisht e moralisht. Për shembull, kur në Kuranin Fisnik flitet për vesvesin që shejtani ua bëri Ademit dhe Havasë, thuhet: **“Djalli u pëshpëriti, për t’ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: “Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.”** (A’raf, 20) Siç shikohet, burimi i parë i vesvesit është shejtani, sepse shejtani, duke e pasur zili mirësinë e Xhenetit që vetë s’do ta ketë, nuk e pranon dot qëndrimin e përhershëm të njeriut në të. Për këtë arsye, përpiket pa reshtur për ta mashtruar njeriun me vesvese, në mënyrë që ta nxjerrë nga Xheneti. Krahas këtyre, edhe një burim tjetër i vesvesit është vetë nefsi i njeriut. Kjo çështje shtjellohet kështu në Kuranin Fisnik: **“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij nefsi i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”** (Kaf, 16) Pëshpëritja, për të cilën bëhet fjalë këtu, janë ndjenjat e këqija dhe të fshehta që njeriut i vijnë nga brenda. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, ka thënë në lidhje me këtë çështje: **“Përderisa të mos shndërrohen në vepra (shirk, mashtrim etj.), ndjenjat e këqija që njeriut i vijnë nga brenda, ai nuk ka përgjegjësi për to.”** (Muslim, Iman, 201.) Në këtë mënyrë, e ka shprehur qartë se njeriu nuk bën mëkat për shkak

të mendimeve që i vijnë në mendje nga shkaqe që ai nuk i ka në dorë. Disa prej sahabëve të nderuar shkuan te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i treguan se në mendje u vinin disa fjalë e mendime, të cilat janë mëkat po të thuheshin. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha atyre se këto mendime u pëshpëriten nga djalli i mallkuar dhe se kjo gjendje buron nga besimi. Domethënë, të mendosh në mënyrë të pavullnetshme, gjëra që janë të këqija apo mëkat, nuk është mëkat përderisa ato të mos shndërrohen në vepra. Këto mendime asnjëherë nuk janë gjëra që u besohet me gjithë zemër, por janë vesvese që lindin nga pëshpëritjet e shejtanit. Vesveset janë ngacmime që shejtani i bën zemrës së njeriut dhe disa foto e pamje që ai i hedh në pasqyrën e imagjinatës së njeriut. Këto janë disa lojëra që shejtani ia bën njeriut, veçanërisht njeriut besimtar në këtë botë, sepse shejtani, si një shenjë e dobësisë së tij, përdor shigjetën e “vesvesit” kundër besimtarit të cilin nuk e mposht dot me anë të kufrit dhe devijimit. Për këtë arsye, qafiri nuk ka vesvese. Mohimi i qafirit nuk është vesves, përkundrazi është mohim i llogarit, i planifikuar dhe i mbështetur në kryeneçësi.

Djalli i mallkuar nuk mund të hyjë dot në zemrën e besimtarit, i cili i beson Zotit (xh.xh.), është i plotë nga aspekti i besimit dhe i kryen ibadetet, dhe ta hedhë atë në kufër/mohim. Ai vetëm ia turbullon

zemrën dhe përpiqet t'i prishë prehjen e rehatinë që gjen në ibadete. Nisur nga kjo që thamë, asnjëherë nuk duhet t'u japim rëndësi vesveseve në formën: "Mos vallë e bëra mangët?" – që mund të kemi përgjatë abdestit dhe namazit. Nëse një vesvese e tillë ndodh për herë të parë, atëherë, ai abdest dhe namaz mund të përsëritet. Por, nëse ndodh vazhdimisht, atëherë, abdestin duhet ta konsiderojmë të saktë sikur janë larë të gjitha pjesët e duhura dhe namazin duhet ta pranojmë si të plotë pa i dhënë vesveseve mundësinë që të na fusin në dyshime. (Shik. Mevsili, el-Ihtijar, I, 11.) Veçanërisht vesveset dhe dyshimet përgjatë abdestit dhe ibadeteve burojnë nga shejtani. I Dërguari i Allahut (a.s.), na njofton se shejtani ikën kur këndohet ezani, se shejtani kthehet pas për t'i dhënë vesvese besimtarit kur të mbarojë ezani dhe se e bën njeriun që ta harrojë sa rekatë namaz ka falur duke i hyrë atij në nefsin (zemrën) e tij dhe duke i thënë "kujtoje këtë gjë, kujtoje atë gjë". (Buhari, Ezan, 4.) Siç shikohet, shejtani mund t'i japë vesvese njeriut edhe përgjatë namazit. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, ka thënë: "Kur Umeri hyn në një rrugë, shejtani e lë atë rrugë dhe futet në një rrugë tjetër." (Muslim, Fedailu's-sahabe, 22.) Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Shoh se shejtanët prej njerëzve dhe xhindëve ikin nga Umeri." (Tirmidhi, Menakib, 18.) Me anë të këtyre haditheve fisnike, i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon besimin e Umerit (r.a.) dhe fuqinë e tij kundër shejtanit të mallkuar. Nisur nga këto që thamë më lart, besimtarët gjithmonë duhet të jenë të kujdesshëm dhe vigilentë kundër vesveseve dhe pëshpëritjeve të shejtanit.

RRUGËT E MBROJTJES NGA VESVESET

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: "**Nëse djalli përpiket të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.**" (A'raf, 200) Ndërsa i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, na njofton: "Shejtani largohet nga biri i Ademit (njeriu) kur ai e përmend Allahun." (Shik. Sujuti, Fet'hu'l-Kebir, II, 185.) Për këtë arsye, nëse dëshirojmë të mbrohemi nga vesveset e shejtanit të mallkuar, së pari nuk duhet ta neglizhojmë namazin me xhemat, i cili është dhikër i hapur. Përveç të tjerash, asnjëherë nuk duhet ta shkëpusim lidhjen me Kuranin Fisnik duke i lexuar veçanërisht suret "nas" dhe "felek". Siç e shprehëm edhe më sipër, djalli i mallkuar nuk mund të hyjë në zemrën e besimtarit që e ka besimin e saktë dhe që i kryen ibadetet, e ta hedhë atë në kufër, sepse shejtani asnjëherë nuk mund ta zërë vendin e njësimiut dhe dashurisë që besimtari ka në zemrën e tij për Allahun e Madhëruar dhe vendin e mendimit që besimtari ka në zemrën e tij për ta pa-

suar të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe për ta zbatuar traditën e tij profetike. I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka këshilluar: "**Nëse shejtani i vjen dikujt prej jush dhe i thotë: "Kush është ai që e ka krijuar këtë gjithësi madhështore dhe e ka futur në sistem? – ai i përgjigjet: "Allahu, i Cili është Zoti im."** Më së fundi, shejtani thotë: "Kush e ka krijuar Zotin tënd?" Nëse vesveset e shejtanit arrijnë deri në këtë pikë, kërkon mbrojtje dhe strehim te Allahu duke thënë eudhu-besmelenë!" (Muslim, Iman, 214.) Ky hadith fisnik tregon se shejtani nuk i bën dot dëm besimtarit nga aspekti i itikadit/besimit. Nëse është kështu, sa më shumë që shejtani i mallkuar të na sulmojë me vesvese, aq më shumë ne duhet ta forcojmë lidhjen tonë me Allahun Teala dhe të Dërguarin e Tij (a.s.) dhe ta përforcojmë përsëritshmërinë tonë. Nganjëherë, shejtanët prej njerëzve dhe xhindëve i bëjnë vesveset në këtë mënyrë: "Çdo gjë është përrallë, andaj mos ua vër veshin, sepse nuk ke për të ardhur më në këtë botë. Çdo gjë që ka kaluar, ka ikur tashmë. Për këtë arsye, përpiku të jetosh sa më mirë dhe të përfitosh nga mirësitë e kësaj bote!.." Nëse përballemi me vesvese të tilla, gjëja më e duhur që mund të bëjmë është që të largohemi nga ai mjedis.

Si përfundim, mund të themi se nuk duhet të merremi shumë me vesveset, por përkundrazi, duhet të veprojmë në të kundërt me to. Nëse nuk u japim aspak rëndësi vesveseve edhe pse vepra e bërë mund të jetë e mangët dhe themi se kjo vepër është në përputhshmëri të plotë me mendimin e ndonjërit prej imamëve të medhhebeve, do të ishte prej sjelljeve më të qëlluara që i zhdukin vesveset dhe pëshpëritjet e shejtanit. Për shembull, edhe pse "nijeti" dhe radha" në abdest janë obligim në medhhebin Shafi, në medhebin Hanefi konsiderohen sunet. Për këtë arsye, nëse një besimtar që i përket medhhebit Shafi dyshon nëse e ka bërë nijet më parë për të marrë abdest pasi e ka marrë abdestin, duhet të bindet që abdestin e ka të plotë duke mos u kapluar nga vesveset pasi në medhebin Hanefi nijeti është sunet. Për ta bërë këtë, sigurisht se duhet dije. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "**Një fakih (dijetar) i vetëm është më i fuqishëm kundrejt shejtanit se sa një mijë besimtarë të zakonshëm.**" (Ibn Maxhe, Mukaddime, 17.) Me anë të këtij hadithi fisnik Pejgamberi na ka treguar se dija është një mburojë e fortë kundrejt shejtanit të mallkuar. Për këtë arsye, mashtrimet dhe vesveset e shejtanit shikohen më tepër te besimtarët e privuar nga dija e Kuranit Fisnik dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërsa atyre që i përjetojnë me shpirt bukuritë e Islamit, vesveset e shejtanit asnjëherë nuk mund t'u bëjnë ndonjë dëm.

RUAJË zemrën në NAMAZ

Xhafer Durmush

Namazi, i cili është përkujtimi i begatë i miraxhit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shenja dalluese e Islamit tonë, është ibadeti më i rëndësishëm prej adhurimeve me të cilat jemi obliguar. Namazi është një adhurim që kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Besimtarëve asnjëherë nuk u është lejuar që të mos e falin namazin në udhëtim, në sëmundje apo në gjendje të tjera të ngjashme me këto, por u është lejuar që t'i shkurtrojnë rekatët e tij. Namazi e fut në disiplinë jetën e besimtarit duke filluar që nga periudha e pubertetit e deri në frymën e fundit të tij. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik është përsëritur urdhri: *"Faleni namazin!"*¹ – qoftë në mënyrë të vetme apo qoftë bashkë me zekatin.

Ndërsa me ajetin fisnik: **"Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."** (Nisa, 103) – është njoftuar obligimi i pesë kohëve të namazit. Ndërsa në suren Mu'minun është përmendur "frikë-respekti dhe vazhdimësia në namaz", të cilat janë prej tërësisë së kushteve të shpëtimit të përhershëm:

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre..." (Mu'minun, 1-11)

Këtu duam të tërheqim vëmendjen te dy çështje në lidhje me këto ajete fisnike. E para është: Edhe pse në Kuranin Fisnik është njoftuar për obligimin e namazit, nuk është dhënë informacion për mënyrën se si të falet ai. Ndërsa e dyta është: Namazit i është vënë kushti i frikë-respektit dhe vazhdimësisë, në mënyrë që ai të bëhet shkak për shpëtimin e përhershëm. Po, në Kuranin Fisnik nuk është dhënë informacion i detajuar në lidhje

me namazin, sepse çdo gjë që duhet ta dimë duke filluar që nga çështjet "lahik" e "mesbuk" dhe deri te dispozitat "zel-letu'l-kari", janë treguar me anë të praktikave dhe shpjegimeve të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërsa në brezat e mëvonshëm këto të dhëna janë mbledhur dhe janë bërë libra...

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë në një hadith fisnik: *"Faleni namazin siç më keni parë mua duke e falur!"* (Askalani nga Buhari, I, 379.) Në këtë hadith fisnik janë treguar kufijtë e kijamit (qëndrimin në këmbë), kiraatit (këndimit të Kuranin përgjatë qëndrimit në këmbë), të rukusë dhe të sexhdes. Po ashtu, janë treguar dhe fillimi dhe mbarimi i kohëve të namazeve farz. Përveç të tjerash, i Dërguari i Allahut (a.s.), na inkurajuar që ta bëjmë si traditë faljen e namazit të Duhasë, Evvabin dhe Tehexhahudit. Ndërsa në një hadith tjetër, (a.s.), na ka dhënë këtë sihariq duke u shprehur:

"Pesë kohët e namazit i ngjajnë një lumi që kalon para shtëpisë së ndonjërit prej jush dhe ai lahet pesë herë në ditë aty." (Muslim, Mesaxhid, 284.) Po ashtu, me hadithin fisnik: *"Namazi i falur me xhemat është njëzet e shtatë herë më i mirë se namazi i falur i vetëm."* (Buhari, Ezan 30.) – na ka inkurajuar që namazin ta falim me xhemat. Pejgamberi na i ka treguar edhe rregullat e pastërtisë nëpër xhamia.

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka qortuar dikë që e falte namazin pa e respektuar tadilu'l-erkanin, duke i thënë: *"Kthehu dhe fale namazin përsëri, sepse ti nuk ke falur namaz."* Pasi e qortoi tri herë, i tha për t'ia mësuar se si falet namazi: *"Bëj ruku në namaz dhe qëndro në ruku de-*

1. Shih. Bekare 43; 110; En'am 72; Haxh, 78.

risa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët! Pastaj, kur të ngrihesh nga rukuja, drejtohu mirë! Pastaj shko në sexhde dhe qëndro në sexhde derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj ngrihu nga sexhdeja dhe qëndro ulur derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj shko përsëri në sexhde dhe qëndro në sexhde derisa të të qetësohen të gjitha gjymtyrët. Pastaj vepra kështu në të gjitha namazet e tua.” (Muslim, Salat, 45.)

Tashmë mund të themi: Me anë të këtyre haditheve fisnike të të Dërguarit të Allahut (a.s.), sa herë që t'i lexojmë, do ta kuptojmë më mirë inkurajimin dhe qortimin e Pejgamberit. Gjithashtu, krahas kushteve dhe rëndësisë së namazit, do ta perceptojmë edhe frikë-respektin ndaj Allahut Teala në namaz dhe vazhdimësinë që duhet të shfaqim përgjatë gjithë jetës në lidhje me namazin. Përveç të tjerash, do të përqipemi më shumë për t'i rinovuar emocionet tona në lidhje me faljen e namazit, i cili është shenja jonë dalluese për besimin që i përkasim. Pastaj do të jemi më të përpiktë ndaj faljes së namazit duke e respektuar tadilu'l-erkanin, në mënyrë që prehja shpirtërore të depërtojë te të gjitha gjymtyrët tona. Pastaj do të përqipemi që të lidhemi me poseduesin e zemrës kur të drejtohemi nga kibla fizikisht dhe do të përqipemi të jemi të vetëdijshëm në lidhje me lartësimin e Zotit (xh.xh.), që bëhet me fjalët e Tij (me këndimin e Kuranit).

Nisur nga këto që thamë, nefsën duhet ta përgatisim më shumë në lidhje me namazin. Gjithashtu duhet të përqipemi seriozisht që këtë vetëdije ta mbartim edhe te të afërmit tanë, edhe te ata që i kemi nën përgjegjësi. Gjithmonë duhet të jemi të përpiktë në namaz, në mënyrë që namazi ynë të konsiderohet miraxh. Namazin asnjëherë nuk duhet ta falim sikur të ishte një detyrë. Këtë e kemi të nevojshme që ta përsërisim gjithmonë në mënyra të ndryshme... Në lidhje me këtë çështje, besoj se është shumë e dobishme që t'ia vëmë veshin paralajmërimit të Imam Gazaliut, rahmetullahi alejh, i cili thotë:

“Pa mendo pak! Kufiri i fundit i ibadetit dhe dhikrit tënd është namazi. Për këtë arsye, kontrolloje zemrën tënde! Pa shikojë një herë se në çfarë gjendjeje është ajo! Kur ti je në namaz, Shejtani i mallkuar ta merr zemrën dhe ta çon nëpër rrugë, të bën që të mendosh për llogaritë e të tjerëve, të kujton përgjigjet që mund t'ua japësh njerëzve kryeneç dhe të shpie nëpër lugina e male. Ai të shpërqendron aq shumë sa që t'i kujton të gjitha ato që ke harruar jashtë namazit. Shejtani ta sulmon zemrën veçanërisht kur je në namaz. Ndërkohë namazi është pasqyra e zemrës. Mirësia dhe ligësia e zemrës bëhet e qartë në namaz. Një namaz që falet me zemër të mbushur plot me epshet e kësaj bote, nuk pranohet nga Zoti (xh.xh.). Siç e shikon edhe vetë, Shejtani përpigjet të të largojë nga qëllimet sublime edhe në namaz duke i shtuar vesveset e tij. Ai të dëmton siç të dëmtojnë ilaçet që konsumohen pa bërë dietën e duhur. Nëse dëshiron të shpëtosh nga shejtani, para së gjithash bëj dijet me devotshmëri. Ja, pikërisht atëherë, Iblisi i mallkuar do të ikë edhe prej teje siç ka ikur nga Umeri (r.a.).”

Le ta përmbledhim temën me një fjalë të Abdullah ibn Abbasit, radijallahu anhuma: “Dy rekatë namaz që falen me qetësi dhe frikë-respekt ndaj Zotit (xh.xh.), janë më të mira se namazi i falur nga mbrëmja e deri në mëngjes prej një zemre të shkujdesur.”


HORIZONTET E PAFUNDME TË MIRËSISË

Në suren Bekare thuhet: **“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robërve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.”** (Bekare, 177)

Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës nga lindja apo perëndimi. Përkundrazi, mirësia është pasuri e përbashkët e të gjithë njerëzve. Për këtë arsye, specifikave që jepen me detaje në ajetin fisnik duhet t'u dalim për zot si një tërësi. Këto mund t'i mbledhim në katër pika kryesore: 1) Besimi ndaj kushteve të imanit, 2) Kryerja e ibadeteve, 3) Ndershmëria dhe besnikëria në vepra, 4) Posedimi i virtyteve etike.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: **“Mirësia është moral i lartë. Ndërsa mëkat janë ato gjëra që ta brejnë zemrën dhe nuk dëshiron që t'i dinë njerëzit.”** (Muslim, Birr 14, 15.) Ndërsa në Ihjau Ulumi'd-Din ka një transmetim të tillë: **“Janë dy vepra që s'ka më të këqija se ato: T'i bësh shirk Allahut dhe t'u bësh dëm robërve të Allahut. Janë dy vepra që s'ka më të mira se ato: T'i besosh Allahut dhe të jesh i dobishëm kundrejt robërve të Allahut.”**

Si përfundim, mund të themi: Dyert e mirësisë janë të hapura për të gjithë, qofshin të mëdhenj apo të vegjël. Kufijtë e tyre janë të gjerë aq sa korniza e hallallit. Mjafton që ne ta plotësojmë fetarinë tonë me mirësi.



Për cilën shkollë KEMI NEVOJË



— Nuredin Nazarko —

Arsim gjithpërfshirës. Shkollë masive. Arsim i detyruar. Të gjithë të kalojnë nga sistemi arsimor. Shkollë komunitare. Reformim i herëpashershëm, që të kemi një arsim tipik siç e ka Evropa. Detajizim i vazhdueshëm mbi aftësitë që duhet të zhvillohen. Përcaktim dhe përkufizim mbi rezultatet e të nxënit. Mbajtje përgjegjësie nëse shkolla nuk del me sukses në provime lirim apo maturë shtetërore. Shkollë me mesatare të lartë. Shkollë me rezultate konkurruese në rang qarku apo rang republike. Shkollë që përgatit nxënës të aftë për të nesërmen.

Kjo është pak a shumë atmosfera, që na përqarkëson sot. Ne jemi përgjithësisht të detyruar të bashkëjetojmë dhe të bashkëveprojmë me këtë atmosferë.

Ajo që mbetet shqetësim, nuk është thjesht masa konkrete e atmosferës në qarkullim. Shqetësues mbetet fakti që të tillë elementë atmosferikë po mbilavdërohen kaq shumë, a thua se me këtë kurs që ndjek ky uragan ndryshimesh konceptuale do të na hedhë në brigjet e një bote të re e më të mirë. *De facto* në vuajmë, po shumë ama nga shumë gjëra. Në morinë e gjithë këtyre gjërave mendojmë se dy elementë korkolepsen çuditshëm, kompleksi inferioritetit ndaj çdo gjëje perëndimore dhe deliri i mençurisë.

Kemi vuajtur mjaftueshëm nga deliri i mençurisë së vegjëlisë, që duhej të kontrollonte dhe aktivitetet intelektuale. Një mençuri që duhej të ndërhynte për të dhënë mend edhe në ato sfera ku nuk ia kishte haberin. Faktikisht dhënia mend është një aktivitet që ne e kemi shumë për zemër. Vdesim për të dhënë ca si shumë mend. Vdesim për t'u spikatur si teoricienë, dikur antiimperialistë e antirevizionistë, tani perëndimorë të thekur. Dikur duke rrahur gjoksën si fanar ndriçues në botë, tani duke mos ditur çfarë të kopjojmë më parë. Në të dy rastet nuk kemi treguar aspak origjinalitet. Duke humbur atë çfarë mund të ishte e jona, origjinale, sot e kemi të vështirë të aktualizohemi me atë çfarë vërtet kemi nevojë. Edhe kur konstatohen drejt nevojat që kemi, frika e sabotimit nga paaftësia vetjake apo dashakeqësia e dikujt tjetër shndërrohen në ngërç. Tejkalimi i këtij ngërçi, që në fakt është i detyrueshëm, realizohet nëpërmjet kompleksit të inferioritetit, duke synuar imitimin e modeleve të huaja në zgjidhjen e ngërçit. Kjo sjellje prek të gjitha fushat e jetës, por meqenëse fokusi ynë në këtë trajtesë është shkolla për të cilën kemi nevojë, do të përqendrohemi pikërisht këtu.



Në përpëlitjet e vazhdueshme për ndryshimin e kursit të shkollës pas shembjes butaforike të sistemit komunist, shumë gjëra kanë ndryshuar. Reforma të vazhdueshme. Reforma të reja apo rireformim të reformave dhe të gjitha këto pa marrë në konsideratë gjendjen reale të atyre që prekeshin nga këto reforma. Të mos keqkuptohemi dhe të mendojmë se nuk duheshin reforma. Politizimi dhe ideologjizimi mbi baza totalitariste ishte një e keqe me rrënjë të thella që duhej të mos i mbetej as hija në sistemin arsimor. Dhe jo vetëm aty.

Ndryshimi i kurrikulave ishte një përpjekje në këtë drejtim, por kush do ta implementonte kurrikulën, mendja e ndritur e njeriut të kultivuar? Kësisoj ne mbetemi teorikisht me teoritë perëndimore për zhvillimin e arsimit, të cilat i imitojmë pa kushte, pa filtra, por me mendje dhe zemër nostalgjikë të pandreqshëm. U mësua me rendin, uniformitetin, disiplinën e hekurt, respektin nga frika dhe kur na u dha në dorë shansi dhe mundësia për të qenë të lirë, u çmeritëm, u ndjemë të vegjël, u çoroditëm. Nuk ishim mësuar dhe akoma nuk jemi mësuar me shijen e ëmbël të të qenit i lirë. Teoritë që bazohem mbi veprimin e personalitetit të lirë ne i përkthejmë me atë që mbajmë në zemër, rendin dhe uniformitetin e dikurshëm. Prandaj dhe shkolla që jemi përpjekur të ndërtojmë në dy dekada e gjysmë postkomunizëm butaforik, kalamendet pa asnjë bazament të qëndrueshëm dhe me strategji afatgjatë zhvillimi.

Mund të teorizosh në stadin më të lartë të abstragimit, të vendosësh piketa që vërtet mund të afektojnë në ndryshime rrënjësore, por në qoftë se nuk kemi njerëzit me personalitet të lirë, babaxhanë e zemërmëdhenj, si do të mund të arrijmë drejt një shkolle vërtet cilësore? Të japësh mend si njeri i madh e të sillesh me mendësi diktatoriale në drejtimin e institucionit të shkollës është e papranueshme për një personalitet të lirë. Kjo nuk është aspak problem për mediokrët e hipokritët, të cilët vegjetojnë në sajë të të tilla cilësive. Ngjallat mund të përdridhen lehtë, burrat jo.

Vërtet kemi nevojë për shkolla që të kenë infras-



strukturë optimale, kushte të mira higjienike, pastërti dhe rregull, ngrohje, por mbi të gjitha kemi nevojë për shkolla ku kemi njerëz me personalitete të lira.

Kemi nevojë për shkolla ku diskutohet për dije, për ide, për mendim. Nuk kemi nevojë për shkolla ku diskutohet për telenovela, reality show të panevojshëm, apo humore banale që mbushin ekranet çdo fundjavë.

Kemi nevojë për shkolla ku diskutohet mbi një libër që diskutohet ta ketë lexuar gjatë javës. Nuk kemi nevojë për shkolla ku lexohen direktiva të përcaktuara, duke ndrydhur mendimin e lirë, për një zhvillim të mirë të shkollës.

Kemi nevojë për shkolla që drejtohen nga profesionistë. Nuk kemi nevojë për shkolla ku nostalgjikët duan të tregojnë se ka Çeçua biçak.

Kemi nevojë për shkolla ku qëndrojnë nxënës – njerëz. Nuk kemi nevojë për shkolla të tipit NGP, se nuk do të prodhojmë reçel me fryte të kalbur.

Kemi nevojë për shkolla ku nxitet të lexuarit dhe nxënësi frymëzohet drejt horizonteve të reja dhe frymës kritike. Nuk kemi nevojë për shkolla ku mbytet mendimi kritik dhe nxënësi duhet të konformohet sipas mendimit që ka dhe shpreh mësuesi apo teksti zyrtar.

Kemi nevojë për shkolla që rritin njerëz. Nuk kemi nevojë për shkolla që janë kthyer në han me 100 porta, e hyjnë e dalin turli lloj qeniesh.

Kemi nevojë për shkolla ku mjedisi më i frekuentuar të jetë biblioteka e saj, në qoftë se ekziston. Nuk kemi nevojë për shkolla ku vendin e bibliotekës e ka mbushur high tech-u.

Kemi nevojë për shkolla me qenie njerëzore në plotkuptimin e fjalës. Nuk kemi nevojë për godina, ku nxënësi dhe mësuesi e kanë braktisur para së të hyjnë aty.

Secili është i lirë ta përfytyrojë si të dëshirojë shkollën për të cilën kemi nevojë dhe të zgjedhë cilindo model që pëlqen. Mbi të gjitha nuk duhet harruar, se vlera apo pavlera e punëve varet nga qëllimi dhe nga përfundimi.

MREKULLITË E Kuranit

IDENTITETI NË SHENJAT E GISHTËRINJVE

Një aspekt tjetër i mrekullive të Kuranit është përmendja e një sërë ngjarjesh të rëndësishme, të cilat ndodhën më vonë. Për shembull, në suren Fet'h, besimtarët përgëzohen me lajmin e rikthimit në Mekë, e cila më parë ishte nën sundimin e idhujtarëve:

"Allahu e përmbushi me të vërtetë vizionin e të Dërguarit të Tij, i cili kishte thënë: "Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike." Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt." (Fet'h, 27)

I parë nga afër, ky ajet shpall një tjetër fitore, e cila do të ndodhte para fitores së Mekës. Me të vërtetë, ashtu siç është shpallur edhe në ajet, besimtarët morën Fortesën e Hajberit, e cila ishte nën kontrollin e çifutëve dhe më pas hynë në Mekë. Shpallja e ngjarjeve të së ardhmes është vetëm një pjesë e dijes së Kuranit. Ajo është gjithashtu argument se Kurani është fjala e Zotit, i Cili ka dije të pafundme.



“T’u thaftë gjuha!”

Edison Çeraj

Duket sikur ka një komplot kundër gjuhës, pasi sa vjen e varfërohet në një numër fjalësh pa palcë, si te 1984. Kur themi “gjuha” duhet të nënkuptojmë emëruesin e përbashkët e të përbotshëm të çdo gjuhe të gjallë. Siç është mjaft e dukshme, të paktën gjuhët më të njohura sot, janë tkurrur ndjeshëm qoftë për sa i takon pjesës së folur, qoftë asaj të shkruar. Me pak fjalë, gjuha vuan nga mospërdorimi, domethënë nga keqpërdorimi.

Alfabetizimi masiv (një dhunë e paprecedentë në historinë e krimit të oragnizuar), pra arsimimi, i dha goditjen e parë dhe më të rëndën gjuhës, duke imponuar te çdo njeri vetëm një numër të kufizuar fjalësh. Sikur të mos mjaftonte kjo, ky numër i kufizuar fjalësh ka një karakter kryesisht teknik, funksional, që më shumë se çdo gjë tjetër shënjon anën sasiore.

Për shembull, një paradoks tipik në këtë kontekst është fakti se nëse zotëron anglishten “i ke dyert e hapura”, e nëse zotëron sanskritishten apo latinishten, këto lloj dyersh i gjen të kyçura.

E kemi akoma të freskët në kujtesë (ose duhet ta kemi) atë çfarë bënë sistemet totalitare – në veçanti komunizmi – me gjuhën: ata na e vodhën gjuhën. E njëjta gjë po ndodh edhe sot, vetëm se jo më në hapësira të caktuara kombëtare, por gati në të gjithë planetin. Kjo nuk është vetëm vjedhje, por një rrëmbim i dhunshëm i veshur me magjinë e ligjeve.

Siç e formulon Heidegger-i, gjuha është shtëpia e qenies, dhe rojtarët e saj janë poetët. Kjo na nxit të kuptojmë se gjuha nuk është vetëm një mjet ndër mjete, sikurse mendohet masivisht në këtë kohë, por diçka më shumë sesa kaq. (“Gjuha, ndërkohë që na mundëson të komunikojmë një mesazh, është duke krijuar vetë përmbajtjen e tij.” – Shamku, 2009) Po ashtu, kjo hedh dritë mbi faktin se librat që janë lënë më shumë në harresë janë ata me poezi!

Më shumë se askush tjetër, janë poetët ata që i japin jetë gjuhës, duke e ripërtërirë herë mbas here. Poetët banojnë te gjuha, dhe kujdesi i tyre për të është një ligj i brendashkruar. Ndërsa gazetarët dhe

politikanët janë ata që ia marrin frymën gjuhës, sepse për ta ajo është vetëm një mjet që përdoret për qëllime të caktuara. Problemi i këtyre dy kategorive agravohet edhe më tej për faktin se kanë një vëmendje masive të përdtishme që i ndjek nga pas, dhe për pasojë ata imponojnë gjuhë nëpërmjet ligjërimit të tyre të vazhdueshëm. Nëse i referohemi Orwell-it, “neogjuha” (*newspeak*) është arma më e fuqishme që ka Vëllai i Madh për të kontrolluar qeniet njerëzore. Kjo na kujton këtë përfundim të Wittgenstein-it: “Caqet e gjuhës sime janë dhe caqet e botës sime.”

“Kështu pra, roli parësor i NEOGJUHËS është “të thjeshtojë deri në palcë mundësitë e mendimit”, në mënyrë që t’u presë rrugën parimeve dhe vlerave që nuk përputhen me ato të diktuar nga Partia; dhe “...kur të mbërrihet në fund, krimi i mendimit, apo psikokrimi do të jetë krejt i pamundur, ngaqë s’do të ekzistojnë më fjalët për ta ngjizur atë.” (Shamku, 2009)

Sa më të ngushtë ta ketë “repertorin” e fjalëve një person, gjasat janë që po aq të ndrydhur e ka edhe qenësinë, pasi siç e provojmë, fjalët shprehin, na mbulojnë ose na zbulojnë në raport me veten më së pari e mandej edhe me botën.

Tjetër gjë është të komunikosh me rrethanat, dhe tjetër të komunikosh me rrethanat e rrethanave. Të komunikosh me rrethanat e rrethanave do të thotë të çlirosh veten nga rrethi vicioz (në dukje) i rrethanave. A nuk e provojmë një gjë të tillë kur përjetojmë shkëputjen që na mundëson një vëllim me poezi? A nuk e provojmë këtë edhe kur na kujtohen apo kur (ri)mësojmë ndonjë fjalë që e kemi dënuar me harresë, ndonjë fjalë të qëmotshme? Pikërisht këto fjalë po na rrëmbehen, e bashkë me to, natyrisht edhe realiteti/gjendja/gjërat që ato shënojnë. Sistemi kërkon që e kaluara të reduktohet vetëm te fazat e ecurisë së tij. Vetëm kaq. Kështu mbulohet e djeshmja dhe shpiket e sotmja, dhe gjuha ka një rol qendror në këtë drejtim; sikundërse ka një rol po aq qendror për t’iu kundërvënë këtij rreziku kronik.



“...Gratë kanë të drejta po aq sa edhe obligime (ndaj burrave),
por burrat kanë përparësi për një shkallë ndaj tyre...”

(Bekare, 228)

Suksesi në jetë varet nga lumturia në familje. Një familje e lumtur do të thotë një e ardhme e ndritur. Lumturia në familje ndikon direkt në produktivitetin në punë dhe në suksesin e jetës shoqërore. Një njeri që kacafytet me probleme në jetën e tij familjare, është si një zog me krahë të thyer. Tashmë ai nuk mund të ngrihet në ajër e të fluturojë. Ai është si një sorkadhe me këmbë të thyer, e cila nuk mund t’u ikë mizorive të jetës, e të shpëtojë prej tyre.

Me qëllim që në familje të çelin lulet e dashurisë, duhet bërë kujdes në këto çështje:

Koncepti negativ ndaj gruas është një problem i rëndësishëm që e shkatërron dashurinë dhe respektin në familje. Por për fat të keq, ky problem haset herë pas here edhe në kulturën tonë. Gruaja konsiderohet si njeri me “mangësi të kuptuari”. Po ashtu, ndonjëherë thuhet se gruaja nuk duhet të përzihet në punët e burrave. Këto lloj botëkuptimesh, padyshim se bëhen shkak i poshtërimit të gruas. Por, nëse kësaj situate i shtojmë edhe natyrën agresive të burrit, dhuna ndaj gruas fillon të shihet si diçka normale. Këto lloj qasjesh, janë shumë larg prej jetës islame. Madje, janë shumë larg edhe prej kësaj thirrjeje profetike, e cila dashurinë dhe respektin ndaj gruas e vë si kush të “të qenit njeri i moralshëm”:

“Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me familjen e vet.” (Tirmidhi, Menakib, 63.)

Një tjetër nga pengesat përballë qetësisë familjare, është edhe të qenit i mbyllur ndaj ndryshimeve në aspektin moral. Fakti që një mysliman mund të këmbëngulë në gabim, është i pakuptimtë. Por për fat të keq, njeriu shpesh e harron veten dhe këmbëngul që të tjerët të ndryshojnë. Por a nuk duhet të fillojmë më parë prej vetes? Lidhur me këtë, Allahu i madhëruar, na kujton:

“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj!..” (Maide, 105)

Nga kjo, kuptojmë se secili prej bashkëshortëve duhet të përpiket të bëhet “njeri i mirë”. Më parë idealin

e përsosmërisë ata duhet të përpiqen ta realizojnë në moralin dhe sjelljet e veta. Përndryshe, shqetësimet në familje nuk do të kenë fund. “Të bëhesh njeri i mirë”, duhet të kthehet në një qëllim më vete. Por për fat të keq, lakmia për këtë botë, na e vjedh të gjithë vullnetin tonë. Po a është më e rëndësishme lakmia për këtë botë që na merr mendjen, apo përpjekja për t’u bërë njeri ose bashkëshort i mirë? Zoti ynë i Madhëruar na urdhëron ta adhurojmë Atë deri sa të na vijë vdekja¹. Në njëfarë kuptimi, a nuk do të thotë kjo, “përpikuni të jeni besimtarë të pjekur deri në fund të jetës suaj”?


Nëse analizohet thelbi i mungesës së harmonisë në familje, aty do të vërehet egoizmi. Në fakt, kjo është një sëmundje që shkatërron të gjitha vertytet morale dhe ul dinjitetin njerëzor. Ajo helmon atmosferën e dashurisë dhe respektit. Në një ajet që flet për mosmarrëveshjet midis bashkëshortëve, tërhiqet vëmendja me këto fjalë:

“Njerëzit janë të prirë për egoizëm. Por në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni prej të këqijave, Allahu e di mirë çfarë veproni!” (Nisa, 128)

Filozofia e jetës së bashkëshortëve është shumë e rëndësishme për një familje të lumtur. Nëse një njeri ka si pikësynim lumturinë e përjetshme, mund të heqë dorë nga dëshirat e veta, mund të durojë vuajtjet, e madje të preferojë të tjerët para vetes. Por, nëse kanë një filozofi me qendër këtë botë, atëherë hyn në lojë egoizmi dhe dëshira e pasionet personale, të cilat bëhen synimi i tyre i vetëm. Ata nuk bëjnë sakrificë për të tjerët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre dhe nuk i durojnë vështirësitë.

Midis pjesëtarëve të familjes është e mundur të përjetohen edhe mosmarrëveshje, sepse ata ndajnë të njëjtin vend dhe të njëjtat mundësi. Po ashtu, brenda në familje, është më e lehtë të shfaqen ndjenjat dhe mendimet, qofshin pozitive apo negative. Këtyre mund t’u shtohen edhe kushtet e vështira

1. - shih. Hixhr, 99.



të punës dhe jeta e lodhshme e qytetit. Njerëzit, mund ta shkarkojnë në shtëpi stresin që nuk mund ta shkarkojnë jashtë në shoqëri. Ja pra, të gjitha këto bëhen shkak që herë pas here midis bashkëshortëve të përjetohen tensione.

Bashkëshortët duhet t'i përballojnë me mirëkuptim rastet e pakëndshme që ndodhin në familje, sepse të reagosh ashpër në çdo ndodhi negative, nuk është sjellje e një njeriu të virtytshëm. Prandaj, në raste të tilla, kërkimi i faljes nga ai që ka gabuar dhe falja nga pala tjetër, është domosdoshmëri e të qenit të virtytshëm. Në këtë ajet fisnik, falja konsiderohet si cilësi e njerëzve të devotshëm: **“ata të cilët...e mposhtin zemërimin dhe ua falin gabimet njerëzve!..”** (Ali Imran, 134)

Mirëpo, në vendin tonë ekzistojnë disa probleme që vijnë prej traditës. Për shembull, në disa zona, kur nusja e shtëpisë flet në prani të të mëdhenjve të familjes, kjo nuk pritet dhe aq mirë. Është e vështirë të thuash se kjo gjendje nuk ndikon në shpirtin e saj. Po ashtu, ndonjëherë burrat nuk mbajnë qëndrim të drejtë ndaj marrëdhënieve nuse-vjehrrë. Kjo gjë e lodh gruan në aspektin psikologjik. Një nga elementet që prish komunikimin në familje në ditët tona, është edhe përdorimi i tepërt i televizionit dhe internetit. Për shkak të kësaj, bashkëshortët dhe fëmijët nuk ndajnë shumë kohë me njëri-tjetrin. Për fat të keq, mjetet që janë shpikur për të shtuar komunikimin ndër njerëz, po bëhen shkak i ndërprerjes së këtij komunikimi.

Gjithashtu, është shumë e domosdoshme të ruhet gjuha prej fjalëve fyese gjatë komunikimit të bashkëshortëve me njëri-tjetrin. Këto sjellje mund të hapin probleme të pariparueshme edhe tek fëmijët, por edhe në marrëdhëniet midis bashkëshortëve. Madje, nëse këto bëhen zakon, mund të bëhen edhe shkak i këputjes së marrëdhënieve familjare. I Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur se këto lloj shprehjesh janë gjynah dhe se ai që flet fjalë të shëmtuara ndaj

familjes së tij, duhet të kërkojë falje shumë herë në ditë për këtë.²

Bashkëshortët duhet ta pranojnë njëri-tjetrin ashtu siç janë, sepse çdo njeri ka cilësi të veçanta. Burri dhe gruaja janë të ndryshëm edhe në aspektin psikologjik. Çdo njeri ka karakter të ndryshëm, ka gjëra që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë.³ Po ashtu, mund të ketë edhe dallime në aspektin kulturor. Shkurtime, është e pamundur që midis bashkëshortëve të ketë një përputhje të plotë. Allahu i Madhëruar urdhëron që bashkëshortët të shohin gjithmonë anët e mira të njëri-tjetrit: **“...Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duroni!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira.”** (Nisa, 19) Po ashtu, edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: **“Besimtari nuk duhet të ushqejë ndjenja të këqija për gruan e tij besimtare, sepse nëse atij nuk i pëlqejnë disa huqe të saj, mund t'i pëlqejnë disa të tjera.”** (Muslim, Rada, 61.)

Mbajtja gjallë e atmosferës shpirtërore është shumë e rëndësishme për arritjen e lumturisë familjare, sepse në ditët tona ndjenjat dhe mendimet fetare të njerëzve po pësojnë erozion të madh. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që pjesëtarët e familjes t'i kryejnë së bashku adhurimet, si namazet, dhikrin dhe leximin e Kuranit në shtëpi, sepse këto janë burimi i harmonisë, gëzimit, tolerancës, faljes, mëshirës, durimit dhe besnikërisë në familje. Gjithashtu, ndjenjat fetare në familje, i ushqejnë edhe lutjet e prindërve të moshuar. Prandaj, pjesëtarët e familjes duhet t'i shohin ata si shkak i mëshirës dhe begatisë hyjnore në familjen e tyre. Ata besojnë se lutjet e tyre do të pranohen dhe ndjejnë kënaqësi shpirtërore prej kësaj. Nuk ka dyshim se në familjet ku jeta fetare është e shëndetshme, vështirësitë kalohen shumë më lehtë.

2. - shih. Ibn Maxhe, Edeb, 57.

3. - shih. Isra, 84.



Në një hadith të transmetuar prej Xhabir ibn Abdullahut (r.a.), Profeti (a.s.), ka thënë:

“Ruhuni prej zullumit, sepse ai do të jetë errësirë e plotë
(për të padrejtin) në Ditën e Kiametit.”

(Muslim, Birr, 56)

Kur çdo fjale të fjalorit iu dha një ngjyrë, asaj i takoi errësira. Prej atëherë ajo përmendet me të zezën e errësirës. Ajo ishte një errësirë e tillë, sa ia kishin zili edhe netët pa yje, qelitë ndriçonin pranë saj, ndërsa pusët pa fund, bënin shqyr për veten kur shihnin atë. Në çdo gjuhë që shqiptohet, në çdo rresht që shkruhet, ajo linte një njollë të zezë. Faqet e historisë ku përmendej emri i saj, damkoseshin me të zezë. Në rrugicat ku kalonte ajo, dritat e shtëpive fikeshin një nga një, duke lënë pas vetëm një errësirë totale.

Në fjalorë, shpjegimi i “zullumit” është, “të vendosësh diçka aty ku nuk i takon, të shkelësh kufijtë, të braktisësh të drejtën e të shkosh në të kotën, të mos i japësh të drejtën të zotit etj.” Ndërsa dijetarët thanë, se shkaku i errësirës që përmendi i Dërguari i Allahut (a.s.), mund të jetë vetëm shirku, që e lë njeriun në errësirë të përjetshme.¹ Në fakt, nëse zullum do të thotë të vendosësh diçka aty ku nuk i takon, a nuk është zullumi më i madh kur njeriu vendos në zemrën e tij zota të rremë? Nëse zullum do të thotë të bësh padrejtësi, a nuk është zullumi më i madh që njeriu të tregohet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet që e krijoi, e t’ia japë dikujt tjetër të drejtën që i takon Zotit? Kjo duhet të jetë edhe urtësia e këshillës së Lukmanit ndaj biri të vet, kur i tha: “... **Biri im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një zullum (padrejtësi) shumë i madh**”. (Lukman, 13)

Rumi thotë se zullumi është si të ujitësh gjembat, pra të lësh lulet mënjanë e të rritësh gjemba. Zullum është të shohësh i heshtur rritjen e gjembave. Të lejosh rritjen e tyre, ndërkohë që pemët thahen.

T’i japësh të drejtë atij që s’e meriton, do të thotë të privosh prej saj atë që e meriton. Zullumi është natyrë e atyre që shkatërrojnë drejtësinë dhe të vërtetën për të forcuar ekzistencën e vet. Ai është vepër e atyre që janë shurdhuar aq shumë, sa nuk dëgjojnë dot as zërin e ndërgjegjes së vet kur janë duke u shkaktuar

dhembje të tjerëve. Zullumqar është njeriu i cili vë nën këmbë të gjitha vlerat në emër të madhërimit të arrogancës së vet. Dhe kur bota është e dënuar të mbetet në drejtësinë e zullumqarëve, ajo është e dënuar të mbetet në një errësirë si e zeza e syrit të zullumqarit.

Ndonjëherë vjen një kohë e tillë, që kjo botë dëshmon bashkë me dheun, malet dhe gurët e saj garën e zullumqarëve me njëri-tjetrin. Çdo despot garon me të tjerët për të arritur i pari në pikësynimin e vet. Duhet derdhur më shumë gjak e lot... për këtë arsye ata thërrasin në të pavërtetën derisa u çirret zëri. Ata punojnë ditë e natë, me qëllim që errësira të mbi-zotërojë dritën. Ata ndihmohen me njëri-tjetrin në zullume, bëhen një trup i vetëm dhe ua nxijnë jetën të dobëtëve. Aq sa prej tyre cenohen Habili, Nuhu (a.s.), Musai (a.s.), Isai (a.s.), Sumejet dhe Amarët. Gjithashtu, preken edhe vajzat e vogla që nuk u është njohur e drejta për të jetuar, fëmijët dhe të pafajshmit që masakrohen nga bombardimet. Faraonët, Nemrudët, Ebu Xhehlët, Ebu Lehebët etj., nuk vdesin kurrë. Ata shëtisin në çdo kohë, në çdo kontinent dhe pas tyre lënë vetëm errësirë të plotë.

Kur jeta e fëmijëve nxihet prej bombave që u hidhen nga sipër, atyre u nxihet edhe e tashmja, edhe e ardhmja. Qiejt e bekuar që kanë dëshmuar profetët mbajnë erë barut. Emrat e qyteteve legjendare tashmë përkujtohen me mjerim. Prej faqeve të historisë rrjedh gjaku i të shtypurve. Fesë së Allahut po i ngjisin emra të errët. Fjalë që bien erë gjak po shkruhen pranë emrit të fesë së Allahut. Pikërisht këtu nxihet edhe boja, edhe mbulesa e Bejtullahut... Qytetet e profetëve digjen dhe çdo qytet i djegur po pret ditën kur do të dëshmojë kundër zullumqarit që i vuri zjarrin. Në qiej nuk ngrihen vetëm tymrat, por edhe rënkimet e të mjerëve që u janë shkatërruar shtëpitë.

Zullumqari që nxin sipërfaqen e tokës për të dobëtën, harron se nëntoka është edhe më e errët për të. Mirëpo, njeriu hesht, ndërkohë që sipërfaqja e

1. shih. Ajni, Umde, 12/293.



tokës dëshmon për çdo grimcë zullumi që bëhet mbi të, Arshi i Allahut dridhet dhe gurët bëhen gati të flasin. Hesht dhe vetëm shikon! Pa e ditur se vetëm duke rezistuar ndaj tij mund të shpëtojë prej pusit të zullumit, ai preferon të qëndrojë në indiferencë të thellë, në hare të pakuptimtë, në moskokëçarje të tepruar dhe shfaqje të rrejshme shqetësimi. Por, kujt do që sheh zullumin i ndyhen duart me gjak dhe i njolloset ndërgjegjja. Të gjithëve që dëshmojnë zullumin u humbet një copë prej njerëzisë së tyre dhe ata vazhdojnë jetët e tyre me këtë të zezë të turpshme që u lyhet në ballë. A nuk është zullum kur nuk bën mirë, po aq sa është kur bën keq? Ku dallon ai që nuk e pengon të keqen prej atij që e kryen të keqen? Sa mysliman është ai që e privon vëllain e vet prej të mirës më të vogël dhe nuk ia zgjat dorën në ditë të vështira? Në momentin që thoni se jeni mysliman, duhet të ndjeni edhe peshën që bie atë moment mbi supet tuaja.

Unitetin që tregojnë zullumqarët kur duartrokin zullumin, jemi të detyruar ta shfaqim edhe ne duke mbajtur qëndrim ndaj zullumit. Pasi kemi dëgjuar fjalën e Profetit tonë (a.s.), *“Myslimani është vëlla i myslimanit. Ai nuk i bën zullum atij, nuk e lë pa ndihmë dhe nuk e përçmon atë!”*² dhe kemi mësuar se edhe lutja, edhe mallkimi i të shtypurit pranohen nga Zoti³, zgjedhja e vetme për ne si myslimanë është të rreshtohemi në anë të të shtypurit. Përndryshe, do të kuptojmë se ai të cilit i bëjmë zullum vazhdimisht, është vetëm vetja jonë. Padyshim do të vijë edhe dita kur fëmijët e pafajshëm do të pyeten “përse u vratë?”. Ndërsa neve do të pyetemi se, çfarë bëmë kur fëmijët ishin duke u vrarë?

2. Muslim, Birr, 32.

3. Buhari, Zekat, 63; Tirmidhi, Birr, 7.



VETËM DEVOTSHMËRIA

ISLAMI: FEJA E VËRTETË

Feja e vetme e pranuar nga Allahu i Lartësuar është feja islame...

Ne erdhëm të udhëzuar në këtë jetë si pasojë e mëshirës së Allahut. Ne kemi ardhur në këtë botë të udhëzuar si një mirësi e madhe e Allahut Teala, por Allahu i Madhëruar na urdhëron të japim shpirt si myslimanë, sepse kjo nuk ka garanci.

Për këtë arsye, është kusht që të jetojmë vetëm me devotshmëri.

Nëse nuk duam që të na rrëshqasin këmbët nga rru- ga e drejtë, atëherë duhet ta zbatojmë këtë kusht.

Siç dihet, feja islame është e përsosur dhe ma- dhështore si sistem. Tek ajo asnjëherë nuk kanë vend komentet sipas dëshirës dhe këndvështrimet e pabaza. Por ja që në ditët e sotme, për fat të keq, ka nga ata që e komentojnë Islamin sipas dëshirave, epsheve dhe interesave të tyre. Atëherë, cili është Islami që duhet të zbatojmë, në mënyrë që Zoti (xh. sh.), të jetë i kënaqur me ne?!

Ai është Islami që e ka zbatuar Krenaria e Gjithësi- së, Profeti (a.s.) dhe sahabët e tij të nderuar.

Islamin duhet ta përfetojmë me thellësinë e zemrës dhe hijeshinë e moralit të lartë.

Ky është vetë Islami, por për ta ndarë nga kënd- vështrime të ndryshme, quhet: devotshmëri, asketi- zëm, ihsan, tasavvuf. Të gjitha këto janë emërtimet e ndryshme të së njëjtës të vërtetë.

Nisur nga kjo pikëpamje, veçanërisht në ditët e sotme, nevoja që njerëzit kanë për tasavvufin (misti- kën) është në pikën më kulminante të saj, sepse feja mund të mbrohet vetëm me devotshmëri.

Devotshmërisë, nëse do t'i bënim përkufizimin më të shkurtër, është frika dhe dashuria ndaj Allahut Teala...

Kur Allahu Teala i përkufizon besimtarët, thotë:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve u fërgëllojnë zemrat e tyre kur përmendet Allahu...”
(Enfal, 2)

Devotshmëria është të përjetuarit e Islamit me një zemër të butë e të ndjeshme, që dridhet nga frika ndaj Zotit (xh.sh.). Devotshmëria përmban shumë çështje brenda vetes:

NJË NAMAZ ME FRIKË E RESPEKT NDAJ ZOTIT

Kur të takohemi me Allahun e Lartësuar, pra në namaz, zemra dhe trupi duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin.

Namazi është shumë i rëndësishëm. Ai duhet të falet me frikë e respekt ndaj Zotit (xh.sh.), në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme, në mënyrë që ai namaz ta mbajë larg dhe ta mbrojë falësin e tij nga çdo lloj ligësie dhe vepre të shëmtuar.

Për ta falur namazin me këtë ndjeshmëri, singëritet e vetëdije, devotshmëria është kusht, tasavvufi është kusht dhe vetëdija e ihsanit është kusht.

Allahu i Lartësuar më së shumti na drejtohet me emrat e Tij “Mëshirues” dhe “Mëshirëbërës”. Nisur nga kjo, Ai dëshiron që edhe ne të mbushemi plot me mëshirë dhe të stolisemi me bujari. Kur Krijuesi i përkufizon besimtarët e devotshëm, thotë:

“...Ata japin nga ajo që Ne u kemi dhënë.” (Be- kare, 3)



Për ta fituar këtë cilësi të lartë, e kemi kusht që të shpëtojmë nga koprracia dhe pangopësia e nefsit. Rruga që të shpie te kjo është tasavvufi.

Allahu Teala kërkon nga ne nder, drejtësi, trimëri, mirësjellje dhe hijeshi. Gjithashtu kërkon që t'i respektojmë të drejtat e njeriut.

Për t'i arritur këto, në zemër duhet të gjendet vetëdija se robi vazhdimisht është nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, pra, ihsani është kusht. Duhet të zhduken sjelljet arrogante të nefsit dhe të nxirren në pah aftësitë shpirtërore, prandaj devotshmëria është kusht.

Në të kundërt, del në pah mungesa e sinqeritetit, shtirja, vesi, injoranca, koprracia, papërgjegjshmëria. Pastaj këto bëhen objekt që tërheqin vëmendjen e armiqve dhe shpifësve për Islamin.

Përfundimisht, Zoti (xh.xh.), kërkon nga ne një natyrë njerëzore të përsosur.

Allahu i Lartësuar thotë kështu duke na sqaruar se si mund ta arrijmë këtë natyrë njerëzore të përsosur:

“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (Fatir, 28)

Ne duhet të përsosim një dije të tillë që të na e shtojë frikën e respektin ndaj Allahut Teala, të na e shtojë thellësinë e meditimit, të na bëjë t'i shikojmë rrymat e fuqisë dhe madhëstisë hyjnore dhe të na bëjë të themi: “Aman o Zot!”

NJË DIJE E TILLË QË...

Një dije e tillë që të na bëjë të meditojmë rreth ajeteve të Kuranit Fisnik dhe argumenteve të librit të gjithësisë. Në këtë mënyrë, të na japë një bazë për “marifetullahin (njohjen) e Allahut”.

Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut dijet ekzoterike dhe ezoterike. Të gjitha dijet, duke filluar nga mjekësia e deri tek astronomia, nga botanika e deri te biologjia, nga fizika e deri te kimia, përbëhen nga rregulla të mësuara si rezultat i përpjekjeve sheku-

llore të njerëzve në lidhje me njohjen e sistemit të gjithësisë, të cilën e ka krijuar Allahu.

Këto dije janë si një thikë me dy tehe të mprehta dhe mund të shërbejnë edhe për të mirë, por edhe për keq.

Shërbimi për të mirë është i njohur:

Qëllimi i këtyre dijeve duhet të jetë përgatitja e një baze për “marifetullahun”. Ato duhet t’ia shtojnë meditimin njeriut dhe ta bëjnë që të vështrojë madhëstinë, fuqinë dhe mëshirën hyjnore.

Dija bashkë me devotshmërinë duhet ta afrojë robin tek Allahu i Plotfuqishëm dhe ta shpjerë atë tek “marifetullahu”. Në çdo rregull të dijes dhe në çdo shfaqje të saj, robi duhet të kujtojë madhëstinë dhe fuqinë absolute të Allahut Teala.



Si mund të dalë një pemë madhështore nga një farë dhe si mund të japë frute me tonelata? Si mund ta fshehë ajo farë platin dhe programin e të fshehtës së formimit të kësaj peme?

Si mund të dalë nga veza një zog apo gjallesë tjetër?

Po njeriu? Si formohet nga një grimcë? Cila fuqi i ruan të gjitha organet në atë grimcë?

Meditimi është një çelës i besimit. Edhe dija duhet të jetë produkt i meditimit.

Fryti material i një dijeje të tillë duhet të jetë shkak për shpërthimin e mëshirës te njeriu. Fryti shpirtëror i dijes duhet të jetë lartësim i Allahut dhe fryti material i saj duhet të jetë mëshirë ndaj të gjitha krijesave nga ana e njeriut. Për shembull, mjekësia duhet të shërbejë për shërimin e njeriut. Shkenca duhet ta mbrojë mjedisin, njeriun, natyrën dhe të gjitha krijesat e tjera.

Për fat të keq, sot nuk po ndodh kështu, sepse aktualisht tehu tjetër i mprehtë i dijes po i shërben më shumë së keqes.

Dija po shkëputet nga “marifetullahu”. Për shkak të kësaj, po dalin njerëz që bëjnë hamallëkun e dijes, por që nga kjo nuk shohin asnjë dobi të tillë si: meditimi, devotshmëria, frika, respekti ndaj Zotit

e mëshira ndaj njerëzve apo krijesave të tjera. Këta hamallë të dijes nuk janë dijetarë, por në të vërtetë janë dijetarë të rremë. Për shkak të kësaj po dalin në pah zemra të nxira dhe të mbytura në rreshtat e zinj të librave me kopertina të errëta.

Allahu i Madhëruar thotë kështu në lidhje me këta hamallë të një dijeje të tillë:

“...i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat...” (Xhuma, 5)

Ky është një shpërdorim dëshpërues i dijes. Ky është një diamant i hedhur në rrugë. Kjo është një fatkeqësi.

Në vend që dija të bëhet shkak për shtimin e dashurisë e besimit ndaj Allahut Teala dhe “marifetullahut”, përkundrazi, po bëhet shkak për mburrjen, mendjemadhësinë, urrejtjen dhe padrejtësinë.

Një pjesë e rëndësishme e dijetarëve ekzoterikë të sotëm janë mashë e të padrejtëve. Si rezultat, kanë shpikur armë që vrasin më shumë njerëz dhe kanë nxjerrë shkençëtarë që janë militantë të tiranëve. Ndotja, e cila ka zhdukur shumë lloje gjallesash në tokë e në det, është rezultat i teknologjisë së nënshtruar ndaj interesave të kësaj bote.

Dijet ekzoterike duhet të përdoren në mënyrë të drejtë e të saktë.

JO QËLLIM, POR OBJEKT PËR TË ARRITUR TE QËLLIMI

Pikërisht si Lejla për Mexhnunin...

Dijet janë si Lejla në historinë e Lejlës dhe Mexhnunit. Nëse Mexhnuni do të rrinte gjithmonë pas Lejlës, nuk do të shprehte asgjë dhe fundi i tij do të ishte tragjik. Por ngaqë Mexhnuni e bëri dashurinë ndaj Lejlës së përkohshme shkallë për të shkuar te dashuria e Zotit të Përhershëm, arriti virtytin, arriti takimin hyjnor, arriti urtësinë.

Edhe në dije, ajo që e shpie njeriun te virtyti është dija e dobishme. Dobia e dijes matet se sa mund ta shpjerë të zotin e saj me devotshmëri të Allahut i Madhëruar. Allahu i Gjithëmëshirshëm thotë:

“...ruajuni Allahut (jini të devotshëm)! Allahu ju mëson (ato që nuk i dini)...” (Bekare, 282)

Domethënë, na dhuron shfaqje nga “marifetullahu”.

Në ditët e sotme, bota globale vazhdon ta ndryjë ndërgjegjen e njerëzve dhe t’ua nxisë ambiciet aty-

re. Nëse u hedhim një sy vendeve në të cilat derdhet gjak, shihet qartë se pas perdes ka luftë për naftë dhe për interesat e kësaj bote. Gjaku i njerëzve po derdhet lumë për të marrë naftë me fuçi.

Ja gjendja e Sirisë... Me miliona drama para syve të botës... Askush nuk përpiqet ta ndalojë padrejtësinë dhe gjakun, në mënyrë që të mos u preken interesat e tyre.

Sot bota gjendet në një zbrazëti të madhe dhe njerëzimi nën vrazhdësinë e tmerrshme të jetës lakmitare.

Cila është rrugëzgjidhja?

Rrugëzgjidhja është Islami.

Islami me natyrën, tasavvufin dhe devotshmërinë e vërtetë.

Për ta bllokuar edhe këtë rrugëdalje, kanë nxjerrë në pah një fenomen që e quajnë islamofobi.

ÇËSHTJA E ISLAMOFOBISË

Në ditët e sotme, ata që duan ta ndalojnë përparimin e Islamit në shkallë botërore, për fat të keq kanë formuar një dallgë të shëmtuar urrejtjeje dhe armiqësie kundër Islamit dhe myslimanëve të cilën e quajnë “Islamofobi”. Tashmë një pjesë e njerëzve, qoftë nga padituria, qoftë nga nijeti i keq, fjalën “Islam” kanë filluar ta përdorin bashkë me fjalën “terror”. Kjo është një prej katastrofave më të mëdha të kohës sonë.

Ndërkohë terrori është i ndërtuar mbi tiraninë. Terroristët asnjëherë nuk kanë nevojë për ndjenja sublime si edukata, morali, dashuria e frika ndaj Allahut Teala. Terrori nuk ka lot, nuk ka mëshirë, nuk ka ndërgjegje.

Ndërsa Islami është plotësisht e kundërta e terrorit. Ai është i ndërtuar veçanërisht mbi butësinë dhe mëshirën. Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik më shumë përmend emrat e Tij si Rrahman dhe Rrahim, domethënë, shpreh mëshirën e Tij që përfshin të gjitha krijesat. Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është dërguar si “mëshirë për botët”.

Nëse i hedhim një sy historisë, vëmë re se njeriu që ka luftuar më së shumti me terrorin është i Dërguari i Allahut (a.s.). Jeta profetike njëzet e tri vjeçare e tij, nga njëri aspekt, ishte luftë me terrorin. Terrori kundër njeriut, terrori kundër kafshëve, terrori kundër bimëve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), gjithmonë ka luftuar me

Shpifësit përpiqen ta shfaqin Islamin si terror dhe barbarizëm. Ata përpiqen ta akuzojnë Islamin përmes shembujve më negativë, të cilët në fakt janë shfaqur në batakun e jetës së tyre.

këto. Ai gjithmonë i ka zbatuar të drejtat e njerëzve qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Si rezultat, shkretëtirat e shndërruara në liqene gjaku i bëri vende të qeta dhe hodhi themelet e një qytetërimi virtytesh të pashoqe, që historia njerëzore nuk e kishte parë kurrë. Ai gjithmonë përhapri mëshirë dhe butësi kundër çdo lloj terrori.

Sot, ajo që na takon të bëjmë si umeti i Muhamedit (a.s.), është përjetimi aq sa kemi mundësi i moralit të lartë të Pejgamberit (a.s.), i cili ishte mëshirë për botët, reflektimi i atij morali në veprat tona dhe predikimi i tij. Përderisa ta kryejmë me sukses këtë detyrë as shpifjet, as ofendimet nuk kanë asnjë vlerë. Shpifësit nuk mund të gjejnë më mundësi për ofendime të tilla, sepse Islam do të thotë paqe. Islam do të thotë paqe për të gjithë njerëzimin.

Shpifësit përpiqen ta shfaqin Islamin si terror dhe barbarizëm. Ata përpiqen ta akuzojnë Islamin për mes shembujve më negativë, të cilët në fakt janë shfaqur në batakun e jetës së tyre.

Ndërkohë Islami nuk është frikësues, por qetësues dhe rehatues i zemrës. Në të njëjtën kohë përhap mirësjelljen, ëmbëlsinë dhe hijeshinë. Islami është feja që lufton me çdo lloj terrori. Islami është feja që i trajton me butësi të gjitha krijesat. Ja disa shembuj nga vetë bahçja me trëndafila e Islamit:

KULMI I DHEMBSHURISË

Kur u nis udhës për në Mekë, Profeti (a.s.), doli prej Medinës i veshur me ihram. Udhëtuan derisa erdhën në një vend të quajtur Usaje, midis Ru'uejses dhe Arxhit.

Aty, pa një sorkadhe që flinte nën një hije. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), thirri menjëherë një person prej sahabëve dhe e urdhëroi të qëndronte pranë saj derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që të mos ta trembnin apo ta shqetësonin. (Mu'uatta, Haxhixh, 79; Nesai, Haxhixh, 78.)

Po ashtu, edhe gjatë udhëtimit për në çlirimin e Mekës, në mes të rrugës vunë re një qen femër që ishte shtrirë përtokë për të ushqyer të vegjlit e saj me qumësht. Profeti (a.s.), menjëherë thirri Xhuajl bin Surakan (r.a.) dhe e vendosi si roje pranë qenit dhe këlyshëve të saj, me qëllim që ata të mos shqetësoheshin nga asnjë njeri që do të kalonte aty. (Uakidi, II, 804.)

I Dërguari Fisnik (a.s.), ka thënë:

“Rrahmani (Mëshiruesi), i mëshiron njerëzit mëshirues. Mëshirojini ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell!” (Ebu Daud, Edeb, 58/4941.)

Kjo ndodhi, është një shembull i pashoq i shikimit të krijesave me syrin e mëshirës:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, se nuk do të hyni në xhenet pa e mëshiruar njëri-tjetrin.” Sahabët thanë menjëherë:

“O i Dërguar i Allahut! Të gjithë jemi të mëshirshëm.” Ndërsa Profeti (a.s.), tha:

“-Mëshira (për të cilën flas), nuk është vetëm mëshira ndaj njëri-tjetrit që kuptoni ju. Përkundrazi, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat. (Po) Mëshira që përfshin të gjitha krijesat.” (Hakim, IV, 185/7310.)

Një shembull të pashoq të kësaj mëshire të madhe e të pafund, e tregon edhe Bejazid-i Bistami:

“Në kohën tonë kishte me mijëra veli. Mirëpo, detyra e prijësit (në rrugën e drejtë) për atë shekull, i ishte besuar një hekurpunuesi me emrin Ebu Hafs. Për të mësuar më shumë rreth kësaj urtësie, shkova te dyqani i tij. Kur e pashë, vura re se ai ishte shumë i shqetësuar dhe i hidhëruar. E pyeta për arsyen e kësaj dhe ai mu përgjigj me këto fjalë:

“Vallë, a ka dert më të madh se derti im, dhe njeri më me shumë derte se unë? Vallë, si do të jetë gjendja e umetit të Muhamedit (a.s.), në Ditën e Kiametit?”

Më pas filloi të qante dhe më bëri edhe mua të qaja. U bëra kureshtar dhe e pyeta:

“Përse të shqetësoni kaq shumë fakti se njerëzit do të dënohen?”

Ebu Hafsi u përgjigj:

“Natyra ime është mbujtur me mëshirë dhe dhembshuri. Nëse i gjithë dënimi që do t’u jepej njerëzve të shkujdesur do të binte mbi mua dhe ata do të faleshin, unë do të isha tepër i kënaqur prej kësaj dhe derti im do të merrte fund...”

Prej kësaj, kuptova se Ebu Hafsi nuk ishte nga ata që thoshin “unë, unë”, por duke qenë në rrugën e Profetit (a.s.), ishte nga ata që thoshin “umeti, ume-ti”.

Qëndrova edhe pak kohë pranë tij dhe mora shumë frymëzim shpirtëror prej tij. Unë kuptova se dashamirësia dhe dhuntia që kishte arritur, ishin begatia e butësisë dhe mëshirës së madhe, të cilat i kishte bërë natyrë të vetën. Prej tij mësova se çfarë është mëshira...”

Duhet menduar se:

Nëse një i dashur i Allahut është kështu, atëherë kushedi se si duhet të jetë dhembshuria dhe mëshira e të Dërguarit të Tij?

Padyshim që është shumë e madhe...

Ta pyesim veten:

Sa të mëshirës jemi ne umeti i një profeti që është dërguar si mëshirë për të gjitha botët?

Ai Profet i mëshirës, thotë:

“Bëni kujdes! Për sa kohë jam gjallë, jam shkak i sigurisë suaj. Por kur të ndërroj jetë, do t’i përgjërohem Zotit “O Zot, ummeti, ummeti!”, derisa t’i fryhet surit për herë të parë...” (Ali el-Muttaki, Kenzu’l-Ummal, V. 14, fq. 414.)

Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), thotë:

“Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

Ndërsa në një hadith tjetër, thotë:

“Shefaati (ndërmjetësimi) im do të jetë për ata prej umetit tim, të cilët kanë bërë gjynahe të mëdha.” (Ebu Daud, Sunnet, 20)

I Dërguari i Allahut (a.s.), pa dikë që po e çonte delen për ta therur duke e tërhequr për veshi. Mënjerë ndërhyni dhe i tha:

“Lëshoje veshin e kafshës dhe kape për qafe!” (Ibn Maxhe, Dhebah, 3.)

Sevade bin Rebi (r.a.), tregon:

“Shkova te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i kërkova disa gjëra. Ai urdhëroi që të më jepeshin 3 deri në 10 deve.

Pastaj më dha këtë këshillë:

“Kur të kthehesh në shtëpi, thuaju njerëzve të shtëpisë tënde që të përkujdesen mirë për kafshët dhe t’u japin mjaftueshëm ushqim.

Gjithashtu urdhëroji që t’i presin thonjtë, në mënyrë që të mos i lëndojnë dhe t’i gërvishtin gjinjtë e kafshëve kur t’i mjelin!” (Ahmed, III, 484; Hejsemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

Një fe e cila urdhëron një mëshirë të tillë për krijesat, sigurisht që ka shfaqur butësi dhe mëshirë edhe për njerëzinë.

Profetit (a.s.), nuk i pëlqeu që sahabët të bënin muhabet hipur mbi kafshët e tyre dhe i këshilloi:

“Mos i përdorni kurrizët e kafshëve tuaja si podiu-mel!” (Ebu Daud, Xhihad, 55/2567.)

Ndërsa atyre që udhëtonin, u kujtoi që kafshët e tyre t’i pushonin në vende me kullota. Njëherë, kur pa një fole milingonash të djegur, u tmerrua dhe tha:

“Kush e dogji këtë fole milingonash, kush mund ta marrë jetën që ka dhënë Allahu?”

Atëherë, duhet menduar mirë se çfarë dhembshurie dhe mëshire ligjëron për njerëzimin një fe e cila

urdhëron një mëshirë të tillë për krijesat.

Shkurtimisht, njerëzimi dhe krijesat e tjera gjetën paqe me Islamin. Ndërsa shkaku që ata zgjasin gjuhët e tyre ndaj Islamit, dihet:

E PAVËRTETA SHQETËSOHET NGA E VËRTETA

Ata që flenë në shkujdesje shqetësohen prej atyre që i paralajmërojnë.

Sot, njerëzit interesaxhinj dhe pragmatistë shqetësohen nga butësia, mëshira dhe altruizmi që predikon Islami.

Islami i shqetëson të padrejtët e mashtruesit me drejtësinë dhe barazinë që urdhëron.

Kështu, në botën perëndimore, pohimi se civilizimi islam është i vetmi që mund të shfaqë rezistencë kundrejt civilizimit perëndimor, i cili gjendet në krye me fuqi materiale dhe se për këtë shkak do të ketë kontradikta e përplasje ndërmjet këtyre dy civilizimeve, ka filluar të thuhet që para 20-30 vjetësh.

Edhe pse myslimanët mentalisht janë shumë prapa perëndimit materialisht, politikisht, ushtarakisht, teknikisht dhe teknologjikisht, ata kanë frikë nga Islami. Përse?

Sepse Islami e ka ruajtur të vërtetën se jeta e vërtetë është Ahireti. Ata nuk kanë një përgjegjësi të tillë. Andaj kërkojnë një jetë argëtuese, të zakonshme dhe në përputhje me dëshirat e vetes.

Për këtë arsye, e sulmojnë Islamin, sepse ai e ndalon këtë.

Përveç të tjerash, edhe ata e dinë se interesi e shqetëson ndërgjegjen e njeriut. Njerëzia kërkon butësi dhe mëshirë.

Padrejtësia i plagos zemrat. Njerëzia po i drejtohet një feje që e urdhëron drejtësinë dhe që e mban gjallë atë.

Një jetë pa qëllime, një jetë shtazore dhe e çmendur, e lëndon shpirtin. Njeriu po kërkon qëllimin e ekzistencës së tij.

Këtij kërkimi i japin përgjigje myslimanët që e zbatojnë Islamin e vërtetë, myslimanët e sjellshëm dhe zemërbutë.

BAZA SHPIRTËRORE ËSHTË KUSHT

Në të gjitha dijet ekzoterike dhe ezoterike patjetër duhet të hyjë baza fetare.

Ata që edukohen me këtë bazë shpirtërore në këtë kohë të fundit dhe që mund ta vendosin dijen në vendin e saj të vërtetë e të dobishëm, mund ta reflektojnë fytyrën e qeshur të Islamit ndaj të gjithë botës. Ja, kjo është edhe frika e vërtetë e atyre që kanë shpikur Islamofobinë.

Nëse brezave nuk u jepet feja, domethënë baza shpirtërore, ata ngelin si një civilizim me një këmbë të vetme, që ekranet dhe rrjetet e padukshme të internetit e kanë lidhur me zinxhirë njëra-tjetër. Si rezultat, lidhja biologjike e prindërve nuk shpreh asnjë gjë.

Për këtë arsye, institucionet që do të hedhin fenë dhe themelet shpirtërore në botën e zemrave të fëmijëve tanë, janë shumë të rëndësishme.

Kurset e Kuranit, medresetë dhe të gjitha përpjekjet që jepen në këtë fushë janë shumë të rëndësishme.

Këto përpjekje janë shumë të rëndësishme për të edukuar një brez të devotshëm, që e zbaton Islamin dhe që do të bëhet dëshmitar i Zotit (xh.sh.), me vetëdijen e ihsanit...

Ata që edukohen me këtë bazë shpirtërore në këtë kohë të fundit dhe që mund ta vendosin dijen në vendin e saj të vërtetë e të dobishëm, mund ta reflektojnë fytyrën e qeshur të Islamit ndaj të gjithë botës. Ja, kjo është edhe frika e vërtetë e atyre që kanë shpikur Islamofobinë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë kështu duke e krahasuar pothuajse me sahabët brezin e myslimanëve që do të vijnë në kohën e fundit:

“Shembulli i umetit tim është si shembulli i shiut, ndaj nuk i dihet nëse fillimi i tij është më i mirë apo fundi i tij! (Edhe fillimi, edhe fundi i tij është i mirë!)” (Tirmidhi, Edeb, 81/2869; Ahmed, III, 130.)

Po, brezat që vijnë duhet t'i edukojmë me rregullat e devotshmërisë që kanë pasur sahabët e nderuar.

SI SAHABËT

Koha e sotme është e mbushur plot me vështirësi. Kështu që në kohët e vështira, ajo që e shpëton njeriun është vetëm devotshmëria.

Kur Profeti (a.s.), i edukoi sahabët e tij, askujt nuk i dha në dorë letër dhe laps. Atyre u dha zemër. U dha një zemër të pastër. Ai gjithmonë i inkurajoi që të ishin të devotshëm. Ndër të tjera ka thënë:

“Ata që janë më afër meje prej njerëzve, janë të devotshmit kundrejt Allahut kushdo qofshin dhe kudo qofshin ata.” (Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)

Edukimi që dha ai, ishte një dije e përjetueshme që transmetohej jo nga rreshtat, por nga zemrat.

Edhe sahabët, të cilët morën këtë edukim të veçantë, e bënë të gjithë sipërfaqen e kësaj bote nga Semerkandi e deri në Afrikën Veriore shkollë të kësaj dijeje shpirtërore të dobishme. Sot në çdo vend ku kanë arritur përpjekjet e frytshme dhe të begata të atyre, duket Islami.

Ja pra, edhe ne duhet ta trashëgojmë këtë dije dhe

t'ua transmetojmë brezave të ardhshëm.

Edhe sot, një nënë dhe baba i mëshirshëm, një nënë dhe baba që dëshiron t'i lërë trashëgimi fëmijëve të tyre, të mos harrojnë se trashëgimia më e rëndësishme është trashëgimia e botës tjetër.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Prindërve të atij që e lexon Kuranin Fisnik dhe punon me të, Ditën e Gjykimit do t'u vihet një kurorë. Drita e kësaj kurore është më e bukur se drita që jep dielli kur bie në një shtëpi në këtë botë. Atëherë, pa mendoni se si mund të jetë drita e atij që punon vetë me Kuranin Fisnik?” (Ebu Davud, Vitri, 14.)

Por ja që dija e thatë nuk është e mjaftueshme. Madje, edhe nëse prindërit e bëjnë fëmijën e tyre profesor të tefsirit apo profesor të Kuranit. Nëse nuk ka devotshmëri, çdo gjë është e pamjaftueshme, sepse Islami kërkon adhurim në çdo fushë të jetës. Islami kërkon adhurim jo vetëm në një fushë, por në çdo frymë dhe në çdo hap.

Dije të thatë kanë edhe orientalistët që e studiojnë Islamin nga jashtë. Kjo dije nuk do t'u japë dobi atyre as në këtë botë, as në botën tjetër. Përkundrazi, mund t'ua shtojë edhe më shumë humbjen.

Sa bukur i shpreh nevojat tona Aliu (r.a.):

“Dija është trashëgimia më e mirë. Morali është arti më i mirë. Devotshmëria është ushqimi më i mirë. Ibadeti është kapitali më i mirë. Vepra e pranuar te Zoti është udhëzuesi më i mirë. Morali i lartë është miku i afërt më i mirë. Butësia është ndihmësi më i mirë. Të mjaftuarit me atë që kemi, është pasuria më e mirë. Meditimi rreth vdekjes është këshilluesi më i mirë.”

Përfundimisht, për çdo ditë që kalon, bota jonë vazhdimisht po ndotet nga çmenduria e jetës së dhënë pas pasioneve.

Kundërhelmi është vetëm Islami.

Shërimi i kësaj sëmundjeje është Islami i përjetuar me devotshmëri.

Rrugëzgjidhja e këtij tmerri është Islami që e solli i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte mëshirë për botët.

O Zot!

Të kërkojmë mbrojtje nga dija e padobishme! Na jep dije të vërtetë, e cila do të jetë bazë e fortë për ne përgjatë rrugës së marifetullahut dhe do të na e shtojë meditimin, devotshmërinë, frikën e respektin ndaj Teje!

Na e mundëso që t'ua transmetojmë brezave tanë dijen e përshpirtshmërisë, e cila është trashëgimi e botës tjetër!

Amin!..

El-Melik

SUNDUESI I PAFILLIM DHE I PAFUND

Ilir Hoxha

Ky emër i bukur, që në leksik ka kuptimin “zotërues dhe sundues”, rrjedh nga rrënja “milk/mulk/melk”. Ndërsa kuptimi terminologjik i këtij emri, është: “Ai që zotëron/sundon në mënyrë absolute të gjitha botët e dukshme dhe të padukshme dhe i menaxhon ato sipas dëshirës”. Shkurtimisht, shpreh sundimin e padiskutueshëm dhe të pakufizuar nga asnjë kusht, të Allahut, në këtë botë dhe në botën tjetër.

Kurani Fisnik, duke përdorur fjalë të ndryshme që burojnë prej rrënjës “mulk dhe milk”, i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe theksimit të faktit se, “çdo lloj sundimi i takon Allahut”.¹

Në këtë kuptim, sunduesi absolut është Allahu. Cilësimi me këta emra i njerëzve, të cilët nuk kanë në dorë as jetën e tyre, është metaforik dhe jo i vërtetë. “Milk”, shpreh sundimin mbi njerëzit. Ndërsa “Mulk”, shpreh autoritetin menaxhues mbi gjërat. Nisur nga kjo, fjala “Melik”, që buron prej rrënjës “Milk”, është emri i fuqisë që menaxhon shoqërinë për interesat e përbashkëta. Ky “menaxhim”, bëhet në formën e marrjes së masave, vendosjes së rregullave dhe zbatimit të ligjeve sipas rezultatit të sjelljeve. Drejtimi bëhet me anë të rregullave dhe kjo vlen edhe për Vetë Allahun, sepse Ai çdo sjellje e ka lidhur me një rregull (sunetullah). Në këtë mënyrë, Ai ua ka bërë të ditur që në fillim robërve të Tij se si do ta përdorë autoritetin e Tij të të qenit “Zoti i Botëve”, duke treguar se mbi asgjë nuk do të ketë sundim pa rregulla.

Shprehja “Malik-i Jeumi’d-din/Sunduesi i Ditës

së Gjykimit”, në suren Fatiha, thekson se në Ditën e Kiametit, njeriut do t’i merret nga dora sundimi i përkohshëm mbi gjërat që ka në këtë botë dhe do të mbetet vetëm sundimi i Allahut, i Cili është sunduesi i pafillim dhe i pafund.²

Atë ditë, vetëm ata që kur ishin në këtë botë pranuan të jenë qytetarët e vendit të Zotit, duke besuar se Meliku/Zotërues/Sunduesi i vërtetë është Allahu, do të marrin pjesën e tyre (sipas gradëve) të lumturisë. Ndërsa të tjerët që nuk e pranuan si Melik të vetëm Sundimtarin e vërtetë, do të shijojnë pafundësisht fatin e tyre të keq.

Në Kuranin Fisnik, gjenden disa ajete që tregojnë se gjithçka është e Allahut, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Këto shprehje, pasohen nga emrat e Allahut, që tregojnë se Ai është sigurues, shpëtues, dhënës i paqes, mëshirues dhe Zoti i njerëzve³. Të gjitha këto shprehje shpresëdhënëse, tregojnë se edhe pse Zoti ynë ka fuqi absolute, falja, siguria, shpëtimi dhe mëshira i paraprijnë asaj.

Cilësia Meliku’l-Mulk/Sunduesi i çdo lloj pasurie, shpreh faktin se Allahu i Madhëruar është autoriteti menaxhues i botës së dukshme. Ndërsa cilësia Maliku’l-Melekut, shpreh faktin se Ai është sunduesi i botëve të padukshme. Për këtë arsye, ai që e bën mbizotërues brenda dhe jashtë vetes autoritetin e Allahut për të drejtuar dhe urdhëruar, është besimtar. Ai që e bën mbizotërues vetëm në botën e tij të jashtme, është hipokrit. Ndërsa ai që në botën e tij të brendshme e pranon autoritetin e Allahut, por

1. - shih. Al-i Imran, 189; Fatir, 13; Mulk, 1; En’am, 75; A’raf, 185; M - minun, 88; Jasin, 83.

2. - shih. Infitar, 19; Gafir, 16.

3. - shih. Fatiha, 1-4; Hashr, 22-23; Furkan, 26; Nas, 1-2.

në botën e jashtme nuk e reflekton këtë të vërtetë, quhet gjynahqar. Dhe, me qëllim që njeriu të arrijë ta kuptojë këtë sundim dyanësh të Allahut, Ai i ka dhënë atij edhe sytë e ballit, edhe sytë e zemrës.

Kushejri thotë se ai që arrin vetëdijen se Allahu është sunduesi i vetëm, nuk i përulet asnjë krijese. Fakti që njerëzit braktisin nderin dhe parimet morale për të marrë pushtet dhe që janë gati të bëjnë gjithçka për para, bëhet shkak që njerëzit të cilët i posedojnë këto mundësi, të krijojnë iluzionin se ata zotërojnë një fuqi të pakufishme. Për këtë arsye, njerëzit që zotërojnë çfarëdolloj fuqie (pozitë, para, etj.), pandehin se në sajë të kësaj fuqie mund të hapin çdo derë. Dhe kjo, pak a shumë buron edhe prej faktit se njerëzit përreth i krijojnë marrëdhëniet në bazë të fuqisë. Pra, nëse ne vazhdojmë t'i japim rëndësi forcave të përkohshme të kësaj bote, e jo Maliku'l-Mulukut, nuk bëjmë gjë tjetër veçse vazhdojmë të ushqejmë mizorinë e tyre mbi ne.

Gjithsesi, mos përlulja jonë vetëm ndaj forcave të jashtme, nuk mjafton që ne të jemi të virtytshëm. Ndërkohë që njeriu fiton lirinë e tij të jashtme, nuk duhet ta lërë jashtë kontrollit mbizotërimin ndaj egos dhe trupit të tij dhe nuk duhet ta neglizhojë rrugën për t'u bërë sundues i botës së tij të brendshme.

Kur Allahu na jep për një farë kohe ndonjë mirësi prej pasurisë së Vet, në vend që ne ta pandehim veten dikushi e të mburremi me këtë, duhet të përpiqemi që në sajë të asaj mirësie, të fitojmë grada të përhershme pranë Allahut. Po ashtu, njeriu nuk duhet t'i harrojë detyrat e tij të adhurimit dhe devotshmërisë ndaj Sunduesit të gjithçkaje, duke e pandehur veten

dikushi vetëm sepse mund të bëjë ndonjë mirësi përreth. Të mos harrojmë se, edhe një pjesë e madhe e kafshëve janë të dobishme për njerëzit, por kjo, nuk mjafton që ato të shkojnë në Xhenet.

Gjithashtu, njeriu, të cilit i është falur pasuri në sajë të këtij emri të bukur hyjnor, duhet të shohë se si sillet Allahu me pronën e Tij, ndërkohë që është edhe sundimtari i vërtetë i kësaj prone, duke vepruar edhe ai në atë mënyrë. Pra, ashtu siç nuk bën koprraci, nuk duhet të bjerë as në gabimin e shpërdorimit në mënyrë të pakontrolluar. Ai duhet të dijë se sunduesi i vërtetë i gjithçkaje është Allahu. Nisur nga kjo, ai nuk duhet t'i çmojë njerëzit në bazë të pasurisë së tyre.

Përveç të gjitha këtyre, njeriu që ndodhet në pozitën e drejtimit të çfarëdolloj çështjeje në tokë si manifestim i emrit “Melik”, duhet që asaj pune t'i dalë zot dhe ta zotërojë plotësisht në çdo proces të saj. Kjo, sepse mungesa e drejtimit që buron prej dobësisë dhe paaftësisë, bëhet shkak i humbjes së pasurisë.

Si përfundim, çdo gjë në këtë botë, të cilën pandehim se e zotërojmë, në fakt na është lënë në përdorim vetëm si amanet dhe nuk është asgjë tjetër përveçse një dobi e përkohshme e kësaj bote. Ne dhe çdo gjë që ne pandehim se e zotërojmë, i takon plotësisht Allahut. Dhe, për të mos rënë në gabim lidhur me këtë çështje, nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se në pronën e Tij ne jemi vetëm udhëtarë që qëndrojnë si mysafirë.





NJIHNI VETEN DHE ARRINI LUMTURINË

Me qëllim që njerëzit në të gjithë botën të kujtojnë lumturinë dhe t'ia urojnë atë njëri-tjetrit, në vitin 2012 OKB e shpalli 20 Marsin "Dita botërore e lumturisë". Duke filluar që prej selisë qendrore të OKB, që ndodhet në SHBA, në shumë vende që janë anëtare të OKB, zhvillohen veprimtari edukative, kulturore e sociale, ndërsa organizatat e ndryshme civile, shoqatat dhe fondacionet përhapin mesazhe të shumta në këtë ditë festive.

Lidhur me këtë çështje, Rektori i Universitetit të Uskudarit në Stamboll, Prof. Dr. Nevzat Tarhan, thekson se, *"ekzistojnë dy kushte themelore që njerëzit të jenë të lumtur: Kushti i parë, është që njeriu të njohë veten, të kuptojë ndjenjat e veta, të jetë i aftë t'i orientojë ato dhe të veprojë me ndihmën e tyre. Ndërsa kushti i dytë është të ketë komunikim me njerëzit e tjerë dhe në këtë mënyrë të kuptojë edhe ndjenjat e palës tjetër. Arritja e lumturisë varet nga komunikimi i drejtë."* Për më tepër, Prof. Dr. Nevzat Tarhan, na jep këto këshilla:

Arritja e lumturisë varet nga komunikimi i drejtë, sepse askush nuk mund të jetë i lumtur në vetmi. Njerëzit u drejtohen psikologëve më tepër për shkak të mungesës së lumturisë. Për këtë arsye, njëri prej qëllimeve të profesionit tonë është të kontribuojmë në paqen dhe lumturinë e shoqërisë sonë. Një nga shkaqet më të mëdha të mungesës së lumturisë është kërkimi i saj në vende të gabuara. Personit, i cili i drejtohet specialistit për të gjetur rrugën e paqes së brendshme, duhet t'i thuhet; "lumturia jote nuk është në këtë fushë, por në këtë fushë!", duke e orientuar atë në vendet e duhura. Për shembull, njeriu ndonjëherë nuk i sheh trëndafilat para dritares së vet, por dëshiron të arrijë një kopsht me trëndafila sipas imagjinatës së vet. Kjo do të thotë ta kërkojë lumturinë në vend të gabuar.

Nevoja e njeriut për lumturi ka filluar prej momentit që ai është krijuar. Mësimet morale që e vazhduan ndikimin e tyre deri në shekullin modern, i ofruan njeriut formula të ndryshme në lidhje me arritjen e lumturisë. Mirëpo, stili i jetës që ka ofruar periudha moderne, nuk ka arritur të gjejë një zgjidhje për këtë

problem. Në shekullin që po jetojmë, njerëzit hyjnë në depresion, e më pas kërkojnë të kurohen. Mirëpo, të jesh i lumtur, është ndryshe nga kurimi i një personi që ka hyrë në depresion.

Tek njeriu ekziston prirja e ikjes prej dhimbjes. Shkencëtarët perëndimorë, flasim për tri prirje gjenetike që e shtojnë njeriun drejt varësisë. E para prej këtyre lidhet me sjelljen e kërkimit të përtëritjes që funksionon me sistemin dopaminergjik. Prirja e dytë është në drejtim të ikjes prej dëmit që funksionon me sistemin serotoninergjik. Ndërsa e treta, është varësia e shpërblimit, e cila shpreh lidhjen e njeriut me gjërat që i pëlqejnë dhe kënaqet prej tyre. Kjo mund të jetë varësia ndaj pijes, kumarit, seksit, teknologjisë, luksit etj. Prandaj është e domosdoshme që këto prirje të lumturisë së njeriut të orientoohen në qendrën e duhur. Përndryshe, njeriu do t'u hyjë aventurave. Madje, me këtë lidhen edhe rastet kur njeriu dëshiron të ndryshojë veten, të zhvillohet ose të bëhet radikal.

Për të qenë i lumtur, duhet të jesh i vetëdijshëm dhe të ecësh drejt së mirës. Dhe, për formimin e vetëdijes, do të na duhet ta njohim mirë biologjinë tonë. Për shembull, lumturia ka parametra që përbëhen prej elementëve truporë, mendorë, ndjesorë, shoqërorë dhe profesionalë. Për rrjedhojë, të gjithë këta parametra duhen marrë parasysh në arritjen e lumturisë së vërtetë. Dikush mund të ketë shëndet të mirë trupor, i cili është i domosdoshëm për ndërtimin e lumturisë, por kjo nuk mjafton, sepse edhe lumturia mendore është shumë e rëndësishme. Sigurisht që vetëm njohuria rreth këtyre është e pamjaftueshme. Që lumturia të vihet në jetë, ajo duhet mbështetur nga ana shpirtërore dhe të reflektohet në marrëdhëniet njerëzore. Në lumturinë sociale e rëndësishme është përshtatja me familjen dhe rrethin miqësor, ndërsa në lumturinë profesionale, e rëndësishme është përshtatja me rrethin dhe jetën e punës. Të gjitha këto, formojnë pesë kriteret kryesore që njeriu të mund të thotë "jam i lumtur".

DIZAJNI: SI TA SHNDËRROSH SHPIRTIN NË TRUP

Edison Çeraj

Një nga fenomenet më të heshtura dhe më të zhurmshme njëherësh të kësaj kohe është edhe dizajni. Individë, grupe e lëvizje të caktura, kompani, shoqata, biznese, parti politike, qytete, shtete e perandori madje kanë prirjen të vetëprojektohen përmes një imazhi të caktuar, i cili vjen nën arsyetimin se e kërkon koha, është kërkesë e kohës. Në fakt, kjo ka ndodhur edhe në të kaluarën, por sot funksionon krejt ndryshe.¹

Le të zbresim ca më poshtë: gati çdo produkt sot, nga ai më pak i rëndësishmi tek më i rëndësishmi, shfaqet para nesh i mbështjellë/i mbuluar nëpërmjet dizajnit, që tanimë shënon një ndërmjetës të pashmangshëm në marrëdhëniet mes njerëzve. Edhe kjo nën arsyetimin se e tillë është koha. “Duhet t’i bësh për vete njerëzit.” E gjitha i ngjan një rrjete (*web*) – sado që të ruhesh nuk ke nga ia mban pa ngecur herë pas here.

Siç mund ta marrim me mend dhe me sa provohet çdo ditë, qëllimi i dizajnit është thjesht joshja shqisore, domethënë, mjaft ta bëjë për vete njeriun duke e reduktuar në “klient”, duke përdorur çdo mënyrë të mundshme² për këtë (deri edhe kurmin e engjëllit të një bebeje), dhe çdo lëvizje e tij mund të parashikohet paskëta. Sa më shumë joshje aq më pak arsyetim, aq më pak mendim. Sa më shumë joshje, aq më shumë tufëzim, aq më pak individualitet.

Kështu dizajni nuk është vetëm një fenomen estetik, por edhe etik, sidomos etik. Siç e shpreh edhe Goys-i, “dizajni mori përsipër një përmasë etike që nuk e kishite pasur më parë. Në dizajn, etika bëhet estetikë; ajo bëhet formë. Dizajni u shfaq prej aty ku ishte religjioni dikur. Subjekti modern tashmë ka një detyrë të re: detyrimin për t’u vetëprojektuar, paraqitjen estetike si subjekt etik”.

Nën këtë mbretëri të dizajnit, e përfaqësuar nga një numër i pallogaritshëm imazhesh që lindin e vdesin

1. “Dizajni, ashtu siç e njohim ne sot, është një fenomen i shekullit të njëzetë. Pa dyshim që problemi për dukjen e gjërave nuk është i ri. Të gjitha kulturat janë marrë me krijimin e veshjeve, objekteve të përditshme, interierëve të gjithfarë hapësirave, qofshin hapësira të shenja, hapësira të pushtetit, a hapësira private, “të bukura e mbresëlënëse”. Historia e arteve të aplikuara, në të vërtetë është e gjatë. Por, dizajni modern doli në dritë pikërisht nga revolta kundër traditës së arteve të aplikuara. Madje, më tepër sesa kalimi nga arti tradicional te arti modernist, kalimi nga artet e aplikuara te dizajni modern shenoi një thyerje me traditën, një ndryshim rrënjësor të paradigmes (modelit).” (Groys, B. *Politika e instalacionit*, f. 20. Përkth.: Irena Buzi. Tiranë: Princi, 2015)

2. Qëllimi e justifikon mjetin.

çdo minutë, konstatohet – veçmas pas Revolucionit Industrial – një lloj tërheqjeje e estetikës autentike që karakterizonte hapësira të caktuara gjeografike, të cilat ishin enë të ndara por komunikuese me njëra-tjetrën, që merrnin e jepnin mes veti.

Natyrisht që nuk mund të flitet prerë apo në formë të përgjithësuar në këtë kontekst dinamik, por bie në sy dhe ndjehet revanshi i dizajnit kundrejt estetikave burimore, nëse mund t’i emërtojmë kështu. Dizajni po i mbulon ato njërin pas tjetrit.³ Dizajni është mbulim.

Dizajni vepron pa asnjë kompromis në emër të një bote të reduktuar magjishëm në treg, të cilit nuk i mjafton numri aktual i popullsisë botërore, edhe sikur të ishte edhe një herë sa është.

Në gjithë këtë stuhë mbuluese, e për rrjedhojë një-suese⁴, të veçohesh për të lëvruar një estetikë autentike (artistët), për ta ripërtërirë një syresh (kuratorët, arkitektët etj.) apo për t’u përqendruar në çaste edukuese i ngjan ndërmarrjes së një murgu, sepse kemi të bëjmë me një tërheqje apo dalje nga radha, e cila gjen mundësi të lërë shenjën e saj edhe nëpër ëndrrat tona, aty ku jo rrallë sublimohet dëshira për të pasur.

Ngjan sikur estetikave burimore – kaq të ndryshme në shpërfaqje⁵ – u janë prerë rrënjët dhe si të tilla ato kanë mbetur në një gjendje statike, që as marrin, as japin. Kemi të bëjmë me një lloj ngecjeje, qëndrim në vendnumëro; sikur janë futur në muze. Një prej arsyeve kryesore për këtë është edhe revanshi i dizajnit, ndikimi i të cilit është i paimagjinueshëm.

E gjalla është pasive, e vdekura aktive.

Krijimtaria artistike është edhe një histori rikthimesh të përhershme, si nevojë për t’u përmendur, për të kujtuar, për të mos u ndjerë i huaj (pa rrënjë), për të kuptuar të tashmen dhe për të pasur një vizion për të ardhmen. Kjo është e nevojshme për çdokënd, jo vetëm për artistët. Këta të fundit na e kujtojnë, prandaj janë quajtur “antena e njerëzimit”⁶.

3. “Lindja e dizajnit modern lidhet thellësisht me projektin e ridizajnimit të njeriut të vjetër brenda Njeriut të Ri.” (Po aty)

4. Udhëtimi është një ilaç me efekt të shpejtë kundër flamës së njësimi.

5. Por, me një qëllim, të njëjtë: ndërmendja e asaj që priremi ta harrojmë dhe angazhimi për cilësinë e jetës.

6. Heidegger.

ISLAMI E MALLKON ASTROLOGJINË!

Muaz Erdem

Që prej kohës së Ademit (a.s.), e deri më sot, kanë ardhur e kanë shkuar me miliarda njerëz. Dikush i besoi Allahut dhe shpëtoi e dikush tjetër ra në devijimin e idhujtarisë, duke adhuruar zjarrin që ndizte vetë, idhullin që bënte prej hallvës, Diellin ose yjet dhe u bë lëndë zjarri për Xhehenem. Ky hadith e tregon shumë mirë dallimin midis këtyre dy lloje njerëzish:

Zejd ibn Halid (r.a.), tregon:

“Kur ishim në Hudejbije, Profeti ynë (a.s.), na fali namazin e sabahut pas shiut që ra gjatë natës. Pas namazit doli para xhematit dhe tha: ‘A e dini se çfarë ka thënë Zoti juaj?’ Xhemati tha njëzëri: «Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë!» Më pas Profeti (a.s.), tha: «Allahu ka thënë: “Një pjesë e robërve të mi janë gdhirë si besimtarë ndaj Meje, ndërsa një pjesë si mohues. Kush thotë: «Ra shi në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Allahut», është gdhirë si besimtar ndaj Meje dhe mohues ndaj yjeve. Por kush thotë: «Ka rënë shi në sajë të filan ylli», është gdhirë mohues ndaj Meje dhe besimtar ndaj yllit!” (Buhari, Ezan 156; Muslim, Iman 125, 71.)

Në ditët tona, edhe pse nuk para ka njerëz që adhurojnë yjet, është përhapur shumë besimi se ngjarjet që ndodhin ose do të ndodhin, kanë lidhje me yjet. Për fat të keq, njerëzit janë zhytur në një devijim që quhet “astrologji”, e cila nuk ka aspak lidhje me shkencën. Në sajë të interesimit të madh të njerëzve ndaj kësaj fushe, shumë njerëz bosh që i thonë vetes “astrologë”, po pasurohen e po jetojnë në luks. Midis

atyre që tregojnë interes për këta njerëz, ka edhe shumë besimtarë myslimanë. Ndërkohë që astrologët po pasurohen e po bëjnë qejf të zhytur në luks, njerëzit e talentuar që janë diplomuar në fushën e astronomisë, nuk po arrijnë të gjejnë punë.

Megjithëse astronomia dhe astrologjia ngjasojnë disi për nga emri, ato nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën, sepse astronomia studion në mënyrë “shkencore” yjet, planetët, galaktikat, trupat qiellorë dhe fenomenet e tjera të kozmosit në bazë të urdhrit të Allahut “Lexo!”. Kurse astrologjia, në të kundërt të astronomisë, është një emër i shpikur prej disa njerëzve të cilët përfitojnë prej kureshtjes së njerëzve për kozmosin dhe nuk ka asnjë bazë shkencore apo fetare.

Njerëzit indiferentë që merren me këtë punë të padobishme, e përkufizojnë astrologjinë si “degë shkencore që (gjoja) studion ndikimin e yjeve tek njerëzit”. Ky përkufizim i tyre, tregon qartë se astrologjia nuk ka të bëjë aspak me shkencën, sepse prej dijeve tona në lidhje me astronominë, dimë se Dielli na mbron prej çdo ndikimi që mund të vijë prej yjeve të tjerë. Fusha e mbrojtjes që na siguron Dielli, është në formë sferike me sipërfaqe prej 30 miliardë kilometrash dhe përfshin të gjithë Sistemin Diellor. Kufijtë e kësaj sfere quhen “heliopause”. Në këtë pikë erërat dhe grimcat që vijnë prej yjeve të tjerë dhe ato që vijnë prej Diellit barazohen me njëra-tjetrën. Pra, shkurtimisht, yjet nuk kanë asnjë ndikim fizik mbi njerëzit.

Një argument tjetër që tregon se astrologjia nuk është një degë e shkencës, është mospërputhshmëria në horoskop. Datat dhe pozicioni i Diellit përballë yjësive, përcaktojnë se cilës shenjë të zodiakut, që mban emrin e një yjësie, i përket njeriu. Mirëpo, nëse shikoni me kujdes, do të vëreni se ndër dymbëdhjetë shenja zodiaku, ka prej atyre që nuk lidhen me asnjë yjësi. Ky është një nga argumentet më të qartë që tregon se astrologjia është thjesht diçka e shpikur dhe pa baza.

Një aspekt tjetër është se Dielli rrotullohet vazhdimisht rreth qendrës së galaktikës sonë, pra Rrugës së Qumështit. Për këtë arsye, yjësitë që ndodhen para Diellit lëvizin vazhdimisht prej datave të caktuara. Kështu që në mënyrë të natyrshme duhen ndryshuar edhe datat që përputhen me shenjën e zodiakut. Dhe fakti se këto data nuk ndryshojnë asnjëherë shpalos para syve tanë të vërtetën e mospërputhjes së tyre.

Ashtu siç nuk ka arritur të gjejë një vend në shkencë, astrologjia ka mbetur edhe jashtë fesë sonë, Islamit. Dijetarët që kanë jetuar në të shkuarën, as nuk e kanë pranuar dhe as nuk e kanë aprovuar një gjë të tillë.

Shpjegimi i një hadithi në librin Kutub-u Sitte, e mbështesin plotësisht këtë që po themi: “Siç dihet, edhe në ditët tona ekzistojnë disa fjalë të pabaza në lidhje me ndikimin e yjeve dhe yjësive që quhen zodiakë dhe njihen si “parashikimi i yjeve”. Islami u ka dhënë fund besimeve besëtyte në lidhje me yjet. Ekzistenca e atyre që ende sot i besojnë ndikimit të yjeve dhe e myslimanëve që kalojnë kohën duke parashikuar fatin me yjet, është një gjendje për të ardhur keq.”

Po e mbyllim shkrimin tonë me një hadith fisnik në lidhje me këtë çështje:

“Allahu i ka krijuar këto yje për tri arsye: I bëri ato zbukurim të qiellit, gurë me të cilët goditen shejtanët (që ngrihen në qiell për të marrë lajme të fshehta) dhe shenja me anë të të cilave gjendet drejtimi. Kush tenton të bëjë interpretime të tjera në lidhje me yjet, gabon dhe humbet kismetin e vet, duke e vënë veten në pozitë të vështirë në një çështje që nuk i intereson dhe nuk ka dije, e madje që edhe profetët dhe melekët janë të dobët.” (Kutub-u Sitte, hadithi nr: 5759.)

Pasuria e humbur E BESIMTARIT

Muaz Erdem

Kur zgjohemi çdo mëngjes, i hapim sytë në një botë plotësisht të re, sepse shkenca përparon aq shpejt sa është e vështirë ta ndjekim. Nga një anë zbulimet në fushën e biologjisë, fizikës si dhe zbulimet e shpikjet e reja në fushat e tjera të shkencës vazhdojnë të shtohen me një grafik që rritet vazhdimisht. Mirë, po në çfarë gjendje jemi ne, Umeti i Muhamedit (a.s.), në gjithë këtë proces zhvillimi? Ose në çfarë gjendje duhet të jemi?

Besoj se nuk ka nevojë të japim përgjigje për pyetjen e parë, sepse këtë përgjigje mund ta gjejmë

shumë mirë duke parë përreth nesh. Në xhepat tanë kemi telefonë Samsung, i-Phone etj., ndërsa në duar tableta. Shkurtimisht, një dorë e kemi në vaj, e një dorë në mjalte. Kjo gjendje rehatie na ka penguar nga kureshtja për të mësuar se si punojnë këto aparate. Pra, ne mjaftohemi duke ngrënë rrushin dhe nuk pyesim për vreshtin. Kjo indiferencë, në mënyrë të natyrshme na ul në pozitën e spektatorit përballë shkencës dhe teknologjisë që zhvillohet përditë.

Ne jemi duke e paguar çmimin e dembelizmit tonë dhe nëse vazhdon kështu, do të vazhdojmë ta pa-



guajmë edhe më shumë, sepse kështu ka ndodhur gjatë gjithë historisë njerëzore. Popujt që i kanë dhënë rëndësi shkencës dhe dijes, gjithmonë kanë dominuar mbi popujt e tjerë. Kjo është një e vërtetë e pandryshueshme.

PERIUDHA E ARTË E MYSLIMANËVE

Arabët, nën ndikimin e Islamit me të cilin ishin njohur në sajë të profecisë së Muhamedit (a.s.), arritën të fitojnë më shumë kulturë dhe vetëdije në krahasim me të shkuarën. Myslimanët të cilët e bënë parim të tyrin hadithin e Profetit tonë (a.s.), *“Dija është pasuria e humbur e besimtarit. Ai e merr atë kudo që të gjendet”*, e shtuan dita ditës interesin e tyre ndaj dijes dhe shkencës. Përhapja me shpejtësi nëpër botë e myslimanëve duke filluar prej gadishullit arabik, ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e interesit për dijen.

Pas Epokës së Lumturisë, myslimanët përjetuan për herë të dytë epokën e tyre të artë në kohën e halifit Me'mun, i cili nga një anë punoi që t'i jepte fund përplasjeve medhhebore të myslimanëve, duke u përpjekur t'i bashkonte ata, ndërsa nga ana tjetër i dha më shumë rëndësi veprimtarive shkencore dhe kulturore, duke rritur standardin e mirëqenies së popullit. Me'muni, i cili i dha një rëndësi të madhe dijes, filloi një lëvizje të jashtëzakonshme në fushën e përkthimeve. Me anë të kësaj lëvizjeje, përktheu në arabisht veprat e njerëzve të ditur grekë dhe në këtë mënyrë, arriti ta ngrejë me shpejtësi edhe nivelin e edukimit të myslimanëve.

Myslimanët, të cilët i kuptuan në një kohë shumë të shkurtër dijet në librat e përkthyer, u bënë në gjendje të diskutonin e të kritikonin dijet e marra prej grekëve, e madje edhe t'i korrigjonin ato me të saktat. Myslimanët, që arritën të gjenin pasurinë e tyre të humbur, nuk u mjaftuan me kaq, por arritën të zhvillonin mjete të reja, duke bërë matje gjeografike dhe astronomike që do të kalonin në histori. Në mënyrë të veçantë, në matjet e sakta astronomike që u bënë në atë kohë, padyshim kanë luajtur rol të rëndësishëm observatorët që u ndërtuan prej kalifit Me'mun.

HUMBËM PASURINË TONË

Kur hymë në shekullin e XV, për fat të keq vlera që myslimanët i jepnin dijes ishte pakësuar shumë dhe për këtë arsye zhvillimet pothuajse kishin arritur fazën e ndalesës. Megjithatë, edhe në këtë gjendje ne ishim shumë herë më lart se Evropa në aspektin shkencor...

Perëndimorët, të cilët vunë re pasurinë e librave shkencorë në bibliotekat e myslimanëve, filluan t'i përkthenin këto vepra në gjuhët e veta. Veprat që u përkthyen formuan themelet e revolucionit ndriçues që në librat e historisë njihet si “Renesancë/Rilindje”. Mirëpo, ngritja e perëndimorëve në nivelin që kishin arritur myslimanët, zgjati më shumë, sepse evropianët nuk kishin një fe si Islami, e cila e mbështeste shkencën. Kisha vazhdimisht e ka bllokuar përparimin shkencor, ndërsa njerëzit e dijes i ka gjykuar në gjyqet e inkuizicionit. Presioni i kishës i ngadalësoi zhvillimet shkencore por nuk arriti t'i ndalojë ato. Më vonë, në sajë të përpjekjeve të njerëzve të dijes, shkencë filloi të zhvillohej me shpejtësi të madhe në Evropë.

Në ditët tona, përparimi dhe epërsia shkencore e Perëndimit vazhdon. Në mënyrë të veçantë, teknologjia hapësinore, në sajë të së cilës jomyslimanët vëzhgojnë pëllëmbë për pëllëmbë të gjithë tokën. Madje, në sajë të satelitëve arrijnë të kontrollojnë raketat e tyre me rreze të gjatë veprimi dhe mjetet fluturuese pa pilot. Gjithashtu, në sajë të rrezeve me gjatësi të ndryshme valësh që i dërgojnë prej satelitëve, ata arrijnë të evidentojnë të gjitha pasuritë nëntokësore.

Neve na duhet të shpëtojmë një orë e më parë prej kësaj indiference në të cilën kemi rënë dhe të vihemi përsëri në kërkim të pasurisë sonë të humbur. Edhe nëse vetë nuk merremi me shkencë, duhet të ndihmojmë vëllezërit tanë që kanë talent në atë fushë. Përndryshe, nënat do të vazhdojmë të qajnë, zemrat tona do të plasën e gjaku do të derdhet pa ndaluar si në Palestinë, ashtu edhe në Siri, Afganistan, Pakistan, Irak etj. Mos harroni! Dija ikën prej vendit ku nuk vlerësohet. Dhe, pasi të ketë ikur lë pas vetëm një tokë të shkretë. *“...A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?...”* (Zumer, 9)

Deshifrimi I KAOSIT

Efekti flutur

Një flutur që rreh krahët në një vend të botës, mund të bëhet shkak i furtunave në një vend të largët. Lorenzi po hapte kapakun e një kauze ironike, por, po aq edhe reale. Kur bëri simulimin në kompjuter të sistemit të parashikimit të motit që kishte ndërtuar, duke kombinuar të dhëna të ndryshme njëra pas tjetrës, vuri re se brenda kompjuterit u krijuan furtuna në sajë të ndryshime të vogla një në një milion. Ai zbuloi se të gjitha këto fenomene të komplikuar të motit, të cilat nuk mund të llogariten e të parashikohen kurrë, në fakt i nënshtroheshin një rregulli të caktuar.

Nëse shohim parashikimet e motit, do të vëmë re se asnjë prej parashikimeve nuk zgjat më shumë se një javë. Ja pra, kjo formon veçorinë e parë të teorisë së kaosit. Paparashikueshmëria dhe pallogaritshmëria... Kur analizat u hodhën në letër, u vu re qartë se ekzistonte një rregull i caktuar. Mirëpo, është kategorikisht e pamundur të parashikohet se çdo të ndodhë brenda një kohe të caktuar (një javë, një muaji, një viti, madje edhe njëmijë viteve).

Vendoseni dorën në zemrën tuaj dhe dëgjoni. Juve ju duket sikur zemra ju rreh gjithmonë me një ritëm të caktuar. Mirëpo, zemra juaj asnjëherë nuk rreh me një ritëm të caktuar. Ajo punon brenda një sistemi kaotik, sepse sipas zbulimeve të fundit në fushën e mjekësisë, “nëse zemra do të punonte me një ri-

tëm të caktuar, ajo nuk do të mund t’i përshtatej dot kushteve të ndryshueshme të jetës (emocioneve, frikës etj.) dhe do të përballeshit vazhdimisht me rrezikun e vdekjes...”

Një shembull tjetër, janë edhe impulsset elektrike që krijohen çdo sekondë. Gjatë tomografive, doktorët shohin se në tru ekziston gjithmonë një lloj zhurme elektrike. Pra, një cërcëritje e pallogaritshme, e parrregullt dhe që mendohet se nuk ka ndonjë qëllim të caktuar. Mirëpo, zbulimet e fundit, tregojnë se edhe truri ynë punon me një sistem kaotik. Madje, njerëzit që shfaqin një aktivitet të rregullt të trurit, diagnostikohen si të sëmurë, si për shembull, të sëmurët epileptikë...

Kristalet e borës, arti i ebrusë dhe gjeometria fraktale...

Lidhur me sistemin e kaosit dhe me faktin se përse ne i kemi deshifruar me kaq vonesë këto sisteme, Mandelbrot shpreh: “Retë nuk janë sferike, malet nuk janë konikë, rrufeja nuk bie drejt dhe guaskat e detit nuk janë të rrafshëta. Atëherë, përse ne merremi me trekëndësha, pentagonë dhe trupat e rregullt gjeometrikë?”

Kjo autokritikë, është për shkak se shkenca dhe njerëzimi e sheh gjithësinë gjithmonë si një sistem që shpjegohet me ekuacione të thjeshta dhe mbështetet në marrëdhëniet shkak-pasojë (qasja deterministe).



Doç. Dr. Sinan Xhanan, botëkuptimin kaotik e shpjegon kështu: *“Asgjë nuk është aq e thjeshtë sa mund të duket. Neve gjithmonë na kanë treguar se gjallesat janë makina shumë të komplikuar. Mirëpo, asnjë gjallesë nuk është makinë.”*

Gjeometria fraktale, përkufizohet si forma e reflektimit në pamje vizuale të teoremës së kaosit. Këto pamje zotërojnë një rregull artistik brenda një kompleksiteti, që formohen duke u mbështetur në llogaritjen e pafundme të formulave të thjeshta matematikore. Shembujt më të bukur të këtyre grafikave “artificiale” në jetë, janë arti i ebrusë dhe kristalet e borës. Me miliona molekula uji dhe boje, formojnë vepra arti kaotike me kompleksitet të pallogaritshëm në sajë të prekjeve delikate të një artisti. Kurse kris-

talet e borës, janë vepra arti ku gjeometria fraktale është përpunuar në formën më delikate. Aq, sa është e pamundur të gjesh dy flokë dëbore që i ngjajnë njëra-tjetrës.

Padyshim se kjo bukuri e pashoqe dhe gjeometria e mahnitshme e flokëve të borës, janë manifestim i emrit të bukur të Allahut “el-Bedi / Ai që krijon pa model të mëparshëm”. Kristalet e borës që formohen prej molekulave të ujit, marrin formë me ftohjen e avujve të ujit. Nëse i shohim me vëmendje këto detaje të imëta në jetën tonë, do të vëmë re ekzistencën e një arti të pashoq, do të sodisim bukurinë e veprave të këtij arti dhe do të arrijmë njohjen e Krijuesit të tyre.

Jeta fshihet në detaje...

Të adhurosh vëcin e artë “SHKENCËN”

“Populli i Musait, pas largimit të tij, filloi të adhuronte një vëc të bërë nga stolitë e tyre të arta. Ai kishte një zë si të lopës. A nuk e shihnin ata se ai as nuk mund t’u fliste, as t’i udhëzonte në rrugë të drejtë?! Ata e zgjodhën këtë vëc për adhurim dhe u bënë keqbërës.” (A’raf, 148)

Sa herë që e dëgjoj nuk mund të rri pa menduar: “Ndërkohë që një njeri sheh me sytë e vet shtatë mrekulli, sheh ndarjen e detit, rënien e shkurtëzave dhe ëmbëlsirës prej qiellit dhe ka pranë profetët e Zotit si Musain dhe Harunin, si arrin të adhurojë një “vëc të artë”, sapo profeti i tyre kthen shpinën e

shkon dyzetë ditë në malin Tur?”

Duket shumë e çuditshme... A mund të shkaktojë harresa një rebelim në një kohë kaq të shkurtër? E si është e mundur të shfaqet tek njeriu një harresë në një kohë kaq të shkurtër? Duket qartë se, kjo ishte një sprovë shumë e madhe. Me sa duket viçi i artë që bënë duke shkrirë stolitë e tyre prej ari, do t'u jetë dukur shumë interesant. Samiri i orientoi besimtarët e Allahut të adhurojnë idhullin e viçit të artë. Sa herë që prej viçit dilyn zëra të çuditshëm, të uriturit për “frymën dhe zërin hyjnor”, nuk mundën ta përmbanin veten nga mbytja në det së bashku me faraonin...

Që prej asaj ndodhie kanë kaluar shekuj të tërë... Samirij të rinj lindën... A thua se nuk ka edhe “viç të artë”? Çdo ditë prodhohen edhe më të rrezikshëm. Çdo ditë një Samiri i tërheq njerëzit si tufa pas “viçit të artë” që ka bërë vetë dhe fluturojnë së bashku rreth zjarrit si flutura, ku më në fund digjen... E kam fjalën për “shkencën”. Për “shkencën” që ne e kemi divorcuar para shumë vitesh... Kur shkenca u nda prej dijes, prej së largu po dëgjohen shumë zëra njerëzish që vrapojnë turmat...

Çdo zbulim që bëhet përditë, në vend që të shtohet nga një argument prej shumë provave që tregojnë Krijuesin, nga gjuha e zbuluesit apo të publikuesit të zbulimit, dalin thirrje si ato të Samirit. Çdo zhvillim shkencor kthehet në një “viç të artë”. Aq, sa sot, dyzet ditë janë një kohë shumë e gjatë. Në një ditë të vetme argumentet shkencore i prezantojnë si “pëllitja e viçit të artë”, në mënyrë të atillë, sa i bën njerëzit të lënë besimin. Tashmë, harresa matet me orë në botën shkencore. Shkenca, në vend që të nxisë në interesimin ndaj Allahut, në dashurinë ndaj Tij dhe në zhytjen e pasurive hyjnore e në thellësitë më të mëdha të urtësive, ajo kthehet në një “viç të artë” larg shpirtërores dhe larg qëllimit të njohjes së Allahut.

FEJA QË ADHURON SHKENCËN, SCIENTOLOGY...

Kur po kaloja në rrugë, sytë më mbetën tek një kishë. Kisha Scientology... Në fakt, nuk ka asnjë

lidhje me krishterimin. Megjithatë, në të njëjtën kohë e prezantojnë veten duke thënë se i kanë dyert e hapura për besimtarët e të gjitha feve. Studimet tregojnë se ata kanë “tempuj” në shumë vende të botës dhe po ashtu kanë “besimtarë” që arrijnë në miliona... Mendoni një fe shkence! Ata kanë përkufizuar si moral në “librat” e tyre çdo lloj sjelljeje –që janë provuar shkencërisht që janë të dëmshme- dhe i propagandojnë ato tek njerëzit në Amerikë, Evropë, e madje edhe në Afrikë. Në besimin Scientology, predikohet se askush nuk duhet të dëmtojë as veten dhe as të tjerët.

Sa më shumë zhyteshim në shpjegimet e tyre, aq më shumë habiteshim, sepse çdo njeri që nuk e ka gjetur “thelbin” e fesë (besimin në Allah), do të ishte i pambrojtur ndaj këtyre interpretimeve. Fjalitë që nuk hiqeshin nga gjuhët e atyre që besonin në fenë e shkencës, ishin se “fetë e ithtarëve të librit, janë vetëm dogma”, gjë të cilën Kurani e ka shpallur shekuj më parë. Përveç kësaj, duke filluar prej njerëzve më specialistë në fushën e vet dhe më elitare, ata ftonin me sinqeritet në fenë e tyre, duke pranuar se “një njeri, mund të ndikojë sa njëmijë njerëz”. Mbase zotëronin moralin islam, por, “një fe që nuk e përmend Allahun dhe nuk e pranon si Krijues”, kujt do t'i dorëzohej, kë do të adhuronte? Sigurisht që “veten” e tyre, si një krijesë të përjetshme me vullnet absolut, e jo të pjesshëm...

Domethënë se ne kishim nevojë për stilin e meditimit të shekullit të 21. Domethënë se ne duhet të mësonim se si të interpretohet me kuptimin islam çdo zbulim shkencor që ndodh përditë. Kishim nevojë për një metodë ndryshe prej atyre që, ndërkohë që nga një anë themeloheshin “tempujt e mendjes”, nga ana tjetër ata përpiqeshin të “vërtetonin” ajetet e Kuranit dhe që pas çdo zbulimi thoshin, “shikoni, ajetet janë të vërteta!”. Ne duhej të edukonim ligjërues shkencëtarë që do t'u drejtoheshin, siç shprehet edhe Kurani “zemrave që mendojnë”, pra, jo vetëm mendjes, ose jo vetëm zemrës, por që do t'i bashkonte të dyja në një melodi...

*Shkenca,
në vend që të nxisë
në interesimin ndaj Allahut,
në dashurinë ndaj Tij dhe
në zhytjen e pasurive hyjnore
e në thellësitë më të mëdha të
urtësive, ajo kthehet në një
“viç të artë” larg shpirtërores
dhe larg qëllimit të njohjes
së Allahut.*

Kthimi te Zoti

“Kthehuni tek Zoti juaj.” (Zumer, 54)

Kthimi tek Zoti, që konsiderohet një shkallë më lart se shkalla e pendimit është përkufizuar nga mjeshtrit e gnosës si heqje dorë nga çdo gabim shpirtëror dhe fizik duke u drejtuar dhe orientuar krejtësisht nga Allahu. Ndërsa pendimi shpreh heqjen dorë nga kundërshtimi i urdhëresave hyjnore, duke u kthyer në bindje, kthimi shpreh drejtimin e plotë nga Allahu.

Sipas Ebu Ali Ed Dekkakut, kthimi që bëhet për shkak të frikës së mëkatit është Teube, kthimi për shkak të shpërblimit është Inabe, kurse kthimi për hir të Allahut është Evbe. Ndërsa e para është cilësi e besimtarëve, e dyta është cilësi e evlijave, kurse e treta është cilësi e pejgamberëve. Huxhviri e ka përkufizuar Teuben si kalim nga mëkatet e mëdha në bindje, Inaben si kalim nga mëkatet e vogla në dashuri, kurse evbe kalimin nga vetja tek Allahu. Ibrahim Ed’hemi, i cili e konsideron inaben si nivelin e dytë të pendimit, shprehet se, nëse personi qëndron besnik në pendim, atëherë kalon në nivelin e ina-

bes. Ebu Said el Kurashi Munibin e ka konsideruar si personin që largohet nga çdo gjë që e pengon të shkojë tek Allahu, kurse Suhreverdi e ka përcaktuar si qëndrim i vazhdueshëm në të drejtë dhe mosgjatja vend kthimi tjetër përveç Allahut. Kurse Kashani inaben e ndan në tri pjesë, Kthimi i njerëzve të zakonshëm, kthimi i njerëzve të zgjedhur dhe kthimi i më të zgjedhurve. Kthimi i njerëzve të zakonshëm konsiston në kalimin nga mosbindja në bindje, kthimi i të zgjedhurve konsiston në zhveshjen e plotë të egos duke mos lënë asnjë dëshirë në zemër.

Sipas Hereviut, kthimi është në tri mënyra: kthimi duke përmirësuar veten, rregullimi i qëllimit në ibadete, duke realizuar premtimin që i është dhënë Allahut. Premtimi i dhënë është besa për të mos u rikthyer në mëkatin prej të cilit je penduar. Realizimi i premtimit duhet shprehur në të gjitha sjelljet e njeriut.

Kthimi tek Allahu duke përmirësuar veten arrihet duke plotësuar këto tre kushte:

a. Çlirimi nga çdo detyrim dhe përgjegjësi, pra



kryerja e të gjitha detyrimeve ndaj Allahut dhe ndjesa e falja ndaj të gjithë atyre që u ke bërë padrejtësi.

b. Shqetësimi dhe brenga për mëkatet e veta dhe të vëllezërve besimtarë. Udhëtari në këtë rrugë duhet të ndjejë keqardhje për mëkatet e bëra, kjo jo vetëm për vete por edhe për të tjerët. Në vend që t'i qortojë për mëkatet e bëra, duhet t'i shikojë më syrin e mëshirës dhe keqardhjes.

c. Kompensimi i ibadeteve të pakryera, si namazi, agjërimi, haxhi, zekati etj.

Plotësimi i premtimit dhënë Allahut realizohet në tri mënyra:

a. Shpëtimi nga kënaqësia e mëkatit. Udhëtari duhet të ndjejë pikëllim të thellë për mëkatet e bëra dhe për të mos e përjetuar edhe një herë këtë gjendje, qëndron larg mëkateve.

b. Mosnënvlerësimi i njerëzve indiferentë, përderisa personi nuk e pret shpresën nga mëshira e Allahut, nuk ka të drejtë askush që ta akuzojë atë

për dënim në Xhehenem, prandaj udhëtari duhet të shikojë nga vetja, jo të fokusohet në mëkatet e të tjerëve.

c. Evidentimi i mangësive dhe dobësive si dhe përmirësimi i tyre.

Gjendja e tij në kthim

bëhet e qëndrueshme përmes tri gjërave:

a. Mospritshmëria nga veprat e tua, sepse shkak kryesor i veprave të mira është Allahu, prandaj udhëtari nuk e konsideron veten si faktor në vepër, por thjesht si mirësi të Allahut.

b. Është i vetëdijshëm që për çdo gjë ka nevojë për Allahun. Në momentin që personi nuk i atribuon vetes asnjë vepër, ai atëherë mbështetet plotësisht tek ndihma e Allahut.

c. Në momentin që udhëtari nuk ia atribuon vetes veprat e mira dhe bëhet i vetëdijshëm për nevojën që ka për Allahun tek ai fillon të shfaqet drita e njohjes dhe urtësisë.



MUHAMMED IKBAL

JETA, PERSONALITETI DHE VEPRAT

Ikbali u lind më 9 Nëntor 1877 në Sialkot, një qytet i vjetër i provincës së Punxhabit, në Pakistanin e sotëm. Rreth katër shekuj e gjysmë para lindjes së tij, paraardhësit e tij brahminë nga Kashmiri (India veriore) kishin pranuar Islamin. Aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, kur sundimi afgan në Kashmir po i linte vendin sundimit sikh, stërgjyshi i Ikbalit, ose bijtë e tij, u shpërngulën nga Kashmiri në Sialkot. Babai i Ikbalit, Nur Muhammedi, me profesion rrobaqepës, ishte individ i devotshëm me prirje mistike. Ndonëse i mungonte arsimi formal, ai lexonte libra në urdisht e persisht dhe rrinte me dijetarë e mistikë, disa prej të cilëve e quanin dashamirësisht ‘filozof i pamësuar’. Në një rreth studimi, që mbahej rregullisht në shtëpinë e tij, lexoheshin klasikë të mirënjohur të sufizmit, çka duhet të ketë shërbyer si hyrje e parë në misticizmin islam për Ikbalin. Me dëshirën për t’i ofruar arsimim fetar të birit, Nur Muhammedi e dërgoi Ikbalin katërvjeçar në një xhami, ku ai mësoi të lexonte Kuranin. Ikbali rrëfen me krenari mjaft anekdota, për të treguar mënyrën e hollë por vendimtare, në të cilën u ndikuan pikëpamjet e tij nga karakteri i thjeshtë por thellësisht fetar i të atit.

Ndonëse analfabete, e ëma e Ikbalit respektohej në familje si grua e urtë dhe bujare, që u jepte ndihmë financiare në heshtje grave të varfra dhe arbitronte në mosmarrëveshjet e fqinjve.

Vetëm një vit pasi u fut në mejteq, Ikbali pesëvjeçar u bë nxënës i Sejjid Mir Hasanit (1844-1929), një dijetar i shquar i fesë dhe letërsisë, i cili drejtonte një medrese në qytet. Në shoqërimin e tyre të gjatë, Mir Hasani jo vetëm e udhëzoi Ikbalin në trashëgiminë fetare islame, por e ndihmoi gjithashtu të kultivonte shije mjaft të rafinuar letrare. Ndryshe nga shumë dijetarë myslimanë në Indi, Mir Hasani ndjente nevojë urgjente që muslimanët të merrnin arsim evropian – që praktikisht do të thotë sekular – krahas fetarit. Marrja e Delhit më 1857, i bëri britanikët sundues *de jure* të Indisë, ndërkohë që pjesë të mëdha të saj ishin *de facto* nën kontrollin e tyre. Zemërimi dhe frustrimi i çoi shumë myslimanë të flaknin gjithçka që shoqërohej me sundimtarët britanikë, të cilët i kishin fajësuar myslimanët për kryengritjen e 1857-ës. Ata i akuzuan britanikët për institimin e politikave paragjyquese ndaj pozitës së tyre sunduese politike dhe shoqërore të mëpar-

shme. Në fushën e arsimit, disiplinat tradicionale islame të dijes, bashkë me gjuhën arabe dhe perse, e humbën përparësinë në shoqëri; përkundrazi, anglishtja dhe artet e shkencat moderne fituan më tepër rëndësi. Për rrjedhojë, kërkesa për dijetarë të arabishtes dhe persishtes ra, ndërsa kërkesa për dijetarë të anglishtes dhe të disiplinave moderne të dijes u rrit. Shumë prijës fetarë myslimanë i shkurajuan ndjekësit e tyre nga studimi i anglishtes – të cilën e quajtën gjuhë të uzurpuesve të pafe të Indisë – si dhe nga marrja e arsimit modern. Sër Sejjid Ahmed Khan (1817-98), arsimues dhe reformist, nuk pajtohej me këtë qëndrim. Ai kishte bindjen se shpëtimi i myslimanëve indianë qëndronte te pranimi i ndryshimit rrënjësor që kishte ndodhur në botën reale. Si kritikues i sistemit tradicional islam të arsimit, të cilin e damkosi si vendnumërues e jo-prodhimtar, ai theksoi nevojën e myslimanëve për të studiuar anglishten si dhe artet e shkencat evropiane. Mir Hasani pajtohej me Sër Sejjidin dhe e mbështeste kauzën e tij. Ai e bindi babain e Ikbalit që ta regjistronte të birin në Scotch Mission College të Sialkotit, ku Mir Hasani jepte arabisht. Në këtë kolegji, Ikbali mori diplomën e Fakultetit të Arteve (1895) – më të lartën që ofrohej asokohe nga kolegji – e cila përfaqësonte dy vjet arsimi pas shkollës së mesme. (Kolegji Scotch Mission u emërua më pas Murray College dhe vazhdon të mbajë këtë emër).

Në Kolegjin Scotch Mission, kur ishte 15 ose 16 vjeç, Ikbali filloi të thurte poezi, disa prej të cilave u botuan.

Kur mbushi tetëmbëdhjetë vjeç, Ikbali kishte arritur gjithçka që Sialkoti mund t'i ofronte. Këto vite të hershme nxorën në pah disa prej qëndrimeve, simpatie dhe interesimeve themelore e karakteristike të Ikbalit. Prindërit e tij i kishin dhënë orientim të thellë fetar e mistik, të cilin do ta ruante tërë jetën. Dashuria e Ikbalit për shpalljen islame, Kuranin, është e mirënjohur. Kurani, të cilin ai e recitonte rregullisht, ishte burim i vazhdueshëm frymëzimi për të; ç'është e vërteta, Ikbali pohon se poezia e tij është veçse kthjelltësim i mesazhit kuranor. Babai i Ikbalit e këshilloi një herë që ta lexonte Kuranin sikur po i shpallej direkt nga Zoti, sepse vetëm atëherë do ta kuptonte vërtetësisht. Kjo fjalë i la përshtypje të pashlyeshme Ikbalit, duke përcaktuar qëndrimin e tij intelektual dhe emocional ndaj Kuranit. Ajo gjeti shprehje më vonë në një dyvargësh të paharrueshëm:

Pa t'u shpallur Kurani në zemër vetë ty,

As Raziu as autori i Keshshafit s'ia zgjidhin nyjat për ty.

Ndikimi i Mir Hasanit të Ikbali ishte gjithashtu formësues. Mir Hasani ishte dijetar i përkushtuar dhe mendjendritur, i cili jo vetëm që nguliti tek Ikbali një dashuri të thellë për trashëgiminë intelektuale dhe letrare të Islamit, por e prezantoi edhe me dijetarët modernë. Pikërisht nëpërmjet Mir Hasanit u njoh Ikbali me Sër Sejjidin. Simpatia e Ikbalit për lëvizjen arsimuese të Sër Sejjidit – megjithëse Ikbali kishte rezerva serioze për vlerën e sistemit arsimues evropian që ajo promovonte – është e mirënjohur. Veç kësaj, nëse mendimi i Ikbalit përfaqëson një sintezë unike të traditave diturore të Lindjes e Perëndimit dhe nëse kjo sintezë u shpreh kryesisht përmes mediumit të poezisë serioze dhe elokuyente, atëherë pikërisht në Sialkot dhe nën drejtimin e Mir Hasanit u hodhën themelet e para të asaj sinteze e u zgjodh si medium i përcjelljes së saj poezia. Në një poemë të shkruar në lavdërim të njërit prej eulijave të Indisë, Ikbali flet me nderim për borxhin intelektual dhe letrar ndaj mësuesit të tij të dashur.

Më 1922, kur qeveria britanike vendosi t'i jepte titullin e kalorësit, Ikbali e kushtëzoi pranimin e nderimit me njohjen e dijetarisë së Mir Hasanit. I pyetur se çfarë librash kishte shkruar Mir Hasani, Ikbali u përgjigj se ai vetë ishte libri që Mir Hasani kishte prodhuar. Kur Ikbali u bë Kalorës më 1 Janar 1923, Mir Hasani mori titullin *Shemsu'l-'Ulema* ('Dielli i Dijetarëve').

Më 1893, kur ishte 16 vjeç, Ikbali u martua me Kerime Bibi, që ishte tre vjet më e madhe. Ky ishte një kombinim i nxituar dhe ka tregues që Ikbali ishte kundër, ndonëse vendimin mbi këtë çështje ua la në dorë prindërve. Kerime Bibi i lindi një djalë e një vajzë. Tensioni në marrëdhëniet e çiftit çoi në ndarjen e tyre, por Ikbali mbeti përgjegjës për mbajtjen e Kerime Bibit, e cila jetoi edhe për tetë vjet pas tij.

LAHORE (1895-1905)

Më 1895, Ikbali u zhvendos në Lahore, një qytet madhor i Punxhabit, që njihej për institucionet arsimore dhe veprimtaritë kulturore të tij. Ikbali siguroi pranimin në të famshmin Kolegj Qeveritar, ku kaloi katër vjet, duke marrë një BA më 1897 – pas studimit të anglishtes, filozofisë dhe arabishtes – dhe një MA në filozofi, më 1899. Pas pak kohe, Ikbali u caktua Ligjërues MacLeod i Arabishtes në Kolegjin Oriental të Lahores, ku dha histori, filozofi dhe ekonomi, duke punuar gjithashtu në projekte kërkimore e përkthyes. Ai e mbajti këtë post me ndërprerje deri më 1904. Për një periudhë të shkurtër

tër, Ikbali shërbeu edhe si Profesor Asistent i Anglishtes në Kolegjin Qeveritar dhe në një kolegji tjetër të qytetit.

Në Lahore, talentet intelektuale dhe letrare të Ikbalit lulëzuan. Në Kolegjin Qeveritar, ai u ndesh me traditën e gjerë dhe energjike të dijes evropiane. Ndikimi më i rëndësishëm mbi të ishte Sir Thomas Arnold (1864-1930), i cili kishte ligjëruar në Kolegjin e Aligarhut përpara se t'i bashkohej Kolegjit Qeveritar më 1898. I shpejtë në pikasjen e aftësive të Ikbalit, Arnoldi e përgatiti atë në shumë drejtime. Përveç mësimdhënies formale, ai e motivoi Ikbalin të ndërmernte mjaft projekte kërkimore.

Ikbali arriti të njihej shpejt si poet i hollë. Në fillim, ai trajtoi temat e zakonshme të poezisë në urdisht - dashurinë, vuajtjen e ndarjes nga i dashuri, dëshirën për njësim me të dashurin.

Arnoldi dhe Ikbali e çmonin shumë njeri tjetrin. Kur Arnoldi u nis për Angli më 1904, Ikbali shkroi një poemë prekëse që i thurte nderime Arnoldit dhe shprehte vendosmërinë e tij për ta ndjekur nga pas në Angli. Me ndihmën financiare të vëllait të madh, Ikbali arriti ta realizonte dëshirën e tij. Më 1905, ai mbërriti në Kembrixh, ku hyri në Kolegjin e Trinitetit si student kërkimor. Në fillimin e shekullit XX, Kembrixhi ishte qendër e shquar e studimeve arabe dhe perse. Luminarët e tij përfshinin Reynold M. Nicholson, i cili më vonë përktheu në anglisht veprën poetike të Ikbalit, *Asrar-i Khudi* (1920). Në Kembrixh, Ikbali takoi edhe filozofin John McTaggart dhe ndoqi leksionet e tij mbi mendimin perëndimor. Ndërkaq, Ikbali u regjistrua edhe si student i juridikut në Lincoln's Inn të Londrës. Me sugjerimin e Arnoldit, ai u regjistrua për doktoratë edhe në Universitetin e Mynihut. Në qershor 1907, Ikbali mori titullin BA nga Kembrixhi. Në Nëntor 1907, Universiteti i Mynihut i dha doktoratën për tezën e tij mbi zhvillimin e metafizikës në Persi. Në Korrik 1908, Ikbali u pranua në gjykatën e Londrës. Po në këtë vit, teza e tij e doktoratës u botua në Londër.

Faza evropiane e jetës së Ikbalit shquhet për disa arsye. Gjatë kësaj periudhe, Ikbali u kushtoi vëmendje thujtë plotë studimeve të tij; ai nuk kishte pasur e as nuk do të kishte më kurrë një jetë kaq intensive akademike. Përkushtimi i tij dha fryte – tri grada nga tri shkolla prestigjioze në tre vjet ishte arritje e pazakontë për çdo standard. Gjatë qëndrimit të tij në Evropë, Ikbali fitoi njohuri të mira të gjermanishtes. Ai njihej

që më parë me një larmi veprash në gjermanisht, nëpërmjet përkthimeve, por tani mund të kryente studime të thella të dorës së parë nga tradita filozofike e letrare gjermane. Që nga kjo periudhë, referimet ndaj autorëve gjermanë dhe mendimeve të tyre u bënë më të shpeshta në veprat e tij dhe ai filloi ta shihte rolin e vet në Indi si të ngjashëm me rolin e luajtur në Gjermani nga Gëte, të cilin e admironte së tepërmi. Kështu, ndikimi i mendimit dhe letërsisë gjermane duket se shërbeu si kundërpeshë e ndikimit anglez. Interesimi i Ikbalit për letërsinë gjermane ishte kryesisht për shkak të dukurisë së Lëvizjes Orientale, e cila përfaqësonte ndikimin e Hafizit, Sa'diut, Rumiut dhe poetëve të tjerë persë mbi shkrimtarë si Herder, Rykert, Gëte, Shiler dhe Hajne.

Në Evropë, ashtu sikurse në Lahore, Arnoldi luajti rol të rëndësishëm në arsimimin dhe rritjen intelektuale të Ikbalit; qëndrimi i Ikbalit në Evropë e forcoi lidhjen mes tyre. Pikërisht Arnoldi ia rregulloi regjistrimin në Kolegjin e Trinitetit të Kembrixhit, madje përpara se Ikbali të mbërrinte në Angli. Gjatë vizitave të tij në Londër, Ikbali qëndronte shpesh me Arnoldin dhe, kur ai mori leje gjashtëmujore nga Universiteti i Londrës, Ikbali e zëvendësoi si profesor i arabishtes. Pikërisht me rekomandim nga Arnoldi dhe të tjerë, Ikbali u lirua nga detyrimi për të përmbushur kërkesat rezidenciale të Universitetit të Mynihut, gjatë studimeve të doktoratës. Kur u botua, teza e Ikbalit iu dedikua Arnoldit.

Në Evropë, Ikbali pati mundësinë t'i bënte një studim kritik nga afër qytetërimin perëndimor, për të cilin do të komentonte në shumë prej punimeve të mëvonshme. Ndërkohë që i admironte aspekte të caktuara të atij qytetërimi, ai qortonte karakterin e tij sekular dhe i paralajmëronte myslimanët për rreziqet e imitimit të verbër të Perëndimit. Në një prej vargjeve të tij, Ikbali thotë: *Stuhia nga Perëndimi i ka bërë myslimanët besimtarë të vërtetë* (BD, 267). Mesa duket, ky vëzhgim vlen pikësepari e mbi të gjithë për vetë Ikbalin. Gjatë qëndrimit në Evropë, Ikbali pësoi një ndryshim madhor në vlerësimin dhe qëndrimin e tij ndaj nacionalizmit. Përpara se të nisej për Evropë, ai kishte përkrahur fuqimisht kauzën e nacionalizmit indian duke punuar për unitetin hindu-mysliman. Për të, besnikëria ndaj vendit mund të bashkekzistonte me çfarëdolloj tensioni serioz kundrejt përkushtimit të dikujt ndaj fesë së vet. Rrjedhimisht, ai shkroi poema, në të cilat lavdëronte nacionalizmin indian. Në Evropë, Ikbali dëshmoi nga dora e parë përçarjen e thellë që nacionalizmi xhingoist kishte

shkaktuar mes fuqive madhore evropiane, e cila do të kulmonte pak vite më pas në Luftën e Parë Botërore. Thellimi mbi gjendjen politike të Evropës e çoi Ikbalin të bënte një dallim ndërmjet nacionalizmit territorial dhe etnik të Evropës dhe universalizmit ideor të Islamit; në fund, ai e flaku të parin në dobi të të dytit. Ky shndërrim në mendimin e Ikbalit do të kishte rrjedhime të gjerësishme për poezinë dhe mendimin e tij.

NJË NDJESI MISIONI (1908-38)

Me t'u kthyer në Indi në Korrik, Ikbali nisi të ushtronte profesionin e juristit në Lahore, ku, për njëfarë kohe, dha edhe filozofi në *alma mater* e tij, Kolegjin Qeveritar. Përpyekja për t'u mëkëmbur financiarisht ushtronte trysni të mundimshme mbi kohën e tij. Edhe jeta e tij martesore ishte larg nga të qenit e lumtur. Martesa e tij e parë kishte qenë e pasuksesshme. Më 1910, ai u martua me Sardar Begum, ndërsa më 1913, me Mukhtar Begum. Telashtet në jetën personale nuk i linin kohë që të merrej me letërsinë dhe për pasojë ai shkroi fare pak poezi në dy-tre vitet e para pas kthimit nga Evropa. Megjithatë, ai mori pjesë gjithnjë e më shumë në veprimtaritë e organizatave të mirëqenies shoqërore dhe u aktivizua në shumë role me një sërë institucioneesh arsimuese, përfshirë Universitetin e Punxhabit dhe Kolegjin Muhammedan Anglo-Oriental.

Më 1911, në përgjigje të kërkesave politike të hinduve dhe për zhgënjimin e rëndë të muslimanëve, qeveria britanike shfuqizoi ndarjen e vitit 1905 të provincës së Bengalit. Edhe skena ndërkombëtare ishte e hidhur për muslimanët. Më 1911-12, Italia pushtoi Libinë, Franca aneksoi Marokun dhe disa shtete ballkanike sulmuan Turqinë, duke e zhveshur nga zotërimet e saj në Evropë. Ngjarjet në vend dhe jashtë tij krijuan një ndjesi dëshpërimi e pafuqie tek shumë muslimanë të ndjeshëm, përfshirë Ikbalin, jeta e të cilit që prej këtij çasti e tutje shenjohej nga një seriozitet qëllimi. Si në prozë, ashtu edhe në poezi, Ikbali fillon të cekë gjëmën e muslimanëve – jo vetëm në Indi, por edhe mbarë botën islame – dhe sakaq, idetë e tij filozofike dhe politike fillojnë të marrin trajtë përfundimtare.

Poezitë në urdisht të Ikbalit ishin shfaqur në perioidikë të asaj gjuhe, por libri i tij i parë me poezi që u botua ishte *Asrar-i Khudi* (1915) në persisht, i cili synonte të jepte një trajtim sistematik të koncepteve rrënjësore të mendimit të Ikbalit. Përkthimi i kësaj vepre në anglisht nga Nicholson (1920) e prezantoi Ikbalin në Perëndim si autor madhor letrar e filozofik. Në recensionin e botimit anglisht,

Herbert Read e krahason Ikbalin me poetin e famshëm amerikan Walt Whitman (1819-92). Në shtrirjen dhe thirrjen e tij, *Asrar-i Khudi* i drejtohet mbarë bashkësisë myslimane. Përmbledhje të tjera poetike në persisht e urdisht vijuan shpejt. I përfshirë rëndazi në frontet intelektuale, arsimore dhe shoqërore, Ikbali mbajti fjalime publike dhe ligjërata akademike, shkroi artikuj për revista e gazeta, ndihmoi në prodhimin e teksteve mësimore për nxënësit e shkollave dhe studentët e kolegjeve. Ai gjithashtu pati letërkëmbime me njerëz të shumtë, duke i shprehur rëndom pikëpamjet e tij mbi çështje të rëndësishë kombëtare e ndërkombëtare. Vepra e tij madhore filozofike, *Rindërtimi i Mendimit Fetar në Islam*, u botua më 1934. Ai u ftua të jepte leksionet Rhodes më 1934, por problemet shëndetësore e penguan nga udhëtimi në Angli.

Në Shtator 1929, Ikbali drejtoi një tubim të madh publik në shenjë proteste ndaj ndikimit zionist që po rritej në Palestinë, nën patronazhin britanik. Në fjalimin e tij, ai deklaroi se myslimanët nuk kishin fare besim te komisioni hetues që Britania synonte të dërgonte në Palestinë. Më 1931, ai përfaqësoi myslimanët e Indisë në një takim të Kongresit Islamik Botëror, të mbajtur në Palestinë. Më 1931 e 1932, sërish si përfaqësues i myslimanëve të Indisë, Ikbali mori pjesë në Konferencat e Tryezës së Rrumbullakët për të vendosur të ardhmen e Indisë. Më 1933, Ikbali dhe dy miq të tij udhëtuan drejt Afganistanit, me ftesën e Nadir Shahut, i cili dëshironte të këshillohej me ta rreth sistemit arsimor të Afganistanit.

Në praktikë, sigurisht, shumica e veprimtarive politike të Ikbalit kufizoheshin brenda Indisë. Më 1926, ai u zgjodh anëtar i Këshillit Kushtetues të Punxhabit, një pozitë të cilën e mbajti deri më 1930. Ai luajti një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kursit të Ligës Myslimane, e cila do të bëhej partia më e madhe myslimane e Indisë.

Ai foli gjithashtu për nevojën e ndarjes së sistemit zgjedhor për hindutë dhe myslimanët në Indi. Gjatë takimit vjetor të Ligës Myslimane Mbarë-Indiane, të zhvilluar në Allahabad në Dhjetor 1930, ai mbajti fjalimin e tij të famshëm presidencial, në të cilin propozoi krijimin e një atdheu më vete, të paktën për myslimanët e Indisë veriperëndimore. Ndonëse nuk arriti ta shihte krijimin e Pakistanit më 1947, Ikbali nderohet si themeluesi i tij shpirtëror dhe poeti i tij kombëtar.



Nuthe të zgjedhura

Naim Drijaj

Viti i ri

Viti i Ri e ka prejardhjen në Mesopotami-Babiloni. Babilonasit paganë e festonin ndërrimin e viteve në ditën e Pranverës, kur hëna është e plotë, nata dhe dita janë të barabarta, kur natyra rilind mbas dimrit të gjatë...

Përse paganët e festonin këtë festë?

Popujt paganë në Evropë besonin se kur ditët shkurttoheshin dhe dita më e shkurtër binte me 21 ose me 22 dhjetor, kjo do të thoshte se Dielli-Zot është sëmurë. Ndërsa kur dita fillon të zgjatet ata gëzohehin dhe festonin, duke besuar se Dielli-Zot i tyre po shërohet, po forcohet dhe vera po afrohet! Ky besim i verbër pagan i përhapur ndër popujt evropianë, prejardhjen e ka nga egjiptianët e lashtë paganë, të cilët e adhuronin hyun pagan Ra, Perëndia e agrikulturës (bujqësisë), që në fakt vinte nga besimi pagan iranian i Mithra, hyu pagan kushtuar Diellit të pamposhtur...!

Viti i Ri në Evropë, e ka prejardhjen nga Roma e lashtë pagane. Në vitin 274, perandori romak pagan, Aureli, e shpalli ditën e 25 dhjetorit: Natalis Solis Invikti (Festa e Diellit të Pamposhtur). Kjo festë kremtohej në gjithë Perandorinë Romake. Edhe kjo festë tek romakët prejardhjen e ka nga hyu pagan i iranianëve të lashtë, i cili quhej Mithra (Zoti i dritës).¹

Ditëlindja e Isait për herë të parë është festuar më 6 janar të vitit 336 (pas lindjes së Isait) në Romë. Më pas kisha perëndimore-katolike në fund të shekullit të katërt feston ditëlindjen e Jezusit me 25 dhjetor, me urdhër të papa Gregorit, ndërsa kisha ortodokse më 6 janar. Kisha ortodokse bazohet ende në kalendarin julian që lëviz 13 ditë prapa kalendarit gregorian, prandaj edhe krishtlindjet i feston më 6 janar.² Kalendarit gregorian është një modifikim i kalendarit julian dhe e merr emrin nga papa Gregori

XIII, i cili e miratoi atë në vitin 1582.

Natën që lindi Jezusi barinjtë kullotnin bagëtitë e tyre në fushat afër Betlehemit.³

Allahu (xh.sh.), thotë: ***“Shkunde trungun e palmës, që të bien për ty hurma të freskëta!”***⁴

BREDHI

Bredhi është simboli i kësaj feste. Ai është me prejardhje pagane, sepse paganët besonin se në shtëpinë që ka bredh, do të ketë bereqet tërë vitin.

Përse zbukurohen dhe dekorohen me bredha e pisha, shtëpitë, fshatrat dhe qytetet?

Sepse popujt paganë të Evropës, para krishterimit, besonin se pemët e gjelbra, siç janë bredhi, pisha, të cilat e ruajnë tërë vitin gjelbërimin e tyre, madje edhe në dimër, kanë diçka hyjnore.

BABADIMRI

Gjithashtu simbol i kësaj feste është Baba Dimri, i cili quhej Nikolas. Ai në fillim ka qenë pagan, por më pas u konvertua në të krishterë, madje më vonë u bë edhe murg dhe i vunë titullin Shën Nikolasi. Ai ka jetuar në Antalja të Turqisë dhe dilte nëpër rrugë dhe shpërndante dhurata.⁵

Çfarë duhet të bëjmë ne besimtarët në këto ditë, ku shumë njerëz vrasin mendjen se ku dhe si do ta festojnë vitin e ri, duke harruar një gjë të rëndësishme, se pas 365 ditëve prapë ky vit i ri do të bëhet i vjetër.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: ***“Kush i përngjan një populli, ai është prej tyre”***.⁶

Festat në Islam janë të caktuara. Ne si myslimanë kemi dy festa vjetore dhe një festë javore. Festat

1. Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (İsa, maddesi)

2. Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (Noel, maddesi)

3. Ungjilli sipas Llukës dhe Mateut

4. Merjem, 25

5. Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi.

6. Ebu Davudi.

vjetore janë Fitër dhe Kurban Bajrami, kurse javore, festa e ditës së Xhuma.

Duhet t'i vendosim një qëllim vetes se çfarë do të bëjmë në këtë vit dhe të kërkojmë llogari nga vetja jonë se çfarë kemi bërë vitin që lamë pas.

Kërkesa e llogarisë nga vetvetja na shtyn të rishikojmë veprimet dhe punët që kemi kryer, duke na mundësuar të bëjmë vepra të mira dhe duke na ndihmuar që të shmangim veprat dhe punët e këqija.

Kërkesa e llogarisë nga vetvetja është shumë e rëndësishme për mbajtjen gjallë të ndjenjës së imanit dhe përtëritjen e tij. Allahu (xh.sh.):

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”⁷

Me të vërtetë, mungesa e kërkesës së llogarisë nga vetvetja është shkaku i zhytjes së njeriut edhe më shumë në gjynahe. Jobsimtarët kënaqen me jetën e kësaj bote, duke mos e llogaritur faktin se një ditë do të dalin para Zotit (xh.sh.). Allahu i madhëruar urdhëron e thotë: **“Në të vërtetë, atyre as që ua merrte mendja se do të japin llogari.”**⁸

Ibn Kajimi thotë: “Shkatërrimi i shpirtit vjen si pasojë e braktisjes së kërkesës së llogarisë nga vetvetja, e pajtimit me dëshirat e epshit dhe zbatimit të tyre”. Prandaj myslimani patjetër duhet të gjejë kohë për t’u vetmuar dhe të mendojë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen (Ditën e Gjykimit).

Vërtet, ai që i kërkon llogari vetvetes e zbulon gabimin, ndërsa kush zbulon gabimin e tij, ai pendohet dhe i kërkon falje Allahu (xh.sh.). Kush pendohet dhe kërkon falje prej Tij, ka pasur fatin të përjetojë mirësinë më të madhe në këtë jetë.

Umer ibn Hatabi (r.a.), i ka shkruar njërit prej nëpunësve të tij: “Bëja llogaritë vetes kur je në siguri, përpara se të japësh llogari në kohë të vështirë, sepse atë që bën llogarinë e vetes kur është në siguri para se të jetë në vështirësi, do ta kenë zili të gjithë.”

Besimtari është edukatori i vetes së tij. Ai kërkon llogari nga vetvetja për hir të Allahut. Me të vërtetë, dënimi në Ditën e Gjykimit do të jetë më i lehtë për ata që kanë kërkuar llogarit nga vetvetja në dynja, dhe do të jetë i vështirë për njeriun që e ka nënvlefësuar këtë mundësi.

Njëra nga gjërat më të rëndësishme është kërkesa e llogarisë nga vetvetja në mënyrë të vazhdueshme, sepse “person i suksesshëm është ai që ia bën llogarinë vetes dhe punon për botën tjetër, kurse i pasuksesshëm do të jetë ai që ndjek epshin e tij”.

Njeriu do të vazhdojë në mirësi për sa kohë që

preokupimi i tij do të jetë kërkesa e llogarisë nga vetvetja.

1. Kërkojini llogari vetes për fjalët që thoni. Allahu (xh.sh.), urdhëron e thotë:

“Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbi-këqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”⁹

Gjithashtu Allahu i madhëruar në Kuran na informon:

“Mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), regjistrues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.”¹⁰

2. Kërkojini llogari vetes tuaj për punët që bëni. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Kush punon ndonjë të mirë, qoftë edhe sa grimca, atë do ta gjejë, dhe kush punon ndonjë të keqe, qoftë edhe sa grimca, atë do ta gjejë.”¹¹

Vetëllogaria të shtyn të përpiqesh për përmirësimin e gabimit, plotësimin e mangësive dhe angazhimin në përkryerje. Ajo e largon njeriun nga vetëpëlqimi, mburrja me punën e tij dhe përbuzja e të tjerëve.

Mënyrat e kërkesës së llogarisë nga vetvetja

Ibn Kajimi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), sugjeron:

1. Fillo nga obligimet dhe, nëse shikon diçka mangut, shpejto ta plotësosh.

2. Pastaj shih ndalesat dhe, nëse kupton se ke shkelur ndonjë ndalesë, shpejto të pendohesh dhe kërko falje.

3. Kërkoji llogari vetes për përmendjen e Allahut sa më shumë.

4. Kërkoji llogari vetes për lëvizjet e gjymtyrëve, fjalët, ecjen e këmbëve, shikimin e syve, dëgjimin e veshëve etj.

Disa nga dobitë e vetëllogarisë

1. Vërejtja e mangësive. Ai i cili nuk i shikon mangësitë e veta, nuk mundet t’i ndreqë ato.

2. Pendimi, keqardhja dhe angazhimi me atë që ka ikur në kohën e duhur.

3. Përrulja e robit dhe nënshtrimi i tij para Zotit (xh.sh.).

4. Kthimi i të drejtave tek njerëzit, sepse kur kërkon llogari nga vetja, vetëkupton se kur ju ke bërë padrejtësi të tjerëve, pendohesh dhe u kërkon hallall atyre.

Në gëzohemi me ditët që kalojnë,
por çdo ditë drejt vdekjes na afron
Puno për veten tënde para se të vdesësh,
Fitimi dhe humbja varen nga ç’vepron.

Omer ibn Hatabi (r.a.), ka thënë: “Bëjani llogaritë vetes suaj para se t’jua bëjnë të tjerët.”

7. El-Hashr, 18.

8. En-Nebe, 27.

9. Kaf, 18.

10. El-Infitar, 10-12.

11. Ez-Zelzele, 7- 8.



VLERAT E BUKËS SË MISRIT

Buka e misrit përmban të dhjetë amino acidet e nevojshme që rregullojnë funksionet e organeve. Buka e misrit është një nga gatimet më të hershme në traditën shqiptare, sa që shpesh konsiderohet si buka e të parëve. Prindërit tanë akoma lënë kokën pas bukës së misrit, një ushqim tejet i shëndetshëm, pa shumë andralla dhe i shijshëm që padyshim u sjell ndërmend kohë të vështira, por edhe të lumtura, aty mbledhur në familjet e mëdha. Përmbajtja kryesore e kësaj buke është padyshim mielli i misrit. Ky drith si shumë të tjerë është i pasur me përbërës të dobishëm për organizmin e njeriut. Mielli i misrit është një burim fibrash që jo vetëm rregullon lëvizjet e zorrëve por edhe përthith kolesterolin dhe ul nivelin e sheqerit në gjak. Sipas të dhënave, 28 gramë bukë misri përmban 1.8 gramë fibër. Duke qenë se fibra nuk tretet, por thjesht kalon përtej sistemit tretës është praktikisht pa kalori. Buka e misrit është një thesar sa i përket vlerave të çmuara. Ajo përmban kalcium, hekur, magnez, fosfor, potas, acid folik, vitamina, A, B-6 dhe B12. Disa bukë që shiten në markete për fat të keq përmbajnë sodë, sheqer dhe yndyrna, por varianti i bukës që bëhet në shtëpi është më i mirë padyshim. E në fakt mënyra më e mirë për të mbajtur nën kontroll përbërësit e bukës së misrit, është ta bësh bukën vetë ose të kesh kujdes listën e përbërësve në bukën që shitet në dyqan. Gjithsesi buka e misrit ka një shije aq të mirë sa edhe fëmijët më nazelinj e duan shumë. Studimet shkencore Përtej vlerave të bukës së misrit, studime të fundit tregojnë që buka e misrit përmban të dhjetë amino acidet e nevojshme që kur futen në organizëm rregullojnë funksionet e organeve, proceset e qelizave dhe rritjen e qelizave të trupit. Ekspertët tregojnë që antioksidantët në bukën e misrit mbrojnë qelizat nga dëmet e shkaktuara nga oksidimi. Në përgjithësi, ushqimet e verdha dhe ngjyrë portokalli janë të pasur me beta karoten, një substancë e nevojshme që kthehet në vitaminë A dhe redukton rrezikun e kancerit, sëmundjeve të zemrës dhe plakjen. Niveli i karotenit natyral në miellin e bluar të misrit është jashtëzakonisht i lartë madje ia kalon edhe perimeve kampion si spinaqi apo karrotat. Misri është drithë apo perime? Drith është ai produkt që mbillet në tokë

nëpërmjet farave të thata. Misri i fushave që mbillet me fara të thata konsiderohet drithë. Misri i ëmbël që vilet përpara se të piqet njihet si perime. Misri i ëmbël është më i ëmbël se të tjerët dhe zakonisht konsumohet nga njerëzit dhe përdoret në gatime. Misri për silazh përdoret për të ushqyer kafshët dhe prodhuar produkte industriale. Misri dekorativ është lloji i tretë për nga përdorimi masiv. Ky misër vjen në disa ngjyra dhe zakonisht përdoret për të prodhuar kokoshka. Drithi i misrit është konsumuar që 8000 vjet më parë, si fillim në Amerikën e Veriut, të Jugut dhe atë Qendrore dhe më pas në të gjithë botën. Që prej asaj kohe misri ka ndihmuar popullësinë e vendeve të botës, në zhvillim ose të varfra për tu ushqyer për vite me radhë. Sot 21% e popullësisë globale ushqehet me misër. Misri rritet gjatë ditëve të ngrohta të verës i mbrojtur nga kallinjët. Në kohët moderne, misri organik gjendet në ngjyra të shumta si i kuq, rozë, i zi, vjollcë dhe blu. Misri ka 10 herë më shumë vitamin A se çdo drithë tjetër. Ai është gjithashtu i pasur me vitaminë C, magnesium, vitamin B dhe potassium. Në përbërjen e tij gjenden dy antioksidantë të vlefshëm për shëndetin e syrit dhe të lëkurës. Misri i plotë konsiderohet si një dozë e mirë energjie për shkak të fibrave dhe karbohidrateve komplekse. Kohët e fundit misri po përdoret në procese aspak të natyrshme për të bërë për shembull, ushqime të përpunuara ose shurup me sasi të madhe fruktoze gjë që është aspak e shëndetshme pavarësisht ç'thonë prodhuesit. Misri është pa gluten, dhe mund të përdoret shumë mire nga njerëzit që duan një dietë pa gluten Origjina e misrit Origjina e misrit ka qenë mister për shumë vite me rrallë sepse variantet e egra të tij nuk janë gjendur askund në planet. Vetëm pak kohë më parë, një ekip botanistësh dhe arkeologësh zbuluan në Meksikë një lloj barishteje të quajtur teosinte që besohet të jetë paraardhësi i lashtë i misrit. Besohet që në vitin 600 Pas Krishtit, indianët e Amerikës së Veriut kanë qenë të parët që kanë mbjellë misër. Më pas Kristofor Kolombi e solli në Evropë dhe në shekullin e 17-të misri u kthye në një produkt të preferuar.

USHQIMET QË PASTROJNË ARTERIET



Avokado. Studime të shumta kanë treguar se avokado ka ndikim të jash-tëzakonshëm mbi shëndetin e njeriut. Një studim tregoi se konsumi ditor i avokados, për një periudhë prej një jave, ul ko-lesterolin e përgjithshëm deri në 17%. Avokado e redukton nivelin e kolesterolit të keq (LDL) dhe e rrit nivelin e kolesterolit të mirë (HDL).

Drithërat integrale. Fibrat e tretshme, të cilat i gjejmë në drithërat integrale si orizi ngjyrë kafe apo bollguri, e rregullojnë nivelin e kolesterolit total në gjak dhe e zvogëlojnë rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Bollguri konsumohet kryesisht si mëngjes, por atë mund ta shijoni në çdo kohë të ditës dhe ta shtoni në pothuajse të gjitha ushqimet.

Vaji i ullirit. Një studim zbuloi se personat mbi 65 vjeç të cilët konsumojnë vaj ulliri çdo ditë, kanë një rrezik pothuajse 41% më të ulët nga sulmi në zemër. Megjithatë, edhe pse është i shëndetshëm, duhet ta konsumoni në sasi të moderuar për shkak se është burim i kalorive.

Arrat. Vetëm një grusht arra të hahet në ditë ofron proteina, fibra bimore, acide yndyrore omega 3 dhe antioksidantë. Sasia e arrave sa $\frac{1}{4}$ e filxhanit mund të jetë burim i rëndësishëm i proteinave për vegjetarianë, sepse përmban 8 gr proteina. E njejta sasi gjithashtu përmban 4 gr fibra, sa një kupë me luleshtrydhes ose një banana e vogël, për shembull. Arrat përmbajnë një substancë antioksidante të quajtur 'ellagic acid', e cila forcon imunitetin dhe shfaq veti antikanceroze. Gjithashtu arrat janë një përmbajtje të lartë acidesh yndyrore omega-3, që trupi yne nuk i prodhon dot, te njohura si yndyra të mira, te cilat ulin shtypjen e gjakut, mbrojnë zemrën dhe ulin ko-lesterolin në gjak. Efekti antioksidant i arrave mbron zemrën, ndihmojnë në parandalimin dhe uljen e hipertensionit, përmirësojnë profilin e kolesterolit te personat me diabet, ulin nivelin e disa qelizave që akuzohen për shfaqjen e arteriosklero-

zës, parandalojnë formimin e gurëve në tëmth, ndihmojnë në shëndetin e kockave, ndihmojnë në parandalimin e mbipeshës kurse te fëmijët zvogëlon problemet shëndetësore.

Peshku i yndyrshëm. Peshku i



yndyrshëm, si salmoni, toni apo sardellet, është një burim i shkëlqyer i acideve yndyrore Omega 3. Ekspertët rekomandojnë vaj peshku dy herë në javë për ta zvogëluar rrezikun nga sëmundjet e zemrës. Vaji i peshkut redukton inflamacionin kronik në trup, nivelet e triglicerideve dhe rrit nivelet e kolesterolit të mirë (HDL).

Brokoli. Është i pasur me vitaminë K, e cila është e nevojshme për formimin e eshtrave dhe e pengon kalciumin t'i dëmtojë arteriet. Brokoli është gjithashtu një burim i shkëlqyer i fibrave, ndër-sa studime të shumta kanë treguar se fibrat e rregullojnë presionin e gjakut dhe kolesterolin.

Shafrani. Kjo erëz ka veti të fuqishme anti-inflamatore.

Ajo përmban kurkuminën, e cila e redukton inflamacionin kronik në trup, shkaktarin kryesor të arteriosklerozës (ngurtësimin e arterieve).

Studimet kanë treguar se kurkumina e zvogëlon grumbullimin e depozitave yndyrore në arterie për 26%.

Kanella. Vetëm një lugë e vogël me kanellë në ditë mund ta zvogëlojë akumulimin e yndyrës në enët e gjakut dhe kështu e redukton rrezikun e akumulimit të shtresave në arterie. Ajo gjithashtu ul nivelin e kolesterolit të keq deri në 26%.

Çaji i jeshil. Është një burim i shkëlqyer i katehineve, komponimeve që ulin nivelin e kolesterolit në gjak. Çaji i gjelbër ndihmon në shëndetin e zemrës, duke e ulur rrezikun e obesitetit dhe diabetit të tipit 2. Gjithashtu mund ta zvogëlojë rrezikun nga llojet e ndryshme të kancerit.

Spinaqi. Për shkak të niveleve të larta të kaliumit dhe acidit folik, spinaqi rregullon në mënyrë efektive nivelin e presionit të gjakut. Vetëm një racion spinaq në ditë mund ta zvogëlojë rrezikun nga sulmi në zemër në masën 11%. Spinaqi, si dhe të gjitha llojet e tjera të perimeve me gjethe të gjelbra, duhet të bëhen pjesë e dietës së përditshme.



A KA JETË PAS VDEKJES? ZBULIMI TRONDITËS I SHKENCËTARIT BRITANIK

A ka jetë pas vdekjes? Kjo është një nga misteret më të mëdha të njerëzimit, por tani shkencëtarët thonë se ka jetë të tillë dhe japin argumentet e tyre për këtë.

Ai pretendon se vdekja e trupit nuk do të thotë domosdoshmërisht vdekje e individit, për shkak sipas tij, të ekzistencës së ndërgjegjes. Sipas disa shkencëtarëve të respektuar, mekanika kuantike lejon që ndërgjegjia të jetojë edhe pasi trupi vdes.

Fizikanti i shquar britanik Roger Penrose dhe ekipi i tij besojnë se kanë gjetur prova për mikrotubulet,

proteinat bazë kuantike për tejçimin e informacionit, informacion i ruajtur në nivele nën-atomike. Roger thotë se nëse një person vdes përkohësisht, ky informacion është lëshuar në univers.

Në qoftë se ai do të ringjallet, sipas tij, informacioni rikthehet sërish.

“Nëse ata nuk ringjallen, dhe pacienti vdes, është e mundur që ky informacion kuantik të mund të ekzistojë jashtë trupit, ndoshta për një kohë të pacaktuar si një shpirt”, thotë ai.

ÇFARË KA PAS VRIMAVE TË ZEZA

Një teori në fizikën e grimcave thotë se janë nëntë dimensione dhe se vrimat e zeza janë kryesoret për të arritur tek to. Kjo do të thotë se vrimat e zeza mund të jenë portalet drejt universe tjera. Ndërsa, janë pikërisht shkencëtarët që punojnë në CERN që po synojnë ta dëshmojnë këtë.

Disa teori në fizikën e grimcave thonë se në univers ka më shumë se ajo që shohin sytë, se ka pra dimensione që mund të japin përgjigje për pyetjet që nga fizika kuantike e deri te graviteti.

Një prej tyre është “Teoria e Branit (telave)” që thotë se dimensionet e shumëfishta mund të fshehin universe tjera.

“Është pjesë e një teorie më të gjerë që përpiket të shpjegojë se si të gjitha forcat dhe grimcat që i njohim mund të përshtaten në një përshkrim të vetëm”, ka thënë fizikani Chris White për Daily Mail. “Kjo teori thotë se materialet bazë të ndërtimit të natyrës, në vend se të jenë grimca, mund të jenë tela, të rrafshëta apo shumëdimensionale”.

Telat janë në universin që përbëhet nga nëntë dimensionet dhe kur kësaj i shtohet koha, atëherë bëhen dhjetë dimensione, transmeton Telegrafi.

“Papritmas njeriu pyeti nëse, rastësisht, tek ato ‘brana’ ka njerëz tjerë”, thotë Dr. Cristophe Galfard, i cili në librin “Universi në dorën tënde” shpjegon se si do të dukej udhëtimi në ato dimensionet.

Shkencëtarët e CERN-it po përdorin LHC-në (përshpejtuesin e përplasjes së grimcave) për të dëshmuar ekzistencën e dimensioneve tjera e këtë synojnë ta bëjnë duke krijuar vrima të zeza mikroskopike.

“Ato do të shpërbëhen shpejtë, por do të lënë rrezatim në detektorët tanë”, thotë White.

Teoritë që sugjerojnë ekzistencën e dimensioneve të tjera parashikojnë se në të njëjtën mënyrë siç atomet e kanë gjendjen e energjisë së ulët në “gjumë” dhe atë të lartë në “zgjim”, në dimensionet të

tjera mund të ketë versione më të rënda të grimcave standarde.

Por, edhe nëse zbulohet dëshmia për dimensionin tjetër, kjo jo patjetër do të thotë se teoria e telave ishte e drejtë. Disa shkencëtarë po ashtu nuk besojnë se ka dimensione shtesë. Nga CERN-i thonë se nuk mund të parashohin rezultatin që do ta kenë për dimensionet tjera, por bëjnë me dije se për këtë do të japin njoftime.

UDHËTIM ANGLI-AUSTRALI BRENDA KATËR ORËSH?

Inxhinierët në Britani po punojnë për ndërtimin e një motori të avancuar për raketat, i cili një ditë mund të ndryshojë natyrën e udhëtimeve ajrore. Sipas parashikimeve, synimi është që pasagjerët të kryejnë një udhëtim nga Londra në Sidnej të Australisë brenda katër orësh. Teknologjia e re që po përdoret mund të bëjë të mundur një ditë që avionët e pasagjerëve të udhëtojnë me një shpejtësi pesë herë më të lartë se shpejtësia e zërit.

Mund të tingëllojë si film fantastiko shkencor, por udhëtimi me një mjet ajror, që mund të përshkojë botën brenda disa orësh, nuk është larg realitetit. Kompania britanike “Reaction Engines” njoftoi kohët e fundit se ka siguruar fondet për hulumtime në zhvillimin e motorit reaktiv SABRE, një motor i ri për fluturime në hapësirë.

Kompania ka kombinuar teknologjinë e motorëve të avionëve reaktiv dhe atyre të raketave. E reja e kësaj teknologjie, është sistemi i shkëmbimit të nxehtësisë, që funksionon në mënyrë të tillë: ajri i marrë nga atmosfera ftohet me shpejtësi të madhe nga 1 mijë gradë celsius në minus 150 gradë celsius. Më pas ajri i ftohur digjet me hidrogjen të lëngshëm në dhomën e djegies së motorit.

Kompania Reaction Engines Ltd. thotë se sistemi në fjalë është tejet i lehtë, që do të thotë se mund të përdoret në mjete hapësinore. Kur mjeti fluturues del nga atmosfera e tokës, ai shndërrohet në një motor të zakonshëm rakete, duke përdorur për djegie oksigjenin në bord. Inxhinierët thonë se kjo teknologji i

mundëson aeroplanit të fluturojë brenda atmosferës me një shpejtësi deri pesë herë më të lartë se shpejtësia e zërit ose madje të fluturojë drejtpërdrejtë në orbitë. Për shembull, një aeroplan me 300 pasagjerë mund të shkojë nga Evropa në Australi brenda katër orësh e gjysëm.

Një perspektivë emocionuese për industrinë e aeronautikës, një avion që mund të fluturojë dy herë më shpejtë se Concorde. Eksperti i aviacionit, Tilmann Gabriel thotë se prova e vërtetë do të jetë nëse industria do të ketë përfitime monetare.

“Në kushtet aktuale, asnjë linjë ajrore nuk po rrezikon me avionë të tillë. Është mirë të kesh mjete të tilla por nuk ka përfitime. Në botën e sotme, avionët duhet të jenë krejtësisht komercialë, të kenë fitime, të jenë efikas, të respektojnë rregullat dhe të jenë tejet miqësor me mjedisin.”

Një zbatim i mundshëm afat shkurtër mund të jetë përdorimi i motorëve SABRE në aeroplanët me telekomandë për të transportuar ngarkesa apo satelitë në orbitë. Avioni mund të ngrihet nga pista të zakonshme, pastaj të përdorë motorin e ri për të arritur në orbitë. Të lërë ngarkesën atje dhe të kthehet në tokë dhe të ulet si avionët e zakonshëm. Kjo mund të jetë edhe arsyeja pas vendimit të kohëve të fundit të Agjencisë Evropiane të Hapësirës për të investuar 10 milionë euro në përpjekjet për zhvillimin e motorit SABRE. Kompania Reaction Engines thotë se ka në plan që prototipi i parë i motorit SABRE për demonstrim të jetë gati nga viti 2020.



Lutmuni Mua,
se do t'ju
përgjigjem!
(Gafir, 60)

